

**CILËSIA E HAPËSIRËS PUBLIKE:**  
**PREZANTIMI I NJË METODOLOGJIE VLERËSIMI**

Nga  
Klaud Manehasa

Disertacion i paraqitur Fakultetit të Arkitekturës dhe Urbanistikës, Tiranë, në përmbushje të  
plotë të kërkesave për gradën e Doktorit të Shkencave

2021



Manehasa, Klaud (2021) *Cilësia e hapësirës publike-Prezantimi I një metodologjie vlerësimi*.  
PhD thesis.

E drejta e autorit dhe morali për këtë tezë ruhen nga autori.

Një kopje mund të shkarkohet për kërkime personale (jo për përfitime monetare) ose studimi, pa leje ose pagesë paraprake.

Kjo tezë nuk mund të riprodhohet apo citohet gjerësisht pa marrë më parë lejen me shkrim nga autori.

Përmbajtja nuk duhet të ndryshohet në asnjë mënyrë ose të shitet komercialisht në asnjë format pa lejen e autorit.

Kur i referohemi kësaj vepre, detajet e plota bibliografike duke përfshirë autorin, titullin, institucioni i dhënies dhe data e tezës duhet të përmenden.

## Falenderime

*Gjatë zhvillimit të temës së këtij disertacionit kam pasur një ndihmë dhe mbështetje të madhe nga shumë bashkëpunorë dhe të afërt përreth meje, të cilën e vlerësoj pasi, përtej përmushjes së këtij studimi, këto marrëdhënie kanë pasur dhe kanë një domethënie të madhe për mua si në aspektin profesional ashtu edhe në atë personal.*

*Në rradhë të parë dua të falenderoj udhëheqësin tim, Prof. Dr. Florian NEPRAVISHTA, për kohën, durmin përkushtimin dhe këshillat e vlefshme profesionale, jo vetëm për pjesën e disertacionit por edhe për procesin në tërësi, sidomos për pjesëmarrjen në konferencat dhe botimet e artikujve.*

*Një falenderim i veçantë i drejtohet 'Këshillit të Profesorëve' të Universitetit Politeknik të Tiranës të cilët më kanë inkurajuar vazhdimisht gjatë gjithë periudhës relativisht të gjatë të këtij procesi.*

*Një falenderim I drejtohet kolegëve të 'Departamentit të Urbanistikës' pranë Fakultetit të Arkitekturës dhe Urbanistikës për mbështetjen dhe këshillat profesionale.*

*Mirënjohje e veçantë i drejtohet bashkëpuntores dhe koleges sime, Kristi MUHARREMI, për mbështetjen dhe ndihmën e vazhdueshme që më ka dhënë që nga fillimi I këtij procesi. Debatet e herpasherëshme konstruktive mbi aspektet e metodologjisë dhe punës kërkimore në terren, por edhe diskutimet e vazhdueshme teorike kanë qenë të një vlerë domethënëse në përmbushjen e kësaj teze dhe në plotësimin e metodës së vlerësimit që ky studim prezanton.*

*Më tej, nuk mund të le pa falenderuar edhe kolegët e mi, Klaudia NUSHI, dhe Xhesi ÇONIKU, bashkëpunimi me të cilët, I konkluduar edhe me botimet në revista shkencore, ka qenë një ndihmesë thelbësore sidomos në pjesën e parë të procesit studimor të temës; si edhe prof. dr. Sokol DERVISHI dhe Prof. Dr. Bilal Draci, për mbështetjen e vazhdueshme profesionale dhe miqësore.*

*Së fundmi, në shenjë respekti, dua të përmend edhe ish profesorin tim të nderuar dhe ish udhëheqësin shkencor, Prof. Dr. Enver FAJA, opinionet e të cilit mbi hapësirën 'Urbane' me bënë që të fokusohem përfundimisht tek hapësira 'PUBLIKE'*

Dedikuar

*Prindërve dhe Familjes Time*

## **Deklarata e autorit**

"Unë deklaroj se, përveç rasteve kur bëhet fjalë për referencë të qartë për kontributin e të tjerëve, ky disertacion është rezultat i punës sime dhe nuk është paraqitur në asnjë studim tjetër shkencor në Fakultetin e Arkitekturës dhe Urbanistikës ose ndonjë institucion tjetër."

Firma \_\_\_\_\_

## Përmbajtja

Falenderime.....	3
Deklarata e autorit.....	5
Lista e Figurave.....	8
Lista e Tabelave .....	9
Abstrakt.....	11
Hyrje .....	12
<b>KAPITULLI 1: Konceptualizimi I hapësirës publike.....</b>	<b>13</b>
<b>1.1 Pse hapësirën publike? .....</b>	<b>13</b>
<b>1.2 Hapësirë urbane apo hapësirë publike? .....</b>	<b>14</b>
<b>1.3 Çfarë është hapësira publike?.....</b>	<b>16</b>
<b>1.4 Roli i hapësirës publike në sferën publike .....</b>	<b>26</b>
<b>1.5 Natyra e hapësirës publike të hapur .....</b>	<b>28</b>
<b>1.6 Struktura e studimit dhe objektivat .....</b>	<b>30</b>
<b>1.7 Kontributi per të ardhmen e studimit.....</b>	<b>31</b>
<b>KAPITULLI 2: Shqyrtimi i Literaturës .....</b>	<b>33</b>
<b>2.1 Hyrje.....</b>	<b>33</b>
<b>2.2 Cfarë e perbën hapësirën publike? .....</b>	<b>33</b>
<b>2.3 Semantika e “vendit” dhe “hapësirës” .....</b>	<b>36</b>
<b>2.4 Ontologjia e hapësirës publike.....</b>	<b>40</b>
2.4.1 <i>Llojet e hapësirës publike .....</i>	<i>48</i>
2.4.2 <i>Socializimi si roli primar I hapësirës publike .....</i>	<i>49</i>
<b>2.5 Përmbledhje .....</b>	<b>52</b>
<b>KAPITULLI 3: Transformimi social I hapësirës publike përgjatë historisë .....</b>	<b>52</b>
<b>3.1 Hyrje.....</b>	<b>52</b>
<b>3.2 Hapësira publike në antikitet.....</b>	<b>53</b>
3.2.1 <i>Mesopotamia .....</i>	<i>53</i>
3.2.2 <i>Qytetërimi Grek .....</i>	<i>54</i>
3.2.3 <i>Qytetërimi Romak .....</i>	<i>56</i>
<b>3.3 Hapësira publike në mesjetë .....</b>	<b>57</b>
<b>3.4 Rilindja.....</b>	<b>59</b>
<b>3.5 Periudha moderne.....</b>	<b>60</b>
<b>3.6 Hapësira publike gjatë periudhës së socializmit .....</b>	<b>62</b>

3.6.1 Hapësira publike në Tiranë gjatë periudhës komuniste .....	63
<b>3.7 Hapësira publike kontemporane .....</b>	<b>64</b>
3.7.1 Hapësira publike kontemporane në Tiranë.....	65
<b>KAPITULLI 4 : Ontologjia e hapësirës publike.....</b>	<b>66</b>
<b>4.1 Hyrje.....</b>	<b>66</b>
<b>4.2 Kategoria I e Ontologjisë: Dobia .....</b>	<b>66</b>
<b>4.3 Kategoria II e Ontologjisë: Komforti fizik .....</b>	<b>74</b>
<b>4.4 Kategoria III e Ontologjisë: Ndjesia e përkatësisë .....</b>	<b>98</b>
<b>4.5 Kategoria IV e Ontologjisë: Vizualisht tërheqëse.....</b>	<b>84</b>
<b>KAPITULLI 5: Metodologjia dhe skema e vlerësimit .....</b>	<b>98</b>
<b>5.1 Hyrje.....</b>	<b>111</b>
<b>5.2 Procesi I studimit .....</b>	<b>111</b>
<b>5.3 Struktura e vlerësimit.....</b>	<b>114</b>
<b>5.4 Kalibrimi i indikatorëve të metodologjisë së vlerësimit .....</b>	<b>118</b>
<b>5.5 Vlerësimi I indekseve-Sistemi BOOLEAN.....</b>	<b>120</b>
<b>KAPITULLI 6: Aplikimi i modelit në praktikë.....</b>	<b>123</b>
<b>6.1 Hyrje.....</b>	<b>123</b>
<b>6.2 Rastet studimore .....</b>	<b>123</b>
<b>6.2.1 Unaza nr.3, Tirane .....</b>	<b>124</b>
<b>6.3 Metoda e studimit .....</b>	<b>125</b>
<b>6.4 Grumbullimi dhe analizimi i dokumentacioneve të ndryshme.....</b>	<b>127</b>
<b>6.5 Aplikimi i modelit të vlerësimit në praktikë.....</b>	<b>129</b>
<b>6.6 Tipologjitë urbane në zonë.....</b>	<b>131</b>
1-Bulevardi “Bajram Curri”, “Gjergj Fishta” .....	131
2-Sheshi “Çajupi” .....	147
3-Rruga “Bardhyl” .....	154
<b>KAPITULLI 7: Konkluzione.....</b>	<b>168</b>
<b>7.1 Hyje .....</b>	<b>168</b>
<b>7.2 Pyetja kërkimore dhe objektivat e studimit .....</b>	<b>168</b>
<b>7.3 Rezultatet e studimit .....</b>	<b>169</b>
<b>7.4 Pikat e forta të studimit.....</b>	<b>171</b>
<b>7.5 Limitet e studimit dhe rekomandime të mëtejshme .....</b>	<b>172</b>
<b>SHTOJCA.....</b>	<b>174</b>

<b>Lista e referencave</b> .....	289
----------------------------------	-----

## **Lista e Figurave**

Figure 1. Ndryshimi midis hapësirës urbane dhe hapësirës publike (Burimi: Autori) .....	16
Figure 2: Ilustrim grafik I hapësirës publike (Burimi: Interneti).....	24
Figure 3. Ndikimi I hapësirës publike (Burimi: autori) .....	28
Figure 4. Vendndodhja gjeografike e Mesopotamisë .....	54
Figure 5. Ilustrim grafik I morfologjise se hapësirës publike ne Greqine e lashte, viti 150 para lindjes se Krishtit .....	55
Figure 6. Shembull I ndërtimit të një forumi romak .....	56
Figure 7. Ilustrim i hapësirës publike në mesjetë .....	58
Figure 8. Shembull i mënyrës së organizimit të një sheshi publik në periudhën e rilindjes....	59
Figure 9. Le Corbusier's Plan Voisin-Plani rregullues për qendrën e Parisit, 1925 .....	61
Figure 10. Ilustrim per funksionin e hapësirës publike si vend grumbullim per shperndarjen e ideologjive.....	63
Figure 11. Sheshi “Skenderbej” gjate periudhes komuniste .....	64
Figure 12. (majtas) Qendra tregtare Grand Central Birmingham, (djathtas) rruga “La Rambla”, Barcelonë .....	64
Figure 13. (majtas) Sheshi “Skënderbej” Tiranë, (djathtas) Kryqezimi I bulevardit “Deshmorët e Kombit” dhe “Bajram Curri” .....	65
Figure 14. Grafik për kategorizimin e cilësive të dobishme dhe jo të dobishme të hapësirës publike.....	73
Figure 15. Skema e funksionimit te komfortit (Burimi: Autori) .....	83
Figure 16. Grafiku I komfortit te hapësirës publike .....	83
Figure 17. Skema e funksionimit te Kohezionit social (Burimi: autori).....	110
Figure 19. Rrethi vicioz I funksionimit të hapësirës urbane. (Burimi: autori) .....	112
Figure 20. Rrethi virtuoze I metodologjisë së studimit. (Burimi: Autori).....	114
Figure 21. Skema e studimit (Burimi: autori) .....	116
Figure 22. Skema e gjysmë-rrethit për vlerësimin e hapësirës publike (Burimi: autori).....	117
Figure 23. Ontologjitë e hapësirës publike (Burimi: Autori).....	119
Figure 24. Ilustrim mbi metodologjinë e funksionimit te sistemit <i>BOOLEAN</i> .....	121
Figure 25. Vlerësimi sipas modelit <i>Boolean</i> .....	122
Figure 26. Morfologjia urbane e zones studimore .....	124



Figure 27. Shembull I skedës informative për cdo mini-hapësirë (Burimi: autori).....	125
Figure 28. Evolucionin historik I zonës së Unazës nr.3 .....	128
Figure 29. Lidhja e tre tipologjive urbane me qendrën e qytetit.....	131
Figure 30. Pamja në plan e zonës së studiuar .....	132
Figure 31. Imazhe të gjendjes aktuale në bulevard .....	133
Figure 32. Foto të gjendjes aktuale në bulevardin “Bajram Curri” .....	133
Figure 33. Ndarja e hapësirës në nën njësi të ngjashme studimore .....	135
Figure 37. Skeda vlerësuese e hapësirës 1, bulevardi “Bajram Curri” .....	137
Figure 41. Skeda vlerësuese e hapësirës 2, bulevardi “Gjergj Fishta” .....	139
Figure 45. Skeda vlerësuese e hapësirës 3, bulevardi “Gjergj Fishta” .....	141
Figure 49. Skeda vlerësuese e hapësirës 4, bulevardi “Gjergj Fishta” .....	143
Figure 53. Skeda vlerësuese e hapësirës 5, bulevardi “Gjergj Fishta” .....	145
Figure 54. Pamja në plan e sheshit «Cajupi ».....	147
Figure 55. Imazhe të gjendjes aktuale në sheshin “Cajupi” .....	148
Figure 56. Imazhe të gjendjes aktuale në sheshin “Cajupi” .....	148
Figure 57. Ndarja e sheshit « Cajupi » në nën njësi të ngjashme studimore .....	150
Figure 61. Skeda vlerësuese e hapësirës 1, sheshi “Cajupi” .....	152
Figure 62. Pamja në plan e rrugës « Bardhyl ».....	154
Figure 63. Imazhe të gjendjes aktuale në rrugën « Bardhyl » .....	155
Figure 64. Imazhe të gjendjes aktuale në rrugën « Bardhyl » .....	155
Figure 65. Ndarja e rrugës « Bardhyl » në nën njësi të ngjashme studimore .....	157
Figure 69. Skeda vlerësuese e hapësirës 1, rruga “Bardhyl” .....	159
Figure 73. Skeda vlerësuese e hapësirës 2, rruga “Bardhyl” .....	161
Figure 77. Skeda vlerësuese e hapësirës 3, rruga “Bardhyl” .....	163
Figure 81. Skeda vlerësuese e hapësirës 4, rruga “Bardhyl” .....	165
Figure 82. Grafiku I rezultatit të cilësive negative në zonë .....	167

## Lista e Tabelave

Table 1. Kategorizimi I përcaktimeve të hapësirës publike (Burimi: Autori) .....	25
Table 2. Kategorizimi I elementëve përbërës të hapësirës publike (Burimi: Carmona et al. - Public Places - Urban Spaces_ the Dimensions of Urban Design-Architectural Press (2003))	

.....	34
Table 3.Krahasimi midis vendit dhe hapësirës .....	40
Table 4.Kategorizimi I cilësive të dizajnit urban.....	97
Table 5. Cilësite positive në hapësirën 1 .....	136
Table 6. Cilësitë negative në hapësirën 1.....	136
Table 7. Lloji I socializimit në hapësirën 1.....	136
Table 8. Cilësitë pozitive në hapësirën 2 .....	138
Table 9. Cilësitë negative në hapësirën 2.....	138
Table 10. Lloji I socializimit në hapësirën 2.....	138
Table 11. Cilësitë positive në hapësirën 3 .....	140
Table 12. Cilësitë negative në hapësirën 3.....	140
Table 13. Lloji I socializimit në hapësirën 3.....	140
Table 14. Cilësitë positive në hapësirën 4 .....	142
Table 15. Cilësitë negative në hapësirën 4.....	142
Table 16. Lloji I socializimit në hapësirën 4.....	142
Table 17. Cilësitë pozitive në hapësirën 5 .....	144
Table 18. Cilësitë negative në hapësirën 5.....	144
Table 19. Lloji I socializimit në hapësirën 5.....	144
Table 20. Cilësitë positive në hapësirën 1 .....	151
Table 21. Cilësitë negative në hapësirën 1.....	151
Table 22. Lloji I socializimit në hapësirën 1.....	151
Table 23. Cilësitë positive në hapësirën 1 .....	158
Table 24. Cilësitë negative në hapësirën 1.....	158
Table 25. Lloji I socializimit në hapësirën 1.....	158
Table 26. Cilësitë positive në hapësirën 2 .....	160
Table 27. Cilësitë negative në hapësirën 2.....	160
Table 28. Lloji I socializimit në hapësirën 2.....	160
Table 29. Cilësitë positive në hapësirën 3 .....	162
Table 30. Cilësitë negative në hapësirën 3.....	162
Table 31. Lloji I socializimit në hapësirën 3.....	162
Table 32. Cilësitë positive në hapësirën 4 .....	164
Table 33. Cilësitë negative në hapësirën 4.....	164
Table 34. Lloji I socializimit në hapësirën 4.....	164

## **Abstrakt**

Objektivi kryesor i kësaj teze është që nëpërmjet një analize morfologjike mbi hapësirën publike dhe gjithë komponentët e saj, mbi bazën e një literature të gjërë mbi këtë fushë, do të studiohet cdo problematik e saj si dhe fushat e ndikimit të cilësisë së jetës sociale publike në tërësinë e qytetit. Në këtë mënyrë, synohen të arrihen dy qëllime kryesore: Së pari, të krijohet një metodologji empirike për vlerësimin e hapësirës publike, e cila do të shërbej jo vetëm për rastet e aplikuara në këtë tezë por për çfardo lloj natyre të hapësirave publike.

Së dyti, duke analizuar me imtësi hapësirën publike, në cdo aspekt dhe problematik të sajën, mund të arrijmë të gjejmë mënyrën e duhur për të ndërhyrë në hapësirën publike duke sjell si rrjedhojë përmirësimin e saj, e cila ndikon në jetën sociale të gjithë qytetit. E gjithë teza sjell një këndvështrim të ri mbi hapësirën publike duke analizuar deri në imtësi natyrën e saj komplekse dhe multi dimensionale. Hapësira publike si entitet fizik dhe social në këtë studim është ndarë në kategoritë kryesore ontologjike që e kristalizojnë formën dhe qasjen e saj në publik, për të arritur thelbin sesi funksionon në mënyrë të suksesshme një hapësirë publike « ideale », duke u bazuar në katër ontologji kryesore : Dobia, Komforti fizik, Ndjesia e përkatësisë dhe Tërheqja vizuale. Marrëdhëniet e ndërsjellta e këtyre kategorive kryesore së bashku me nënndarjet e veta është materializuar në modelin e gjysmë-rrethit, i cili është mjeti i krijuar në këtë studim që do të shërbej për analizimin e cilësisë së hapësirës. Në këtë kontekst metodologjia e krijuar është testuar edhe në raste praktike, të situatave të ndryshme urbane reale, për të vërtetuar funksionalitetin e këtij modeli vlerësimi. I gjithë ky proces do të jetë baza për arritjen e optimizimit maksimal të cilësisë së sferës publike kundrejt funksionit të saj themelor, kohezionit social.

Gjithsesi, duhet theksuar se ky është një projekt eksperimental, ku mbi bazën e analizës së një literature tepër të vlerësuar dhe vëzhgimit të drejtpërdrejtë të hapësirës publike, tenton që në një mënyrë sa më objektive të krijoj një metodologji vlerësimi gjithëpërfshirëse dhe funksionale por nuk pretendon që kjo është formula e vetme dhe më e saktë për vlerësimin e hapësirës. Kjo metodologji do të jete në testim konstant si nga autori por edhe nga studiues të ndryshëm për ta vërtetuar funksionalitetin e saj por edhe për ta vazhduar në nivele edhe më të avancuara studimi.

## Hyrje

Thuajse të gjitha funksionet e jetës sonë të përditshme janë të varura në mënyrë direkte ose indirekte nga hapësira publike. Pavarësisht se shpenzojmë pjesën më të madhe në hapësirë publike, në shumicën e rasteve e neglizhojmë ndikimin që cilësia e saj jep në jetën e një shoqërie. Tipologjia e aktiviteteve dhe veprimtarive që zhvillohet në to është e shumëllojshme duke nisur që nga ato të imponuara për shkak të funksioneve që ofrohen në një hapësirë e deri tek aktivitetet sociale si shpenzimi i kohës së lire, i vetëm ose në grup. Hapësira publike është e kudogjendur në formën e rrugëve, shesheve, parqeve, lulishteve në zonat e banimit, blloqet, komplekset dhe lagjet, ne qendrat e qytetit dhe ne pjeset periferike të tij, etj.

Një analizim i thellë i literaturës së dizajnit urban thekson rolin dhe nevojën për hapësirë domethënëse publike, për përvojën e jetës publike dhe ndërveprimin shoqëror (Jacobs, 1961; Lynch, 1984; Gehl, 1987; Crowhurst-Lennard dhe Lennard, 1987, 1995; Vernez-Moudon, 1991; Carr et al., 1992; Tibbalds, 1992; Sorkin, 1992; Zukin, 1996; Cooper-Marcus dhe Francis, 1998). Megjithatë, shumica e tyre janë të dyzuar nëse hapësira publike e viteve të fundit po pëson rënie në cilësinë e saj apo po ndryshon formë për t'iu pershtatur ndryshimit të vrullshëm të jetës shoqërore.

“Shpëtimi” i hapësirës publike, vitet e fundit, është parë kryesisht në krijimin e sa më shumë parqeve, pa marr parasysh se hapësira ekziston në tipologji të ndryshme dhe më e rëndësishmja, pa analizuar problematikat në funksionimin e hapësirave për të arritur kështu në thelbin e mos funksionimit. Marrja në konsideratë e këtyre konceptimeve domethënëse do të çonte për rrjedhojë në përmirësimin e llojeve të hapësirave ekzistuese. Gjithsesi ky është një debat shumë i gjerë për të cilin do të flasim në vazhdim në një mënyrë më të hollësishme.

Thelbi i kësaj teze qëndron në qasjen ndaj funksionit të hapësirës publike si një arenë për të nxitur kohezionin social pa të cilin qytetet tona do të ishin thjeshtë konglomerate ndërtesash. Ky funksion kardinal i hapësirës publike do të jetë boshti kryesor i zhvillimit të këtij studimi. Bazuar në natyrën semiotike të hapësirës publike, teza mbështetet mbi analizimin empirik të karakteristikave fizike, përdorimit dhe zonave në të cilat zhvillohen aktivitete sociale në hapësirën publike. Mbështetur në literaturë të gjerë shkencore mbi hapësirën publike nga autorë të vlerësuar, e kombinuar kjo më vlerësimin e drejtpërdrejtë vizual, studimi grumbullon informacione të detajuara mbi marrëdhënien e hapësirës publike me kohezionin social të cilat së bashku me metoda deduktive analizimi, cilësore dhe sasiore do të jenë pikënisja e krijimit të një modeli vlerësimi mbi cilësinë e hapësirës publike, i cili mund të përdoret si një mjet vlerësues i cilësisë së hapësirës publike.

## **KAPITULLI 1: Konceptualizimi I hapësirës publike**

### **1.1 Pse hapësirën publike?**

Nëse do të bëjmë pyetjen ‘Pse duhet ta studiojmë kaq imtësisht hapësirën publike?’ apo ‘Si ndikon hapësira publike në jetën e një komuniteti?’ duhet të jemi të kujdesshëm që, pavarësisht evolucionit historik që ka pësuar hapësira publike, fokusi kryesor I analizës duhet të jetë situata e saj bashkëkohore, sidomos në ditët e sotme, ku hapësira publike po ndryshon natyrë me procesin e vullshëm të privatizimit të hapësirave, fenomen ky, i cili është ngritur si një shqetësim i gjerë midis profesionistëve dhe jo vetëm.

Shumë role historike të hapësirës publike, të tilla si mbledhja e ujit, asgjësimi i mbeturinave, shpërndarja e lajmeve, shfaqja e dënimeve dhe ekzekutimeve publike (Lofland, 1998) nuk i përkasin më kohës së tashme. Tashmë hapësira publike konceptohet si një arenë e ndërveprimit social, ku përdorimi duhet ti përkas plotësisht publikut. Çdo ditë e më tepër po vihet theksi në cilësinë e sferës publike si promotor i jetës sociale të qyteteve por erozioni i ndodhur ndër vite i përdorimit për qëllime kryesisht private dhe ekonomike e ka dhënë efektin e vet negativ.

Kërkimet e fundit në studimet urbanistike tregojnë se hapësirat publike në kohët e sotme janë të rëndësishme për të gjeneruar, përmirësuar dhe mbështetur një ndjenjë të komunitetit (Boyer, 1994; Hayden, 1995). Banorët lokalë i veshin kuptime dhe ndjesi personale hapësirave dhe vendeve të përditshme publike si "struktura të shenjta" të vlefshme në jetën e tyre të përditshme (Hester, 1993). Hapësira publike domethënëse ose cilësore urbane ka aftësinë për të mbështetur, lehtësuar dhe promovuar jetën publike, si një homolog thelbësor i hapësirës sonë private, shtëpisë dhe punës, për të kënaqur nevojën tonë për kontakt, komunikim, lojë dhe relaksim, Oldenberg (1981).

Në një botë urbane ku shqetësimi kryesor është zhvillimi i qëndrueshëm (Raporti i Zhvillimit Njerëzor 2007/2008; Konferenca e KB për Ndryshimet Klimatike Kopenhagë 2009), ndërtimi i qyteteve më socialisht kohezive, miqësore me mjedisin dhe ekonomikisht në zhvillim, paraqitet si një parakusht kryesor duke e vënë theksin tek funksionet bazë të hapësirës publike ku:

*-Nga pikëpamja sociale* hapësirat publike si rrugët, parqet, sheshet etj janë vendet kryesore ku jeta shoqërore zhvillohet, ku njerëzit mund të takohen apo të kalojnë kohën e lirë së bashku.

*-Së dyti, nga pikëpamja mjedisore,* hapësira publike cilësore favorizon përdorimin e rrugëve këmbësorëve dhe përdorimin e transportit publik në vend të qarkullimit të vazhdueshëm me makinë.

-Së treti, nga pikëpamja ekonomike, një hapësirë publike që ka një fluks të lartë këmbësoresh, sjell më tepër fitime për bizneset që ndodhen në atë hapësirë.

Me besimin se hapësira publike është një element thelbësor në dizajnin urban, në jetën sociale të komuniteteve dhe komponenti bazë në zhvillimin e qëndrueshëm të qyteteve në procesin e globalizmit të vrullshëm që është duke ndodhur, është ndërmarr ky hulumtim dhe studim i hollësishëm mbi cilësinë e hapësirës publike.

## 1.2 Hapësirë urbane apo hapësirë publike?

Të japësh një përkufizim të qartë midis asaj çfarë është hapësira urbane dhe hapësira publike është një detyrë aspak e thjeshtë duke pasur parasysh gërshetimin e një mori elementesh, faktorësh dhe marrëdhëniesh të ndërsjellta që përbëjnë thelbin e secilës prej tyre. Ky përkufizim vështirësohet edhe më tepër duke qënë se hapësira urbane është produkt i procesit të urbanizmit, i cili kap kufijtë e globalizmit. Shpesh, në opinionin publik hapësira urbane dhe hapësira publike konsiderohen dy terma që përfaqësojnë të njëjtin koncept. Por e shprehur në një mënyrë më të thjeshtë, hapësira urbane është një marrëdhënie e dyfishtë: objektet e ndërtuara dhe hapësira midis tyre, duke pasur në fokus sigurimin e funksionimit të qytetit, kryesisht në aspektin ekonomik të tij. Nga ana tjetër hapësira publike është një marrëdhënie e trefishtë midis ndërtesës, hapësirës dhe ndërveprimit social të përdoruesve të tyre.

Pra ndryshimi thelbësor midis tyre është *efekti social* (fig.1). Ky konstatim do të shoqëroj të gjithë studimin duke u kthyer në aksiomën bazë të tij.

Në anën tjetër ka ekzistuar gjithmone një debat i ndezur në lidhje me përcaktimin se çfarë përfshin hapësira publike, ku profesionistë të ndryshëm kanë mbajtur qasje të ndryshme për sa i përket hapësirës publike në terma të aksesit dhe pronësisë. Problemi kryesor qëndron në faktin që disa e lidhin konceptin e saj me mjedisin fizik ndërsa disa të tjerë më përjetime dhe eksperiencat individuale të përdoruesve të saj, duke krijuar kështu një konglomerat përcakimesh të mbivendosura, të cilat në fund të fundit nuk japin një kontribut pozitiv për askënd.

Hapësira publike është vetëm një pjesë, një manifestim fizik, i sferës publike (Thomas, 1991). Megjithatë, ajo luan një rol të rëndësishëm në mbajtjen e sferës publike (Sennett, 1971; Thomas, 1991; Lofland, 1998).

Sipas Madanipour, 1996, 'hapësira publike' është hapësira që nuk kontrollohet nga individë apo organizata të ndryshme dhe është e hapur për publikun, ndërsa Carr, 1992 thekson se hapësira

publike përfaqësohet nga vende të cilat mund të aksesohen nga gjithë publiku për aktivitete individuale apo në grupe.

Në dimensionin fizik, hapësire publike janë të gjitha pjesët e strukturës urbane në të cilat publiku ka akses fizik dhe visual të pakufizuar. Në këtë mënyrë, përfshihen që nga rrugët, parqet, sheshet e qytetit ose ato midis ndërtesave të cilat konfigurojnë hapësirën. (Tibbalds, 1992,).

Ekzistenca e përcaktimeve të ndryshme multidisiplinore mbi hapësirën publike krijon tepër konfuzion mbi atë çfarë realisht përfaqëson hapësira publike. Në rafshin teorik do të vëmë re gjatë studimit se ekzistojnë një mori përkufizimesh të mbivendosura ndërsa në rafshin praktik shohim se hapësira publike është një produkt kompleks midis politikës, mjedisit dhe kulturës së shoqërive. Gjërat do të veshtirësohen edhe më tepër nëse do të marrim parasysh që hapësira publike është një konstrukt personal i krijuar në mënyrë subjektive nga ndjesitë dhe eksperiencat e çdo përdoruesi.


Hapësirat publike mund të jenë të natyrave të ndryshme, të hapura, të mbyllura apo të kombinuara si përshembull; parqe, sheshe, rrugë, biblioteka, teatro etj, ku karakteristika e përbashkët për gjithësecilën është që krijojnë mundësinë për njerëz apo grupe njerëzish të ndryshëm të qëndrojnë në këto hapësira dhe të kalojnë kohë aty, të vetëm ose të krijojnë kohezion social me njëri tjetrin pavarësisht gjinisë, moshës, prejardhjes apo klasës.

Nëse do ndalemi të analizojnë hapësirën publike në terma të **pronësisë** një shembull i mirë ilustrues do të ishin qendrat tregtare ku aksesit dhe përdorimi është i pakufizuar për publikun por pronësia e saj është private. A mund të quhet kjo një hapësire publike?

Në anën tjetër, nëse do ti referohemi **arritshmërisë** (aksesit), një shembull i mirë janë institucionet publike, ku pronësia e tyre është publike por aksesit për publikun është i kufizuar. A mund të themi në këtë rast se bëhet fjalë për një hapësirë publike? Gjithsesi ky është një diskutim shumë i gjerë në të cilin, nëse do të zgjerohemi shumë, do të humbisnim esencën e hapësirës publike për këtë studim. Për këtë efekt me termin '*hapësire publike*', në këtë tezë, *'janë të gjitha ato pjesë të mjedisit të ndërtuar dhe natyror, publik dhe privat, të brendshme dhe të jashtme, urbane dhe rurale, ku publiku ka akses, megjithëse jo domosdoshmërisht të pakufizuar. Kjo përfshin: të gjitha rrugët, godina me përdorime rezidenciale, tregtare ose komunitare / qytetare; hapësira të hapura dhe parqe; fshatra; "publike / private"hapësira si të brendshme ashtu edhe të jashtme aty ku aksesit i publikut është i lejuar- nëse kontrollohet - siç janë qendrat private tregtare ose hekurudhat; dhe hapësira të brendshme të ndërtesave*

*kryesore publike dhe qytetare si psh biblioteka, kisha ose salla qytetesh. (Matthew Carmona, Public space the management dimension)*

Në funksion të studimit, kjo tezë fokusohet vetëm në **‘hapësirat publike të mjedisit të ndërtuar, publike, të hapura, urbane, ku publiku ka akses të pakufizuar’**.



*Figure 1. Ndryshimi midis hapësirës urbane dhe hapësirës publike (Burimi: Autori)*

### **1.3 Çfarë është hapësira publike?**

Sipas Shoqates Amerikane të planifikimit, një hapësirë publike mund të jetë një vend grumbullimi ose pjesë e një lagjeje, në qendër të qytetit, një zonë e veçuar, ballinë ujore (Waterfront) ose zona të tjera brenda sferës publike që ndihmojnë në promovimin e bashkëveprimit shoqëror dhe një ndjenje të komunitetit. Shembuj të mundshëm mund të përfshijnë hapësira të tilla si plazat, sheshet e qytetit, parqet, vendet e tregut, vendet e përbashkëta dhe qendrat publike, mjediset e gjelbërta publike, zona ku ndodhen basene ujore natyrore.

Për Lofland L. (*The Public Realm: Exploring the City's Quintessential Social Territory, 1980*), termi “hapësirë publike” përfshinë një larmi të lidhjeve juridike midis publikut dhe hapësirës. (f.8)



Mbi karakterin e hapësirës publike Carr, S et. Al. (*Public space, 1992*) shprehet: "Ne e shohim hapësirën publike si tokë të përbashkët ku njerëzit kryejnë aktivitete funksionale dhe rituale që lidhin një komunitet, qoftë në rutinat normale të jetës së përditshme, apo në festat periodike (f. Xi)"

"Ekzistojnë tre vlera kryesore që drejtojnë zhvillimin e perspektivës sonë: Ne besojmë se vendet publike duhet të jenë të përgjegjshme, demokratike dhe domethënëse (f. 19)."

Duke e ndarë hapësirën në kategori të ndryshme, Kohn, M (*Brave New Neighborhoods, The privatization of Public Space, 2004*), jep pikëpamjen e vet: "Përkufizimi që unë propozoj për hapësirën publike tre komponentë thelbësorë, pronësia, aksesimi dhe ndërsjelltësitë. Në zhargonin e përditshëm, hapësira publike zakonisht i referohet një vendi që është në pronësi të qeverisë, i arritshëm për të gjithë pa kufizime dhe / ose nxit komunikimin dhe ndërveprimin (f. 11)."

Ndërsa Zukin S, në librin "*Kulturat e Qyteteve*" e trajton konceptin e hapësirës publike në disa dimensione:

•*Si koncept*: "Hapësirat publike janë të rëndësishme sepse ato janë vende ku të huajt bashkohen lirshëm. Por ato janë gjithashtu të rëndësishme sepse negociojnë vazhdimisht kufijtë e shoqërisë njerëzore. Si për nga vendndodhja, ashtu edhe nga pamja, vendi i takimit dhe terreni i organizimit shoqëror, hapësirat publike na mundësojnë të konceptojmë dhe përfaqësojmë qytetin - të bëjmë një ideologji të pranueshmërisë të tij ndaj të huajve, tolerancën e ndryshimit dhe mundësitë për të hyrë në një jetë plotësisht të socializuar, qytetare dhe komerciale (f.8)"

•*Si vend publik*: "Shumë kritikë sociologë kanë filluar të shkruajnë për hapësirat e reja publike të formuara nga" hapësira transaksionale "e telekomunikacionit dhe teknologjisë kompjuterike, por interesimi im për këtë libër është në hapësirat publike si vende që janë fizikisht atje, si qendra gjeografike dhe simbolike, si pika e takimit për një huaj (f. 45). "

•*Si kulture publike*: "Hapësirat publike janë vendi kryesor i kulturës publike; ato janë një dritare në shpirtin e qytetit. Për më tepër, nga ana vizuale hapësirat publike janë një mjet i rëndësishëm për të inkuadruar një vizion të jetës shoqërore në qytet, një vizion si për ata që jetojnë atje, dhe bashkëveprojnë në hapësira publike urbane çdo ditë, dhe për turistët, udhëtarët dhe njerëz të pasur që janë të lirë të ikin nga "detyrimet" e qytetit (f. 259). "

•*Si hapësira publike urbane*: "... Hapësirat publike urbane vëzhgohen nga afër sepse ato janë kryqëzime të identitetit kombëtar. Karakteristikat përcaktuese të hapësirës publike urbane -

afërsia, diversiteti dhe mundësia e përdorimit - dërgojnë sinjalet e duhura për një identitet kombëtar që do të jetë më multikulturor, dhe të ketë diversitet social në vitet në vazhdim (f.262). "

Duke i'u referuar aspekteve të menaxhimit dhe kontrollit të hapësirës publike, *Mitchell, D*, "The right to the city: social justice and the fight for public space (2003), shprehet: "Hapësira publike krijon frikë, frikë që buron nga ndjenja e hapësirës publike si hapësirë e pakontrolluar, si një hapësirë në të cilën civilizimi është jashtëzakonisht i brishtë (f.13)."

"Në një botë të përcaktuar nga prona private, hapësira publike (si hapësirë për përfaqësim) merr një rëndësi të jashtëzakonshme. (...). Vetë akti i përfaqësimit të një grupi (ose në një farë mase të vetvetes) për një publik më të madh krijon një hapësirë për përfaqësim. Përfaqësimi në vetvete i kërkon te dyja, duke krijuar kështu hapësirën (f. 34)."

*Staeheli, L & Mitchell, D*, ne *The People's Property? Poëer, Politics, and the Public* (2008), e trajton përcaktimin mbi hapësirën publike në aspektin e pronës publike: "Hapësira publike (...) nuk është e njëjtë me pronën publike. Në të vërtetë, cilësia e të qënurit publik – për aq sa publike mund të jetë një hapësirë - duket se konsiston në marrëdhëniet e vendosura midis pronës (si një send dhe një grup marrëdhëniesh dhe rregullash) dhe njerëzve që banojnë, përdorin dhe krijojnë pronën. (f. 116).

"..." hapësira publike "është një hapësirë e rrëshqitshme, e ndërlikuar dhe zhvendosëse (f. 117)"

*Loë, S*, *On the Plaza: The Politics of Public Space and Culture* (2000) thekson dy koncepte të hapësirës të cilat shpesh keqpërdoren duke i njësuar si terma:

•-Hapësira publike urbane, "Vendet publike urbane janë shprehje të përpjekjeve njerëzore; artefaktet e botës shoqërore vendosen, komunikohen dhe interpretohen në kufijtë e këtij mjedisi të projektuar (f. 47)."

•-Hapësira publike, "Sidoqoftë, ajo që është domethënëse është se hapësirat publike janë arena të rëndësishme për ligjërimin publik dhe shprehjen e pakënaqësisë (f. 204)"

*Gehl, J. & Gemzoe, L.*, *Neë City Spaces* (1999), shprehet për hapësirën publike: "Megjithëse modeli i përdorimit ka ndryshuar gjatë historisë, hapësira publike ka shërbyer gjithnjë si vend takimesh, tregu dhe hapësirë trafiku (f. 10)."

*Tibbalds, F, Making People Friendly Towns (1992)*, e ndan hapësirën publike në dy sfera kryesore të veprimtimit:

•-Fusha publike: "Realiteti publik, sipas mendimit tim, është pjesa më e rëndësishme e qyteteve tona. Është vendi ku sasia më e madhe e kontaktit dhe ndërveprimtimit njerëzor zhvillohet. Janë të gjitha pjesët e paterneve urbane, tek të cilat publiku ka qasje fizike dhe vizuale. Kështu, ajo shtrihet nga rrugët, parqet dhe sheshet e një qyteti ose qyteti në ndërtesat që i mbyllin dhe i markojnë ato (f. 1). "

•-Hapësira publike: "Vendet publike brenda një qyteti i përkasin njerëzve të këtij qyteti - ato nuk u përkasin zhvilluesve ose investitorëve, policisë ose reparteve të trafikut. Natyra e tyre do të ndikohet nga shkalla, forma dhe madhësia e tyre; mënyrat në të cilat ato lidhen njëra me tjetrën; përdorimet dhe aktivitetet që ato përmbajnë, dhe mënyra në të cilën trajtohet trafiku i të gjitha llojeve (f. 14)"

Gjithashtu *Madanipour, A, Public and Private Spaces of the City (2003)*, i referohet konceptit të hapësirës publike duke ju referuar sferave të ndikimit si vendet publike, sfera publike dhe fushën publike: "Unë kam përdorur termin "hapësirë publike (dhe vend publik) për t'iu referuar asaj pjese të mjedisit fizik, i cili shoqërohet me kuptime dhe funksione publike. Megjithatë, termi sferë publike (dhe sfera publike) është përdorur për t'iu referuar një koncepti shumë më të gjerë: të gjithë gamën e vendeve, njerëzve dhe aktiviteteve që përbëjnë dimensionin publik të jetës shoqërore të njeriut. " "... Hapësira publike është pjesë përbërëse e sferës publike (f. 4)."

"Duke përdorur kriteret e aksesit, kontrollit dhe interesit, një hapësirë mund të konsiderohet publike nëse kontrollohet nga autoritetet publike, i përket të gjithë njerëzve në tërësi, është e hapur ose e disponueshme për ta, dhe përdoret nga të gjithë anëtarët e një komunitet (f. 112)"

Në anën tjetër *Orum, A & Neal, Z, Common Ground: Readings and Reflections on Public Space (2010)*, shpreh një koncept të lidhur me cilësinë e aksesit të hapësirës "Ndërsa ekzistojnë shumë mënyra të ndryshme për të përcaktuar hapësirën publike, shumica janë dakord që hapësira publike përfshin të gjitha fushat që janë të hapura dhe të arritshme për të gjithë anëtarët e publikut në një shoqëri, në parim dhe jo domosdoshmërisht në praktikë (f.1)."

*Scruton, R, The Public Interest (1984)* gjithashtu i referohet hapësirës në terma të aksesit "Një hapësirë bëhet publike për shkak të natyrës së kufirit ndarës të saj. Është një hapësirë në të cilën dikush mund të hyjë, dhe nga e cila dikush mund të largohet, pa pëlqimin e të huajve, dhe

pa ndonjë deklaratë - sado të heshtur - me një qëllim justifikues. Kufiri që krijon një hapësirë publike është i përshkueshëm dhe i hapur për përdorimet tona publike (f. 15)”

Ndersa *Jackson, J.B. 'The American Public Space'*, e lidh cilësinë e aksesit me meanxhimin e hapësirës duke e cilësuar hapësirën publike si një marrëdhënie e ndërsjelltë midis menaxhimit dhe aksesit: “Një vend publik përcaktohet zakonisht si një vend (ose hapësirë) i krijuar dhe mirëmbajtur nga autoriteti publik si dhe i arritshëm për të gjithë qytetarët për përdorimin dhe kënaqësinë e tyre. Kjo nuk na tregon asgjë për mënyrat e ndryshme në të cilat ne i përdorim dhe shijojmë ato, as për llojet e ndryshme të përdoruesve të përfshirë (...) Kur përfshijmë midis hapësirave më të reja publike parkimin, zonën e deponimit të plehrave dhe autostradën, është e qartë se publiku i ka të gjitha kushtet e nevojshme, jo vetëm për sa i përket vendeve për relaksim, por edhe për përdorimin korrekt të tyre (f. 277)”

Krahas përcaktimeve në terma të kushteve fizike, *Mensch, J, Public Space (2007)*, i referohet hapësirës në kuadrin e marrëdhënieve sociale, "Hapësira publike" është hapësira ku individët shohin dhe shihen nga të tjerët ndërsa merren me punët publike. Është, pra, hapësira e mbledhjes së komunitetit, kuvendi ligjvënës ose ndonjë nga vendet e tjera ku kryhet biznesi publik (f. 31)”

Nje koncept i përgjithshëm sipas *Goodsell, C.T. 'The Concept of Public space and its Democratic Manifestations' (2003)*, është: "Unë propozoj një përkufizim të përgjithshëm që mbështetet në këto orientime të ndryshme, por që tejkalon secilën. Përkufizimi im është një hapësirë - kohë për ligjërimin politik. Me këtë frazë nënkuptoj aftësinë për një proces njerëzor të lidhur dhe ndërveprues të përvojës komunikuese. (...) Diskursi është politik sepse ka të bëjë me natyrën dhe të ardhmen e komunitetit dhe të mirës publike (f. 370)”

Hapësira publike është një arenë politike, dhe në rastet më ekstreme është luftuar në mënyrë aktive nga grupe me vizione ideologjike në dukje të pakonkurueshme, në lidhje me natyrën dhe qëllimin e hapësirës publike - një vend i qasjes dhe ndërveprimit të lirë, i pakushtëzuar nga kontrolli komercial / forcat e shtetit, një hapësirë për qëllime të veçanta të përcaktuara, duke iu nënshtruar normave të sjelljes dhe kontrollit mbi ata që lejohen të hyjnë (Mitchell 1995: 115).

Në librin “Hapësira publike- dimension i menaxhimit”, Matthew Carmona jep një përkufizim shumë të gjerë të hapësirës publike, në saj të pikëpamjeve të shumëllojshme, mbështetur mbi citatet e autorëve të ndryshëm, duke prekur pothuajse të gjitha aspektet fizike dhe sociale mbi të cilat vepron hapësira:

1- Nga pikëpamja Sociologjike-Wallin (1998: 109) përcakton shumicën e hapësirës publike urbane bashkëkohore si "hapësirë dyistike", një hapësirë e marrëdhënieve jopersonale dhe abstrakte dhe si një antitezë e qëllimshme e hapësirave ‘proksemike’ të Hall (1966) që kontrollohen nga kultura. Hapësirat dyistike janë më personale, kanë marrëdhënie abstrakte që nxisin anëtarët e grupeve të ndryshme sociale të ndërveprojnë me njëri tjetrin ndërsa hapësirat proksemike janë shprehje e kulturës lokale.

Përkundrazi, sistemi është "një bashkësi e të huajve" që banojnë në hapësirën publike. Kjo është bota e qendrës tregtare, televizionit ose rrjetit botëror: kultura e kapitalizmit ku shoqëria vazhdimisht mbahet në gjendje pasive dhe konsumuese për anën mendore dhe emocionale”.

2- Nga përvoja hapësinore- Gulick (1998: 135–41) përcakton tre lloje të hapësirës publike për të cilat ai pretendon se shumë kritikë janë konfuz kundrejt njëri-tjetrit:

- ‘Pronë publike’: përcaktimi tradicional ku qeveria ose shteti posedojnë zyrtarisht hapësirë;
- ‘Semiotike’: i përbërë nga identitete hapësinore që inkurajojnë konkurrencën dhe ndarjen në hapësirën urbane (Fainstein 2001: 1);
- ‘Sferë publike’: hapësira e komunitetit, ku qytetarët mund të bashkëveprojnë në mënyrë shoqërore ose politike.

3- Në terma të marrëdhënieve të pushtetit-Kilian (1998: 115–16) argumenton se të gjitha hapësirat janë shprehje të marrëdhënieve të pushtetit që përmbajnë publikun ashtu edhe privat. Ai identifikon dy lloje të hapësirës publike: hapësirën publike si vend i kontaktit dhe hapësirën publike si vend i përfaqësimit (përkatësisht sferën publike të Gulick dhe hapësirat publike semotike), dhe argumenton se kritikët kanë të bëjnë me të dyja llojet, publike dhe private. Në fakt, ai sugjeron se, të gjitha hapësirat janë njëherësh publike dhe private dhe përmbajnë kufizime, qofshin këto aksesit ose aktiviteti, të qarta ose të nënkuptuara.

4- Si një rrugëtim nga vizioni dhe realiteti- Lefebvre (1991: 39) bën dallimin midis 'hapësirës përfaqësuese' (hapësirës së përvetësuar, të jetuar ose hapësirës në përdorim) dhe 'përfaqësimeve të hapësirës' (planifikuar, kontrolluar dhe porositur). Në këtë kuptim, hapësira shihet si një kronologji, që zhvillohet dhe ndryshon me kalimin e kohës. Kështu, hapësira zakonisht fillon si përfaqësim i një lloji të veçantë të hapësirës, me një gamë të veçantë përdorimesh, por përvetësohet me kalimin e kohës nga përdorime dhe aktivitete të tjera.

5- Në sajë te kontrollit- Van Melik et al. (2007 : 25–8) argumentojnë se dizajni dhe administrimi i hapësirës publike në vitet e fundit u është përgjigjur dy tendencave : 'Nga njëra anë, një ankth në rritje për krimin i nxiti njerëzit të shmangnin sferën publike të qytetit dhe të tërhiqeshin në sfera private. Megjithatë, tërheqja e argëtimit urban gjithashtu u rrit, duke i nxitur njerëzit të kënaqin fantazinë dhe përvojat e reja jashtë shtëpisë '. Për ta, këto përfaqësojnë dy anë të një tendence drejt një kontrolli më të madh, por prodhojnë dy lloje të dallueshme të hapësirës publike :

- hapësirë të sigurt publike - të karakterizuar nga masa për të krijuar një ndjenjë të sigurisë, përmes CCTV, njësi mbikqyrëse dhe përjashtimi i grupeve të padëshiruara.
- hapësirë publike me tematikë- synon të krijojë ambiente dhe të stimulojë aktivitete në mënyrë që të tërheqë më shumë njerëz në hapësirat publike dhe në këtë mënyrë të inkurajojë vetëqeverisjen e tyre.

6- Në terma të përshatshmërisë në përdorim- Franck dhe Stevens (2007 : 23) argumentojnë : 'lirëshmeria dhe ngushtësia e hapësirës janë kushte të lidhura, që dalin nga një lidhje e veçorive fizike dhe sociale të një hapësire '. Kështu, hapësira e lirshme është e adaptueshme, e pakufizuar dhe e përdorur për një sërë funksionesh, rastësore si dhe të planifikuara. Në të kundërt, hapësira e ngushtë është e kufizuar fizikisht ose e kontrolluar për sa i përket llojeve të veprimtarive që mund të ndodhin atje. Për ta, megjithëse këto cilësi janë të rregullueshme dhe relative, llojet e reja të hapësirës që janë shfaqur shpesh kanë një natyrë më kufizuese sesa kanë qenë në të kaluarën dhe dekurajojnë në mënyrë aktive llojet e aktiviteteve të paplanifikuara që të çojë në lirshmëri.

7- Përmes strategjive të tyre përjashtuese - Flusty (1997 : 48-49) bën dallimin midis llojeve të hapësirës, secila e krijuar për të përjashtuar në shkallë të ndryshme :

- Hapësira e fshehtë', e cila është e kamufluar ose e errësuar nga ndryshimet në nivele ose objektet ndërhyrëse, dhe që në këtë mënyrë nuk mund të ndryshohet ;
- Hapësirë e rrëshqitshme ', e cila është e vështirë të arrihet për shkak të mjeteve të shtrembëruara, të tej zgjata të aksesit ose shtigjeve që mungojnë ;
- "Hapësirë e ndryshkur", në të cilën hyrja është ndaluar për shkak të pengesave të tilla si muret, portat dhe pikat e kontrollit ;
- Hapësirë me gjemba 'e cila është e vështirë dhe e papërshtatshme për t'u zaptuar, për shembull vendet e krijuara për të qenë të paretshëm dhe dekurajojnë qëndrimin për një kohë të gjatë, ose parvazat që janë të pjerrëta në të cilat nuk mund të ulesh ;

•Hapësirë nervoze 'që monitorohet në mënyrë aktive dhe që nuk mund të përdoret pa u vrojtuar në mënyrë konstante nga të tjerë.

8- Në sajë të shkallës së përfshirjes-Malone (2002 : 158) përshtat nocionin e Sibley (1995) të hapësirave të hapura dhe të mbyllura në hapësirat e përcaktuara sipas pranimit të tyre të ndryshimit dhe diversitetit. Kështu, hapësirat e hapura kanë kufij të përcaktuar dobët dhe karakterizohen nga përzierja sociale dhe diversiteti (p.sh. Karnavalet, festivale, parqe publike), ndërsa hapësirat e mbyllura kanë kufij të përcaktuar fuqishëm dhe përjashtojnë në mënyrë aktive objektet, njerëzit dhe aktivitetet që nuk përputhen (p.sh. Kisha, disa qendrat, shkollat). Këto të fundit gjithashtu janë angazhuar fuqishëm me mirëmbajtjen dhe përcaktimin e kufijve.

9- Nga klientela- Burgers (1999) e klasifikon hapësirën si një seri peisazhesh që formojnë fushat e sektorëve të ndryshëm socialë ose grupeve të interesit :

- hapësirë e ngritur publike - peizazhe me potencial të shpejtë ekonomik dhe qeveritar;
- hapësira e shfaqjes - peizazhe të tundimit dhe joshjes;
- hapësirë e lartësuar - peizazhe të entuziazmit dhe ngazëllimit;
- hapësirë e ekspozuar - peizazhe të reflektimit dhe idealizimit;
- hapësirë me ngjyra - peizazhe të imigrantëve dhe pakicave;
- hapësira e marginalizuar - peizazhet e devijimit dhe privimit.

10- Në terma të ndërveprimit midis hapësirës dhe përdoruesve- Dines dhe Cattell (2006 : 26-31)përdorin angazhimin social me hapësirën dhe perceptimin e saj si një mjet për të identifikuar pesë kategori, edhe pse këto nuk janë domosdoshmërisht reciprokisht përjashtuese :

- Vendet e përditshme – gama e hapësirave të lagjeve që përbëjnë pjesën më të madhe të sferës publike dhe vendin e përditshëm për ndërveprim ;
- Vendet domethënëse - që ndryshojnë nga personi në person dhe që lidhen me ngjarje dhe domethënie kundrejt hapësirave të vecanta, si pozitive dhe negative ;
- Mjedise sociale - që me anë të projektimit dhe përdorimet e tyre aktive nxisin takime sociale ndërmjet përdoruesve
- Vendet e veçuara - që ofrojnë një mundësi për njerëzit që të jenë vetëm me mendimet e tyre apo për të bisedojnë në grupe të vogla me miqtë ;
- Hapësirë negative - aspekte të sjelljeve antisociale, duke përfshirë edhe racizmin dhe aktivitetet shkatërruese që shpesh perceptohen si kërcënuese.

11- Sipas karakterit fizik dhe morfologjik- Sitte (1889) sheshet e gjera, të Zucker-së (1959) të mbyllura, të dominuara, nukle, sheshe të grupuara dhe amorfe, deri tek përpjekja më e

sofistikuar e vellezerve Krier për një klasifikim mbi tipologjinë e hapësirave publike (Papadakis dhe Watson, 1990).

12- Sipas funksionit- Gehl dhe Gemzøe (2000 : 87) klasifikojnë hapësirat e reja të qyteteve në pesë lloje kryesore :

- sheshin kryesor të qytetit
- sheshet rekreative
- shëtitore
- sheshet e trafikut
- sheshet monumentale

Ndërsa Carr et al. (1992: 79) identifikon njëmbëdhjetë lloje të hapësirave:

- Parqe publike
- Sheshe
- Memoriale
- Markete
- Rrugë
- Hapësira për të luajtur
- Hapësira të hapura për komunitetin
- Rrugë të gjelbëruara parqesh
- Atriume/markete hapësira të brendshme
- Hapësirat e përditshme
- Shëtitore në breg të detit



Figure 2: Ilustrim grafik I hapësirës publike (Burimi: Interneti)

Duke analizuar të gjithë konceptet e mësipërme mbi atë çfarë përfaqëson hapësira publike, më poshtë është paraqitur një tabelë përmbledhëse mbi përcaktimet e saj duke i kategorizuar ato në grupe të ngjashme:



1-Nga një pikepamje sociologjike	2-Nga përvoja hapësimore	3-Ne terma të marrëdhënieve të pushtetit	4-Si një rrugetim nga vizioni dhe realiteti	5-Sipas funksionit	6-Ne terma të pershtatshmerise ne perdorim
<p>H.p. percaktohet si "hapësirë dyistike", një hapësirë e marrëdhënieve jopersonale dhe abstrakte dhe si një antitezë e qëllimshme e hapësirave 'proksemike' që kontrollohen nga kultura</p> <p>Staehele, L &amp; Mitchell, D Hapësira publike nuk është e njëjtë me pronën publike. Në të vërtetë, cilësia e te qenit publike konsiston në marrëdhëniet e vendosura midis pronës dhe njerëzve që banojnë, përdorin dhe krijojnë pronën.</p> <p>Orum, A &amp; Neal, Z Hapësira publike përfshin të gjitha fushat që janë të hapura dhe të arritshme për të gjithë anëtarët e publikut në një shoqëri, në parim dhe jo domosdoshmërisht në praktikë</p>	<p>H.p. identifikohet në tre lloje:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• 'Pronë publike': shteti posedon hapësirën</li> <li>• 'Semiotike': e përbërë nga identitete hapësimore që inkurajojnë konkurrencën</li> <li>• 'Sferë publike': hapësira e komunitetit, ku qytetarët mund të bashkëveprojnë në mënyrë shoqërore ose politike.</li> </ul> <p>Shoqata Amerikane e planifikimit Një vend grumbullimi ose pjesë e një lagjeje, në qendër të qytetit, një zone e vecuar ose zona të tjera brenda sferës publike që ndihmojnë në promovimin e bashkëveprimit shoqëror dhe një ndjenje të komunitetit.</p> <p>Scruton, R Është një hapësirë në të cilën dikush mund të hyjë, dhe nga e cila dikush mund të largohet, pa pëlqimin e të huajve, dhe pa ndonjë deklaratë - sado të heshtur - me një qëllim justifikues.</p>	<p>Të gjitha hapësirat janë njeheresh publike dhe private dhe përbajnë kufizime, qofshin keto aksesit ose aktiviteti, të qarta ose të nënkuptuara.</p> <p>Lofland, L. Përfshinë një larmi të lidhjeve juridike midis publikut dhe hapësirës.</p> <p>Kohn, M H.p. i referohet një vendi që është në pronësi të qeverisë, i arritshëm për të gjithë pa kufizime që nxit komunikimin dhe ndërveprimin.</p> <p>Madanipour, A Duke përdorur kriteret e aksesit, kontrollit dhe interesit, një hapësirë mund të konsiderohet publike nëse kontrollohet nga autoritetet publike, i perket të gjithë njerëzve në tërësi, është e hapur ose e disponueshme për ta, dhe përdoret nga të gjithë anëtarët e një komuniteti.</p> <p>Jackson, J.B. Një vend publik percaktohet zakonisht si një vend (ose hapësirë) i krijuar dhe mirëmbajtur nga autoriteti publik si dhe i arritshëm për të gjithë qytetarët për përdorimin dhe kënaqësinë e tyre.</p>	<p>H.p. ndahet midis 'hapësirës përfaqësuese' (hapësirës së përvetësuar, të jetuar ose hapësirës në përdorim) dhe 'përfaqësimeve të hapësirës' (planifikuar, kontrolluar dhe porositur). Në këtë kuptim, hapësira shihet si një kronologji, që zhvillohet dhe ndryshon me kalimin e kohës.</p> <p>Mensch, J Hapësira publike "është hapësira ku individët shohin dhe shihen nga të tjerët ndërsa merren me punët publike. Është, pra, hapësira e mbledhjes së komunitetit, kuvendi ligjvënës ose ndonjë nga vendet e tjera ku kryhet biznesi publik</p> <p>Mitchell Hapësira publike është një arenë politike, dhe në rastet më ekstreme është luftuar në mënyrë aktive nga grupe me vizione ideologjike në dukje të pakonkurueshme, në lidhje me natyrën dhe qëllimin e hapësirës publike.</p>	<p>H.p. përfaqësohet nga pesë lloje kryesore</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>-sheshin kryesor të qytetit,</li> <li>- sheshet rekreative,</li> <li>- shëtitore,</li> <li>-sheshet e trafikut</li> <li>-sheshet monumentale</li> </ul> <p>Carr, S et. Al. Një zonë e përbashkët ku njerëzit kryejnë aktivitete funksionale dhe rituale që lidhin një komunitet.</p> <p>Gehl, J. &amp; Gemzöbe, L. Hapësira publike ka shërbyer gjithnjë si vend takimesh, tregtie dhe qarkullimi.</p>	<p>Lirëshmeria dhe ngushtësia e hapësirës janë kushte të lidhura, që dalin nga një lidhje e veçorive fizike dhe sociale të një hapësire.</p> <p>Low, S Hapësirat publike janë arena të rëndësishme për ligjërimin publik dhe shprehjen e pakënaqësisë.</p> <p>Goodsell, C.T Hapësira është kohe për ligjërimin politik. Me këtë frazë nënkuptoj aftësinë për një proces njerëzor të lidhur dhe ndërveprues të përvojës komunikuese.</p>

Table 1. Kategorizimi i përcaktimeve të hapësirës publike (Burimi: Autori)

#### 1.4 Roli i hapësirës publike në sferën publike

*"Një qytet i mirë është si një festë e mirë –  
njerëzit qëndrojnë më gjatë seç duhet vërtet, sepse  
ata po shijojnë momente të këndshme"*

- Jan Gehl

Një qytet i mirë duhet të jetë si një teatër i jetës publike dhe jo vetëm një makineri prodhimi. Hapësira publike ndihmon për të rigjeneruar jetën ekonomike dhe sociale të qytetit por për ta arritur këtë së pari duhet të jetë komferte, e sigurt dhe miqësore për këmbësorët. Padyshim që hapësira publike është karakteristika kryesore e çdo qyteti apo qyteze ose të pakten një komuniteti të ngjashëm me të, i cili është mjaftushëm tolerant për të lejuar lirinë e shprehjes. Hulumtimet e fundit në fushën e studimeve urbane kanë treguar se në qytetet moderne hapësira publike luan një rol të rëndësishëm për të krijuar ndjesinë e komunitetit (Boyer, 1994; Hayden, 1995).

Roli i hapësirës publike është i gjithanshëm dhe kap shumë sfera të jetës së qytetit ku më kryesorët janë:

##### ► Ekonomik

-Mund të ketë një ndikim pozitiv në çmimet e pronave – siç sugjerojnë raporte të ndryshme, ku shifrat e rritjes së çmimit variojnë nga 5% (Colin Buchanan dhe partnerët 2007) 8% (Luttik 2000) dhe 15 % (Peiser dhe Schëann 1993) ose madje deri në 34 % në disa rrethana të veçanta (CABE 2005a);

-Është e mirë për biznesin - duke rritur tregtinë deri në 40% (DoE dhe ATCM 1997);

-Ngre vlerën e tokës dhe nivelet e investimeve (Luther dhe Gurhin2001; Phillips 2000);

-Ndihmon në rritjen e performancës ekonomike rajonale (Frontier Ekonomi2004).

##### ► Për shëndetin e njeriut

-mund të inkurajojë stërvitjen, e cila sjell përfitime shëndtësore – për shembull zvogëlon rrezikun e atakut kardiak (Hakim 1999 ; Grupi i Parandalimit të Diabetit2002 ; Slattery, Potter and Caan 1997 ; Grisso, Kelsey dhe Stom1991) ;

-mund të ndikojë në një jetë më të gjatë (Takano et al. 2002) ;

-siguron një hapësirë për sporte dhe lojëra në grup ose të vetëm (Woolley2003; Eoolley and Johns 2001);

-zvogëlon stresin dhe rrit shëndetin mendor (Hartig et al. 2003; Halpern 1995);

-rrit shëndetin e fëmijëve - për shembull duke ndihmuar prindërit të kujdesen për fëmijët me aftësi të veçanta (Taylor et al. 2001).

► *Social*

-I jep përfitime të mësuarit të fëmijëve nëpërmjet lojrave krijuese (Fjortoft 2001; Taylor et al. 1998);

-ushqen aftësi sociale dhe njohëse (Pellegrini dhe Blatchford 1993) ;

-mund të ndihmojë në zvogëlimin e incidenteve kriminale dhe sjelljes antisociale (McKay 1998; Conolly 2002; Painter 1996; Loukaitou-Sideris et al. 2001; CABE 2005b);

-promovon fqinjësinë dhe kohezionin shoqëror (Baulkëill 2002; Massey 2002; Quayle dhe Driessen van der Lieck 1997; Kuo et al.1998; Appleyard 1981);

-siguron një vend për ngjarje sociale (Schuster 1995) ;

-zvogëlon vdekshmërinë - duke shmangur mjediset e mbizotëruara nga makina (Living Streets 2001 ; Maconachie and Elliston 2002) ;

-siguron një vend për shkëmbim shoqëror dhe për të mbështetur jetën sociale të komuniteteve (Mean and Tims 2005; Dines and Cattell) 2006; Jones et al. 2007; Eatson 2006).

► *Mjedisor*

-mund të inkurajojë përdorimin e mënyrave të qëndrueshme të transportit (Gehl dhe Gemzøe 1996; 2000);

-përmirëson cilësinë e ajrit, zvogëlon efektet e ishullit të nxehtësisë, ndotjen

-rrjedhja e ujit (Littlefair et al. 2000; Whitford et al. 2001; Shashua-Bar dhe Hoffman 2000; Upmanis 2000);

-krijon mundësi për lulëzimin e jetës urbane (Shoard 2003).

Siç e shohim më sipër hapësira publike ka një fushë ndikimi shumë të gjerë duke u kthyer kështu në suport, lehtësim dhe nxitës i jetës urbane si një vend shkëmbim ekonomik, si një promotor i rritjes së cilësisë të jetesës dhe si vendi kryesor ku mund të krijohet kohezion social midis individëve të një shoqërie.

*Gehl & Gemzøe 2000, p. 7, thekson rëndësinë e hapësirës publike në peisazhin urban: "... Rryma filloi të kthehet rreth vitit 1970. Modernizmi filloi të sfidohet dhe debati publik mori çështjen e cilësisë urbane dhe kushtet për jetën në qytet, ndotjen dhe copëtimin e shpejtë të makinave në rrugët dhe sheshet urbane. Hapësira publike dhe jeta publike u rivendosën si*

objekte të rëndësishme të debatit dhe trajtimit arkitektonik, ndër të tjera. Arkitektura e hapësirës publike ka qenë nën zhvillim të vazhdueshëm që nga ajo kohë dhe një numër shumë i madh i hapësirave publike të reja ose të rinovuara të cilat u krijuan në tremujorin e fundit të shekullit të 20-të.”

*Thomas (1991)* zgjerohet edhe më tej në analizën e rolit të hapësirës publike dhe thekson se “hapësira publike është një arenë thelbësore që siguron mundësi që individët dhe komunitetet të zhvillojnë dhe pasurojnë jetën e tyre ”(fq. 222).

Ai identifikon katër role të rëndësishme për hapësirën publike:

- i) si një arenë për jetën publike;
- ii) si vend takimesh për grupe të ndryshme shoqërore;
- iii) si hapësirë për shfaqjen e simboleve dhe imazheve në shoqëri;
- iv) si pjesë e sistemit të komunikimit ndërmjet aktiviteteve urbane (fq. 210).



*Figure 3. Ndikimi I hapësirës publike (Burimi: autori)*

Crowhurst-Lennard (1995) argumentojnë se “hapësira publike urbane është elementi i vetëm, më i rëndësishëm për të ndërtuar një qytet të jetueshëm”. Nga studimi i tyre në qytetet Europiane ata konstatojnë se hapësirat publike cilësore, sigurojnë akses të thjeshtë për të gjithë shërbimet apo varietetin e aktiviteteve që ofrojnë, nxisin ndjesinë e vetëvlerësimit dhe përkatësisë, rrit interesin dhe përkujdesjen ndaj mjedisit dhe siguron kontaktin social.

### **1.5 Natyra e hapësirës publike të hapur**

Shpesh herë është e veshtirë të bëhet një përshkrim i qartë mbi ndryshimin midis hapësirës publike të mbyllur dhe hapësirës publike të hapur si dhe fushën e ndikimit që ushtron secila prej tyre në jetën urbane. Në përballemë në jetën tonë të përditshme me hapësirat publike të llojeve të ndryshme dhe me një vështrim të thjeshtë mund të konstatojmë se hapësira publike e hapur perbënë pjesën më të madhe në tërësinë e hapësirës publike të qytetit. Këto hapësira mund të jenë të tipologjive më të ndryshme si përshembull rrugët të cilat shërbejnë si një

paradigm e hapësirës publike të hapur, sheshet kryesore të qytetit apo sheshet e dedikuara publikut nëpër lagje të ndryshme. Por natyra e hapësirës publike të hapur perceptohet në forma të ndryshme në vende me kontraste të forta kulturore. Nëse do ti referohemi, si shembull, tipologjisë në SHBA është mëse normale që hapësira publike zakonisht të jetë e zotëruar nga ndërtesa që e kufizon dhe të përdoret kundrejt pagesës, ndërsa në vende të tjera, kryesisht Europiane, hapësira publike është e stigmatizuar me pronësinë e publikut, pra të përdoret në mënyrë të lirë nga kushdo. Një nga dokumentet më të rëndësishme urbane të krijuar ndonjëherë në Europë, ku kodifikohej përbërja e hapësirës publike, është harta e Romës, e krijuar më 1748 nga Giambattista Nolli. Nolli zbuloi kufijtë e hapësirës publike duke I trajtuar hollet, gjykatat dhe hapësirat e brendshme të ndërtesave publike njësoj me rrugët dhe sheshet e qytetit. Si atëherë dhe në ditët e sotme hapësira publike nuk është homogjene, por e dualizuar midis privates dhe publikes, të hapurës dhe të mbyllurës.

*Gjithsesi pjesë e studimit të kësaj teze do të jenë vetëm hapësirat publike të hapura të cilat përfshijnë shumëllojshmërinë e hapësirave brenda mjedisit urban që janë lehtësisht të aksesueshme për komunitetin dhe përdoren për rekreacion.*

Studiues të fushave të ndryshme të planifikimit urban, si një proces i zhvillimit dhe dizenjimit të hapësirave urbane, theksojnë se janë rrugët, sheshet, parqet dhe hapësira të tjera urbane të cilat kanë potencialin për tu shndërruar në “skenën në të cilën zhvillohet jeta e përditshme” (Carr et. Al, 1992).

Hapësira publike ofron mundësi të ndryshme për kontakte sociale ku, siç thekson Sennett, krijohet mundësia për zhvillimin e individëve:

*« Sepse nëse pikat e shumta të kontaktit shoqëror, mund të rigjenerohen nën kushte të përshtatshme për te arritur ndikimin, atëherë disa hapësira do të jenë përsëri të mundura për njerezit. Premtimi i madh i jetës së qytetit është një lloj i ri konfuzioni, i mundshëm brenda kufijve të tij, një anarki që nuk do të shkatërrojë njerëzit, por do t'i bëjë ata më të pasur dhe më të pjekur. » (Sennett, 1971, 108)*

Oldenburg dhe Brissett (1980) gjithashtu mbrojnë idenë për vende të tilla si një terren i përbashkët, një nivel i një shoqërie polarizuese. Ata theksojnë se:

*“Kontakti social është i rëndësishëm për atë që simbolizon; një lloj shoqërie e pastër dhe e lirë, e pa kontaminuar nga statusi, qëllimet apo objektivat e veçanta.” (Oldenburg dhe Brissett, 1980, 82)*

Në një analizë mbi hapësirën publike, Carr et al. (1992) ka përpiluar një listë të tipologjive të hapësirave publike kontemporane të hapura. Autori sugjeron se këto hapësira të ndryshme urbane furnizojnë nevoja të ndryshme fizike dhe sociale të funksioneve njerëzore duke përfshirë komfortin, relaksin, ndërveprime pasive ose aktive dhe zbulime të reja. Duke patur parasysh karakteristikat e tyre si lloji, aksesit dhe përdorimi, këto hapësira kanë mundësinë që të përmbushin një ose më tepër prej aspekteve të përmendura më sipër.

Në fakt, hapësira publike, ashtu siç përjetohet sot, është një rezultat i:

- Tendencave dhe normave historike, të cilat datojnë në botën antike
- Mënyrave të ndryshme të qeverisjes, rregullit, sundimit ligjor dhe investimeve nën të cilat është krijuar
- Traditave kulturore
- Prioriteteve politike dhe mënyrave të veçanta të jetesës që ato mbështesin;
- Ekuilibrit midis politikave dhe forcave të tregut që rrit kompleksitetin e hapësirës publike dhe kufizimet në aftësitë dhe përgjegjësitë profesionale për të zgjidhur këtë (Carmona, Public space, f.60).

### **1.6 Struktura e studimit dhe objektivat**

Në pikat e mësipërme është tentuar të krijohet një koncept sa më i qartë mbi atë çfarë përfaqëson hapësira publike në nivelin e jetës urbane. Ky studim është i mbështetur plotësisht në të dhëna empirike të grumbulluara nga kontakti i drejtëpërdrejtë me hapësirën publike. Duke u mbështetur në një studim të hollësishëm të literaturës mbi këtë fushë, synohet që të bëhet një analizë e hollësishme mbi të gjitha karakteristikat e hapësirës publike për të arritur në këtë mënyrë, ndërtimin e një modeli vlerësimi të hapësirës publike. Pyetja themelore e këtij studimi është: *Si mund të arrihet në një metodologji praktikë vlerësimi / studimi për hapësirën publike publike e cila analizon të gjitha karakteristikat e saj dhe mund të jetë e aplikueshme për tipologji të ndryshme?*

E thënë hap pas hapi, ky proces konsiston në:

- ▶ Krijimin e një përkufizimi sa më të qartë për atë çfarë përfaqëson hapësira publike në këtë studim
- ▶ Kuptimin e mënyrës sesi funksionon hapësira publike. Në këtë pikë do të përmbledhim një analizë tepër të hollësishme të literaturës ndërkombëtare mbi këtë temë.

► Përkthimin e të gjitha gjetjeve të kësaj analize në skema të ndërlidhura me njëra tjetrën të cilat së bashku do të krijojnë metodologjinë e cila do të përdoret për studim duke e ndarë hapësirën, sipas karakteristikave dhe ndikimit të saj në dy lloje: positive dhe negative.

► Aplikimin e kësaj skeme në raste konkrete të tipologjive të ndryshme të hapësirës publike, duke testuar kështu efektshmërinë e saj për situata të ndryshme urbane që mund të merren në studim.

► Së fundi rezultatet do të na japin mundësinë të arrijmë në terma konkretë, nëse një hapësirë publike është positive apo negative, nëse ajo e kryen funksionin themelorë të saj, kohezionin social apo jo. Mbi bazën e rezultateve mund të bëhen edhe rekomandime se cilat do të ishin ndërhyrjet që mund të propozohen për të përmirësuar problematikat e çdo rasti të marr në studim.

### **1.7 Kontributi për të ardhmen e studimit**

Nëse duam të përmirësojmë cilësinë e përgjithshme të qytetit duhet ta nisim patjetër me elementet thelbësor të tij. Në konglomeratin e objekteve fizike që e formojnë atë, hapësira publike perfaqëson entitetin social, duke u bere kështu ura lidhëse e boshllëkut midis qytetit dhe funksionimit të tij si arenë sociale. Në këtë mënyrë, kjo tezë, filimisht heton në mënyrë deduktive esencën e hapësirës publike, duke u nisur nga literatura në dispozicion mbi këtë temë për të arritur kështu në elementet kyç që kristalizojnë funksionimin e saj. Studimi jep si produkt modelin e gjysmë rrethit për të analizuar funksionimin e hapësirës publike, duke vendosur kështu në dispozicionin e kujt do, një mjet lehtësisht të kuptueshëm dhe të thjeshtë për tu përdorur në këtë fushë. Janë të shpeshta rastet kur hapësira publike përveç rasteve që ndodhet në një gjëndje të keqe fizike por edhe në raste kur bëhen ndërhyrje për përmirësimin e saj, vazhdon të mos funksionoj si e tillë, pasi nuk krijon kohezion social. Me metodën e krijuar për analizimin e saj do të mund të gjenden shkaqet e problemit dhe të arrihet në ndërhyrjen e duhur, duke përfshirë në këtë proces jo vetëm profesionistë por edhe përdoruesit e thjeshtë të saj.

Modeli krijon një seri standartesh bazë për procesin e planifikimit dhe projektimit për zhvillimin e tokave dhe hapësirës për të ardhmen, duke u kthyer në suportin kryesor vendimmarrës në rrugën drejt krijimit të hapësirave publike me zhvillim të qëndrueshëm. Modeli duke u ndërtuar mbi të dhëna objektive dhe gjithëpërfshirëse, përshkruan, mat dhe në fund vlerëson hapësirën publike, duke e paraqitur të gjithë procesin grafikisht të kuptueshëm nga kushdo. Kjo metodë paraqet një risi në këtë fushë, pasi studimet e mëparëshme ishin konfuzë, kishin një erozion në përdorimin e termave, pa pasur në fund nuk jepnin një rezultat

konkret dhe lehtësisht të kuptueshëm. Në këtë aspekt, modeli i gjysmë rrethit funksionon si një audit i hapësirës publike duke nxjerr konkluzione konkrete se cilat veprime duhen ndërmarrë për të ndërhyrë në rregullimin dhe përmirësimin e saj për të shmangur në këtë mënyrë denigrimin e cilësisë së saj.



## **KAPITULLI 2: Shqyrtimi i Literaturës**

### **2.1 Hyrje**

Procesi I hulumtimit të literaturës e ka bazën e vet në tre hapa kryesor, ku fillimisht nisim me ekspolorimin e shumëllojshmërisë së informacioneve që janë publikuar në lidhje me temën studimore, më pas leximi në mënyrë analitike për të nxjerr konkluzione dhe në fund implementimi i tyre në dobi apo funksion të studimit.

Në rastin e kësaj teze, si fillim, për të arritur në thelbin e analizës, duhet të qartësohen të gjitha konceptet bazë mbi të cilat është ndërtuar ky studim. Kapitulli i dytë është i përqëndruar tërësisht në një studim literature mbi hapësirën publike së bashku me të gjitha elementet përbërëse të saj, fushat e ndikimit dhe qasjen e përdoruesve ndaj saj. Si i tillë, ky kapitull synon të kuptojë se si është përcaktuar hapësira publike në shkrimet kryesore të kësaj fushe, duke u përqëndruar jo vetëm në studimet mbi hapësirën bashkëkohore por edhe në zhvillimin historik. Nëpërmjet hulumtimit të koncepteve bazë mbi këtë temë dhe analizimit të tyre, do të konkludohet në gjetjen e cilësive kryesore të hapësirës publike dhe elementeve të cilat ndikojnë në qasjen e tyre. Kapitulli është i organizuar në pesë pika kryesore. Pas hyrjes, pjesa e parë paraqet një hulumtim mbi esencën e hapësirës publike. Pjesa e dytë zhvillohet mbi një analizë ndërdisiplinore mbi semantikën e “vendit” dhe “hapësirës”, duke analizuar kuptimin leksikor të tyre në raport me hapësirën publike. Pjesa e tretë lidhet me tërësinë e metafizikave që përbëjnë natyrën e hapësirës publike duke nxjerr në pah ontologjinë e saj. Pjesa e katërt bën një kategorizim të llojeve të hapësirave publike, të analizuar në këndvështrime të ndryshme, si nga cilësitë fizike ashtu edhe nga kohezioni social. Në përmbledhje të pikave të mësipërme, kapitulli mbyllet me një pikë gjithë përfshirëse sic është socializimi si roli primar I hapësirës publike.

### **2.2 Cfarë e përbën hapësirën publike?**

*“Së pari jeta, pastaj hapësira, pastaj godinat- mënyra e kundërt nuk funksionon kurrë”*

*Jan Gehl*

Në shumicën e opinionit publik është krijuar perceptimi se cilësia e hapësirës publike po shkon drejt përkeqësimit. Megjithëse ky perceptim është I saktë në shumicën e rasteve, vlen për tu përmendur se ekzistojnë edhe disa hapësira publike cilësore përsa I përket kushteve fizike. Por problemi kyç qëndron nëse këto hapësira funksionojnë si hapësira publike apo jo. Për të arritur

në këtë deduksion fillimisht duhet të njihemi në menyrë të imtësishme me esencën e hapësirës publike, pra me elementet bazë mbi të cilët ndërtohet. Në një qasje morfologjike mbi karakterin e hapësirës publike, Carmona et al.2003, konstaton se hapësira publike përbëhet nga katër element kryesor:

1. Ndërtesat
2. Mobilimi urban
3. Infrastruktura
4. Përdoruesit

<b>Ndërtesat</b>	<b>Infrastruktura</b>	<b>Mobilimi urban</b>	<b>Përdoruesit</b>
•Mure	•Rrugët dhe korsitë e	•Pemët	•Evente
•Strukturat	bicikletave	•Sipërfaqjet	e •Grumbullime
•Dritare	•Ndalesat e autobuzëve	gjelbëruara	•Argëtim rrugor
•Hyrjet/Daljet	•Linjat e tramit	•Lëndinat	•Biznese
•Ballkonet	•Pajisjet e	•Bimësi e varur	•Hapësira për të
•Fasadat		•Trotuare	konsumuar ushqim
•Sinjalet	telekomunikacionit	•Rrugët	•Kioska
•Ndricimi I ndërtesave	•Ndricimi rrugor	•Sinjalistika rrugore	•Hapësira për të luajtur
•Arti I rrugës	•Parkimet	•Shatërvane/Basene	•Parqe
•Dekorimet	•Tualetet publike	ujore	•Shërbime
•Tendat	•Kosha	•Arti publik	•Hapësira për të kaluar
•Kolonadat	•Survejimi me kamera	•Reklama	kohën
•Skyline/roofscape	•Kuti postare	•Mobilimi rrugor	•Përdorime të
•Qoshet	•Kanalizimet	•Vende për tu ulur	komunitetit
•Flamuj dhe Banera		•Dekorime festive	•Banesa
•Monumente			•Vende pune
			•Përdorime industriale
			•Turizëm

*Table 2. Kategorizimi I elementëve përbërës të hapësirës publike (Burimi: Carmona et al. - Public Places - Urban Spaces\_ the Dimensions of Urban Design-Architectural Press (2003))*

Siç e shohim në tabelën 2, tre ndarjet e para, pra ndërtesat, infrastruktura dhe mobilimi urban janë elemente solid fizik të cilët kanë një ndryshueshmëri shumë të ulët me kalimin e kohës. Në anën tjetër përdorimet janë shumë elastike dhe specifike në funksion të tre kategorive të tjera publike duke çuar kështu drejt një disbalance të komponenteve për një funksionim normal

të saj. Duke iu referuar Carmonas (Public space-the management dimension, fq.11) do të kemi një listë të gamës së gjerë të veprimtarive apo elementëve funksional që ndodhin në këto hapësira: si dhe kanë një ndryshueshmëri shumë të madhe me kalimin e kohës, pothuajse të përditshëm. Secila prej kategorive akomodon funksione të llojeve dhe nevojave të ndryshme duke bërë kështu që në disa raste një prej tyre të dominoj më tepër në përdorimin e hapësirës:

1. Sipërfaqe për kalimin e këmbësorëve
2. Arterie trafiku
3. Destinacione komerciale
4. Markatë
5. Shërbime civile
6. Vende për t'u relaksuar
7. Vende për të diskutuar
8. Vende për takime miqësore apo politike
9. Vende për të realizuar shkëmbim kulturor
10. Mundësi për vende parkimi
11. Pikë takimi midis fushës publike dhe asaj private
12. Vende për ndërveprim social
13. Shërbime
14. Hapësira për të luajtur
15. Vende për konsumuar ushqim ose pije
16. Arterie të transportit publik
17. "Kontenier" të peisazhit
18. Burime informacioni dhe komunikimi
19. Mundësi për të krijuar shërbime
20. Ndalesa për të pushuar

*Siç shihet më sipër, hapësira publike është një konglomerat elementesh statik dhe dinamikë, ku elementët dinamikë janë në funksion të prezencës të elementëve statik, duke bërë të mundur funksionim e saj.*

### 2.3 Semantika e “vendit” dhe “hapësirës”

“Vend” dhe “Hapësire” janë dy fjalë të cilat i përdorim përditë dhe bartin një shumëllojshmëri përdorimesh, kuptimesh dhe nënkuptimesh në fusha të ndryshme. Në pamje të parë duket sikur këto dy terma kanë përafërsisht të njëjtin përdorim për shkak edhe të erozionit në përdorim të ndodhur me kalimin e kohës por nëse do të jepnim një përkufizim të qartë shkencor do të kuptojmë se këto dy terma perfaqësojnë koncepte krejt të ndryshme, ndërkohë që përdorimi i tyre qëndron në një marrëdhënie të ndërsjelltë me njëra tjetrën.

Sipas Eric O. Jacobsen, në një definicion filozofik, *vendi* është “nje koncept specifik për kontekstin, i pasur me shumë kuptime”. Është një kontekst i cili mbart kujtime personale, eksperiencia dhe ndjesi të lidhura me të. Ndërsa *hapësira* është një koncept më abstrakt sesa vendi. Hapësira është një lloj BLANK SLATE/TABULA RASA – një vendndodhje fizike e cila duhet të ngjyroset me eksperiencia personale. Ndërsa vendet vazhdimisht krijojnë dhe formojnë identitetin tonë, hapësirat na lejojnë të ekzaminojmë idenitetet e krijuara.

Ndër të tjera Jackson thekson, “Ndërsa një individ jeton jetën, narrativa fillon të lidh kuptime me një hapësirë të vecantë duke e kthyer atë në vend”.

Sipas filozofit Yi Fu Tuan, vendi është siguri, hapësira është liri: ne jemi të lidhur me njërin dhe dëshirojmë tjetrin.

Yi-Fu Tuan analizoi kuptimin e vendit dhe hapësirës. Sipas Tuan ndryshimi midis "hapësirës" dhe "vendit" mund të përshkruhet në masën në të cilën qëniet njerëzore i kanë dhënë kuptim një zonë specifike. Kuptimi mund të jepet apo të derivoj nga këto zona në dy mënyra, të cilat përkatësisht janë :

► Në mënyrë të drejtpërdrejtë dhe intime, për shembull përmes shqisave të tilla si shikimi, nuhatja dhe dëgjimi.

► Një mënyrë indirekte dhe konceptuale e ndërmjetësuar nga simbolet, artet etj. (Tuan, 1977, f. 6).

'Hapësira' mund të përshkruhet si një vend i cili nuk ka lidhje shoqërore për një qenie njerëzore. Asnjë vlerë nuk është shtuar në këtë hapësirë. Sipas Tuan (1977, f.164-165) ajo është një hapësirë e hapur, por mund të shenjohet dhe mbrohet kundër mësymjes (Tuan, 1977, f. 4). Nuk i fton apo inkurajon njerëzit të mbushin hapësirën duke qenë krijues. Asnjë kuptim nuk i është bashkëngjitur asaj. Është më shumë ose më pak abstrakte (Tuan, 1977, f.6).

'Vendi' në kundërshtim me konceptin e hapësirës, më shumë sesa thjesht një vendndodhje mund të përshkruhet si një vend i krijuar nga përvojat njerëzore. Madhësia e kësaj vendndodhje nuk ka rëndësi dhe është e pakufizuar. Mund të jetë një qytet, lagje, një rajon apo edhe një klasë etj. Në fakt 'vendi' ekziston prej 'hapësirës' që është e mbushur me kuptime dhe objektiva nga përvojat njerëzore në këtë dimension të veçantë. Vendet janë qendra ku njerëzit mund të plotësojnë nevojat biologjike siç janë ushqimi, uji etj. (Tuan, 1977, f. 4). Sipas Tuan (1977, f. 6) një "vend" nuk ekziston me kufij të vëzhgueshëm dhe është një shprehje e dukshme e një periudhe kohore specifike. Shembuj janë artet, monumentet dhe arkitektura.

Tuan ishte i bindur se njerëzit japin ose derivojnë kuptime nga gjeografia e botës dhe organizojnë botën përreth tyre (Cloke, Philo & Sadler, 1991, f. 76-77). Kjo shpjegon gjithashtu se kuptimi që i japim "hapësirës" lidhet me distancën nga njeriu në këtë "vend" (Cloke, P., Philo, et al., 1991, f. 79). Sic Tuan (1977, f. 3) thotë: "hapësira është liri, vendi është siguri".

Gjeografi Edëard Relph, në një shkallë të madhe, ka të njëjtat ide si Tuan. Një shtesë që mund të thuhet është se Relph përshkruan marrëdhëniet midis njerëzve dhe vendeve të tyre si të shkëputura dhe në distancë, përmes të cilave njerëzit janë në gjendje të reflektojnë për këtë marrëdhënie (Cloke, Philo, et al., 1991). Në veprën e tij, Relph përpiket të ruajë lidhjen midis hapësirës dhe vendit dhe jo t'i prezantojë ato si koncepte të veçuara, pasi cilësia e vendit ka fuqinë për të nxitur dhe për të përqendruar qëllimet, përvojat dhe veprimet njerëzore në mënyrë hapësinore (Seamon & Soëers, 2008). *"Pra, hapësira dhe vendi janë të strukturuar dialektikisht në përvojën e mjedisit njerëzor, pasi të kuptuarit tonë të hapësirës ka të bëjë me vendet ku banojmë, të cilave ju derivon kuptimi nga konteksti hapësinor"* (Seamon & Soëers, 2008, f.44).

Teoria e vendit e Canter (1977) shton një tjetër dimension në psikologjinë mjedisore të sjelljes. Sipas Canter *vendi* përcaktohet dhe perceptohet nga karakteristikat fizike të tij, aktivitetet që zhvillohen në të dhe ndjesinë që njerëzit kanë kundrejt tij. Në dallim nga Tuan apo Relph, ky koncept i vendit nuk ndërthuret me cilësitë e vendndodhjes së tij. Përkundrazi ai "...Krijon mundësinë e një njësie studimi që mbart një miks procesesh të cilat krijojnë ekperiencën tonë në lidhje me elementet socio-fizike që na rrethojnë" (Canter, 1991, fq.118)

Për rrjedhojë, Canter sugjeron se mënyra sesi e perceptojmë vendin varet nga ajo çfarë ne bëjmë në këto vende dhe ndjesia që na shkakton.

Interesi në rritje i kohëve të fundit në lidhje me hapësirën është ilustruar në thënien e famshme të Foucault: "*Obsesioni i madh i shekullit XIX ishte, siç e dimë, historia [...] Epoka e tanishme do të jetë mbi të gjitha epoka e hapësirës.*" (Foucault, 1986; f. 22)

Më pas ai vazhdon: "*Sidoqoftë besoj se ankthi i epokës sonë ka të bëjë në thelb me hapësirën, pa dyshim shumë më tepër sesa me kohën. Koha ndoshta na shfaqet vetëm si një nga proceset e ndryshme shpërndarëse që janë të mundshme për elementët e përhapur në hapësirë.*" (Foucault, 1986; f. 23)

Gjeografi Italian, Franco Farinelli (2003), thotë se dy kuptimet e vendit dhe hapësirës mund të bëhen qartësisht të dallueshme nëse do ti referohemi Greqisë antike:

Vendi është një pjesë e sipërfaqes tokësore e cila nuk është e barabartë apo e ngjashme me asnjë pjesë tjetër të saj, e cila nuk mund të shkëmbehet pa e ndryshuar komplet atë. Ndërsa hapësira, mund të zëvendësoj pjesë të saj pa e ndryshuar esencën e vet, saktësisht si në rastin kur dy gjëra që kanë të njëjtën peshë zhvendosen nga njëra anë e një shkalle në tjetrën pa kompromentuar ekuilibrin.

Robert Sack (1997, 58) analizon qëllimin thelbësor kur ai shkruan se "korniza e tij" tërhiqet në përvojat gjeografike të vendit, hapësirës, shtëpisë dhe botës që njerëzit përdorin në jetën e tyre për të integruar forcat, perspektivat dhe vetveten".

Nga ky këndvështrim:

*Vendi* nënkupton hapësirë, dhe secila shtëpi është një vend në hapësirë. *Hapësira* është një pronë e botës natyrore, por që mund të përjetohet. Nga këndvështrimi i përvojës, vendi ndryshon nga hapësira sa i përket familjaritetit dhe kohës. Një vend kërkon prani njerëzore, është diçka që kërkon kohë për ta njohur, dhe një shtëpi po kështu. Ndërsa lëvizim përgjatë tokës ne kalojmë nga një vend në tjetrin. Por nëse lëvizim shpejt vendet do të mjegullohen; ne humbim gjurmët e cilësive të tyre, dhe ato mund të bashkohen në sensin që po lëvizim nëpër hapësirë (Sack 1997, 16).

Dallimi midis vendit dhe hapësirës është vetëm një mënyrë instrumentale e "vendosjes së rendit në gjëra"; kuptimet e "vendit" dhe "hapësirës" janë të hapura dhe të pafundme, që ndryshojnë nga personi në person, nga konteksti në kontekst dhe situata në situatë.

Doreen Massey shtron pyetjen (2005):

"Dhe çfarë nëse refuzojmë atë dallim, gjithçka duket tërheqëse, midis vendit (si kuptimplotë, të jetuar dhe të përditshëm) dhe hapësirës (si çfarë? E jashtme? Abstrakti? E pakuptimtë?)" (f. 6) mund të merret si provokim se asnjë kuptim nuk deshifrohet plotësisht dhe se ato janë në një ndryshim të vazhdueshëm.

"Hapësira është një koncept më abstrakt se vendi. Kur flasim për hapësirën, ne kemi tendencë të mendojmë për hapësirën e jashtme ose gjeometrine e hapësirave. Hapësirat kanë zona dhe vëllime. Vendet kanë hapësirë midis tyre." (Creswell, 2004, f. 8).

Nëse do ti referohemi fjalorit për një përcaktim të saktë shkencor vendi dhe hapësira janë :

Vendi :

- Hapësirë a sipërfaqe tokësore, tokë e kufizuar a pjesë toke që ka veçori të caktuara fizike e gjeografike ; truall ; zonë.
- Pjesë toke a pjesë e sipërfaqes tokësore (fushë, pyll, fshat, krahinë etj.), që ka diçka të veçantë ose që përdoret për diçka, hapësirë a sipërfaqe që shërben për një qëllim të caktuar, truall që caktohet për një punë ; pjesë hapësire ose sipërfaqeje tokësore ku është një njeri a një send, ku ka ndodhur diçka, për ku ka marrë drejtimin një lëvizje etj.
- Hapësirë a sipërfaqe ku është a ku duhet të jetë një njeri, një send etj., pjesë e një hapësire që zë dikush a diçka ; pjesa e hapësirës a e sendit ku rri dikush a mbahet diçka.

Hapësira :

- Shtrirje e pakufizuar në të gjitha drejtimet e përmasat ; shtrirje e gjerë brenda caqesh të caktuara, vend i hapët e i rrafshët, vend i gjerë e i lirë ; pjesë e madhe e sipërfaqes së tokës ose të ujërave.
- Zbrazëtia që ndan një send nga një tjetër, një pjesë nga e tëra etj. ; largësia ndërmjet dy pjesëve të diçkaje.

Më poshtë paraqitet tabela 2, e cila përmban tërësine e paradigmeve që i bashkangjiten kuptimit të vendit dhe hapësirës nga analiza e mësipërme, për të bërë kështu më të qartë dallimet dhe ngjashmëritë midis tyre :

<b>VENDI</b>	<b>HAPËSIRA</b>
Koncept specifik	Koncept abstrakt
Mbart kujtime/eksperienca/ndjesi personale	Tabularasa/ vendndodhje fizike që ngjyroset me eksperienca personale

Krijon/formon identitete	Ekzaminon identitete
Siguri	Liri
Krijohet nga përvoja njerezore	Distancë nga njeriu në një vend të caktuar
Mund të plotësoj nevoja biologjike	Ka të bejë me vendet ku banojmë
Nuk mund të ndryshoj formë pa ndryshuar esencën e vet	Mund të ndryshoj pjesë të vetat pa e ndryshuar esencën e saj
Shprehje të një periudhe kohore specifike	
I derivon kuptimi nga konteksti hapsinor	
Nuk ekziston me kufinj të vëzhgueshëm	

*Table 3. Krahasimi midis vendit dhe hapësirës*

*Nga analiza e mësipërme, nëpërmjet një deduksioni llogjik, vëmë re se vendi dhe hapësira janë dy koncepte realtivisht të ndryshme nga njëra tjetra por duke qënë dy elementet kyç të hapësirës publike qëndrojnë në një lidhje dialektike kundrejt tyre. Marrëdhënia e tyre është shkak-pasoja, vendi është shkak, hapësira pasoja.*

## 2.4 Ontologjia e hapësirës publike

*“Për të arritur thelbin e gjërave, të gjithë elementët jo thelbësorë duhet të eliminohen”.*

*Dr. Koichi Kawana*

Më sipër kemi diskutuar mbi aspekte të ndryshme të hapësirës publike. Duke parë se ajo është një fushë me spektër shumë të gjerë, atëherë natyrshëm shtrojmë pyetjen : *“Cili është thelbi i hapësirës publike ?”*. Në një qasje analitike për të kuptuar esencën e hapësirës publike, vëmë re se ekzistojnë një mori informacionesh dhe konceptesh të mbivendosura ndër vite nga studiues të ndryshëm duke dhënë një përkufizim jo të qartë mbi të. Kjo për shkak se në shumicën e rasteve, përcaktimet mbi hapësirën publike i japin prioritet kategorive të ndryshme që e përbëjnë natyrën e saj.

Sipas *Vikas Mehta (The Street-A quintessential public space, f.20)* përkufizimet e ndryshme të hapësirës publike bazohen mbi 4 dimensione:

- Pronësia



- Kontrolli
- Aksesi
- Përdorimi

Disa autorë tregohen tepër rigoroz në konstatimet e veta duke e përcaktuar hapësirën publike si “një hapësirë e cila nuk kontrollohet nga individë privat apo organizatë dhe është e hapur për të gjithë publikun” (Madanipour, 1996, 144).

Të tjerë shprehen “...hapësira të aksesueshme nga publiku për aktivitete individuale ose në grup”. (Carr et.al, 1992, 50)

Projekti për Hapësirën Publike (2000), bazuar në analizën e qindra hapësirave publike në të gjithë botën, konkludon se kërkohen katër karakteristika kryesore për një mjedis me cilësi të lartë:

- Akesi dhe ndërlidhja - e përshtatshme për t’u përdorur, e dukshme, e thjeshtë për t’u arritur dhe për të lëvizur brenda;
- Përdorimi dhe aktivitetet- duke dhënë një arsye për të qenë atje, jetike dhe unike;
- Komforti dhe imazhi - e sigurt, e pastër, jeshil, identitet dhe tërheqëse;
- Kohezioni social - nxitja e fqinjësisë, miqësisë, bashkëveprimit, diversitetit.

*Smith et al. (1997)*, bazuar në një analizë të gjerë mbi lloje të ndryshme të hapësirave publike, zhvilloi një listë të cilësive që duhet të plotësojnë mjediset e saj:

-Të jenë të jetueshme

-Identiteti i vecantë

-Ndërlidhja

-Levizshmëria

-Liria e individit

-Diversiteti

Ndërsa *Carr et al. (1992 : 87–136)* konkludon se ekzistojnë pesë kushte thelbësore të cilat duhet të plotësojnë një hapësirë publike për të bërë njerëzit të shpenzojnë kohë në të :

-Komforti - Me sigurimin e ushqimit, strehim nga kushtet e motit dhe vende të përshtatshme për tu ulur.

-Relaksi - Të siguroj një ndarje nga trafiku

-Të ofroj mundësinë e angazhimit pasiv me mjedisin - Sigurimi i lehtësirave që argëtojnë përdoruesit siç janë ngjarjet e planifikuara dhe të paplanifikuara, bimësia, burimet dhe elementët artistikë që mund të ofrojnë pika qendrore të interesit për soditje.

-Të ofroj mundësinë e angazhimit aktiv me mjedisin - Të disponoj kushtet e duhura të cilat nxisin kontaktin direkt midis përdoruesve.

- Zbulimi: Diferencimi hapësinor me elemente dekorative

Sipas tij, është e rëndësishme të ekzaminohen nevojat, jo vetëm sepse ato shpjegojnë përdorimin e vendeve, por edhe sepse përdorimi është i rëndësishëm për suksesin. Vendet që nuk plotësojnë nevojat e njerëzve ose nuk shërbejnë për funksione të rëndësishme për njerëzit do të jenë të nënpërdorura dhe të pasuksesshme. (Carr et al. 1992: 91–2)

Carr konkludon se funksionaliteti në vetvete nuk shpjegon praninë e njerëzve në hapësirat publike. Për të qenë të suksesshme, hapësirat publike gjithashtu duhet të përqafojnë cilësi të tjera, domethënë:

- Lehtësimin dhe lirinë e aksesit
- Lirinë e veprimit
- Territor hapësinor të diferencuar
- Ndryshim i vazhdueshëm për shkak të aftësisë për t'u përshtatur me tendencat e reja në shoqëri
- Pronësinë nga publiku.

Ndër studimet e shumta mbi hapësirën publike, *William White (1980)* thekson në vëzhgimin e tij empirike mbi hapësirën publike në New York, se një hapësirë publike e suksesshme duhet të plotësojë këto kushte:

- Të ndodhet në një pozicion të mirë -mundësisht pranë një rrugë me fluks të lartë qarkullimi si dhe të jetë vizualisht/fizikisht e aksesueshme.
- Rrugët duhet të jenë pjesë e hapësirës “Sociale”-ndarja e hapësirave nga rruga me barriera fizike do të izolonte ato dhe do të reduktonte përdorimin e tyre
- Hapësira duhet të jetë në të njëjtin nivel ose pothuajse e nivelit me trotuarin-hapësirat e ngritura dukshëm mbi ose nën kuotën e trotuarit ishin më pak të përdorura
- Duhet të ketë vende për t'u ulur - të integruara në dizajn (p.sh, shkallet, muret e ulëta, etj.) dhe të vecanta (p.sh, stolat, vendet, etj.)

■ Vendet e lëvizshme për tu ulur lehtësojnë mundësinë për të komunikuar

Midis të tjerëve, arkitekti Jan Gehl, argumenton që faktorët si :

- Forma
- Madhësia
- Ndërlidhja

•Disponimi I elementëve të ndryshëm në hapësirë dhe dizajni I tyre I detajuar janë vendimtar në krijimin e hapësirës publike cilësore dhe për rrjedhojë llojet e aktivitete njerëzore që do të zhvillohen në këto hapësira. Për më tepër këto janë të gjitha cilësi të dukshme dhe të prekshme fizikisht.

*Llewelyn Davies (2000 : 99-105)* konfirmon rëndësinë e një *ambienti cilësor*, duke argumentuar se një hapësirë publike *e rehatshme* dhe *stimuluese* kërkon veprimtari, me përdorime që lidhen me hapësirat publike në mënyrë të tillë që të rezultoj në *animacion, diversitet dhe elasticitet në përshtatje*. Hapësira publike duhet të stimuloj shqisat, vizualisht, por edhe me tinguj, prekje dhe nuhatje ; vende që kanë identitet dhe janë interesante, duke u bazuar në karakterin lokal ; vende pa rrëmujë, por që megjithatë shfrytëzojnë fuqinë e artit publik ; dhe vendet që janë të “lexueshme” përmes ndriçimit dhe shenjave të mira.

Planifikuesi urban amerikan, Kevin Lynch (1981) pas një serë studimesh mbi hapësirën publike, liston pesë kritere që duhet të përmbush një hapësirë publike, të cilat janë :

- Kontrolli
- Të përmbush qëllimet e përdoruesve
- Ndjesi pozitive
- Vitaliteti
- Aksesi

Jacobs dhe Appleyard (1987) shprehen se janë shtatë cilësi që duhet të zotëroj hapësira publike për të funksionuar në mënyrë të suksesshme, të cilat janë :

- Identiteti dhe kontrolli i komunitetit
- Hapësira të plotësoj nevojat e saja
- Imagjinatë dhe gëzim
- Të ketë gjallëri
- Autenticitet dhe kuptim
- Akses në oportunitete
- Një mjedis për të gjithë

Bentley et al. (1985) vecon këto cilësi ndër të tjera si bazë e hapësirës publike:

- Personalizimi
- Të jetë në kushte të mira fizike
- Të ketë mobilim urban të pasur

- Të jetë e lexueshme vizualisht
- Të ofroj variacion
- Të jetë e arritshme nga gjithë publiku
- Të jetë tërheqëse nga ana vizuale

Tibbalds (1988) cilëson këto karakteristika të hapësirës publike:

- Të jetë e dizenuar për të mirëpritur të gjitha grupet e ndryshme të komunitetit
- Të ndërtohet për një kohëzgjatje të madhe dhe të jetë e adaptueshme
- Shkalla njerëzore, detaje, gëzim dhe kënaqësi vizuale
- Të evitohen kontrastet në ndryshim shumë të madh shkalle
- Vendet përpara ndërtesave
- Mjedis i lexueshem
- Përdorim mik
- Liria për të shëtitur
- Të mësojmë nga eksperiencat e shkuara dhe të respektojmë kontekstin

Detr dhe Cabe (2000) vecojnë këto cilësi:

- Përshtatshmëria
- Karakteri unik
- Vazhdimësia dhe mbyllja
- Cilësia e jetës publike
- Lexueshmëria
- Diversiteti
- Lehësia për të levizur

Llewelyn Davies (2000) gjithashtu liston gjashtë elemente thelbësore për suksesin e hapësirave publike:

- Ti kushtohet vëmendje dizajnit të peisazhit
- Forma mikse
- Vende për njerëz
- Përdorime mikse
- Të krijoj ndërlidhje
- Të pasuroj vazhdimisht mjedisin ekzistues

Matthew Carmona (Public Space-The management dimension 2008) si rezultat i një analize shumë të gjerë mbi karakterin e hapësirës publike ka listuar një sërë cilësish universale që duhet të ketë hapësira publike e çfardo lloji:

1-E pastër dhe e rregullt: Të pastrohet dhe të mirëmbahet në mënyrë konstante; Pastrimi i mbeturinave, vendosja e fletëpalosjeve, vendosja e posterave, makinat e braktisura, aromat e këqija, pajisjet e dhura për grumbullimin e mbeturinave; kushte për qentë.

2-Akses: Lehtësisht e arritshme dhe të ketë mundësi për të lëvizur lirshëm brenda saj; trotuare pa pengesa; të arritshme me këmbë, korsi për biçikletë dhe transport publik në çdo kohë; parkim me cilësi të mirë; vazhdimësia e hapësirës; mungesa e barrierave fizike.

3-Tërheqëse: Vizualisht e këndshme; vizualisht stimuluese; të mos ketë shumë elemente dizajni të mbivendosur; asfalt i mirëmbajtur, mobilje në rrugë, peisazh, gjelbërim, kopshte të përparme; të mos ketë graffiti; përdorimi i artit publik; mobilim urban i vendosur në mënyrë të kordinuar

4-Komforte: e rehatshme për të shpenzuar kohë në të; Pa trafik të rënduar, zhurmë hekurudhore / avionësh/industri; sigurimi i mobiljeve në rrugë, sipërfaqe për tu ulur të vendosura në menyrë jo të përshtatshme, tualete publike, strehë; e lexueshme; sinjalistikë e qartë; mbyllje hapësinore

5-Gjithpërfshirëse: të përfshijë këdo në komunitet; e hapur dhe tolerante për të gjithë pavarësisht gjinisë, moshës, racës, aftësisë së kufizuar; angazhim inkurajues në jetën publike; aktivitete për të rinjtë; pakufizime.

6-Vitale: funksionale dhe e gjelberuar; mungesa e hapësirave bosh/ të neglizhuara, ndërtesa të braktisura, të inkurajoj një diversitet përdoruesish, vend takim, animacion, të mundësoj vende për të luajtur, të nxis ndërveprimin me hapësirën.

7-Funksionale: të funksionoj pa konflikte; të jetë një mjedis i përshtatshëm për përdorime të ndryshme, aktivitete, miqësore me automjetet/këmbësorët, siguron mirëmbajtje, shërbime, mungesë parkimesh anësore në rrugë.

8-Identitet: Të ketë një karakter identifikues pozitiv; ndjesia e vendit, tinguj stimulus, prekja dhe nuhatja, të përforcoj karakterin ekzistues/historinë, autentike, individuale.

9-E sigurtë : të jap ndjesinë e sigurisë ; shpejtësi të reduktuar të automjeteve, e sigurtë për këmbësorët dhe ciklistet, prani e autoriteteve, të perceptohet siguria në hapësirë

10-E qëndrueshme : Ti rezistoj presionit të përdorimit të përditshëm, mobilim urban elastik, materiale shtrimi për hapësirat e kalimit, kufinj, peisazh, mobilimi rrugor, ndërtesa të mirëmbajtura, hapësirë e adaptueshme, e gjithanshme.

11-E gjelbëruar dhe pandotje : hapësirë e shëndetshme dhe natyrale, ndërtesa dhe hapësira të gjelbërta, biodiversitet, ujë I pandotur, diell dhe toke, akses në natyrë, mungesa e emetimit të ndotjes së automjeteve.

12- Përmbushja : Ndjesia e zotërimit të hapësirës, të nxisë publikun për të ndërvepruar me hapësirën individualisht ose në grup, të lejoj lirinë personale.

Francis (1987), i kushton vëmendje sigurisë, pasi është pengesa më e shpeshtë e raportuar për përdorimin e hapësirave publike nga njerëzit. Francis përmend gjithashtu komfortin dhe perceptimin si çështje të rëndësishme për arritjen e hapësirave të suksesshme publike. Komoditeti përfshin jo vetëm ambiente adekuate për të ulur, por edhe mbrojtje nga era dhe shiu.

Megjithëse konteksti shoqëror dhe fizik ndryshon nga vendi në vend, duke rezultuar se çdo vend publik ka identitetin dhe karakterin e tij, ekziston një konsensus që për një sërë aktivitete "opsionale" dhe "shoqërore" (Gehl, 1996) të ndodhin, dy parakushtet kryesore duhet të përmbushen për të krijuar një vend publik : mundësi të mira për t'u ulur dhe mundësi të mira për të ecur ;

*"Hapësirat publike që ofrojnë shumë cilësi dhe pak disavantazhe, krijojnë një spektër të gjerë të aktiviteteve urbane. Rrugët të cilat perceptohen si tërheqëse gjatë një shëtitje në këmbë dhe vendet për të ndaluar gjatë rrugës inkurajojnë trafikun këmbësor, i cili nga ana tjetër promovon veprimtari sociale dhe rekreative, sepse njerëzit që ecin së bashku bëhen të frymëzuar për të qëndruar dhe për të shijuar skenën urbane. "* (Gehl dhe Gemzøe, 2000 ; f. 14).

Urbanisiti William H Whyte (Rishfaqja e Qendrës (1988)) dhe arkitekti Jan Gehl, (*Jeta midis Ndërtesave. Përdorimi i hapësirës publike (1996)*) kanë publikuar studime nga me të thelluarat për të zbuluar lidhjen midis cilësive fizike dhe përdorimit të hapësirës publike. Të dy autorët tregojnë për rëndësinë e mundësive për t'u ulur për suksesin e një vendi publik : *"Vetëm kur ekzistojnë mundësi për t'u ulur, mund të ketë qëndrime të çdo kohëzgjatjeje. Nëse këto mundësi janë të pakta ose të këqija, njerëzit thjesht ecin tutje. Kjo do të thotë jo vetëm që qëndrimet në hapësirën publike janë të shkurtra por gjithashtu që shumë aktivitete tërheqëse dhe me vlerë estetike për hapësirën janë paraprakisht të pamundura për tu zhvilluar. Ekzistimi i mundësive të mira për t'u ulur hap rrugën për aktivitetet e shumta që janë tërheqjet kryesore në hapësirat*

*publike : ngrënia, leximi, gjumi, luajtja e shahut, rrezet e diellit, shikimi i njerëzve, bisedimi, etj. " (Gehl, 1996 ; f. 157)*

*"Cfardo qofshin elementet tërheqës të një hapësire, nuk mund t'i shtyjë njerëzit të vijnë dhe të shpenzojnë kohën aty nëse nuk ka vend për t'u ulur." (Whyte, 1988 ; f. 112)*

Mundësitë për t'u ulur mund të ndahen në dy kategori : "primare" ose formale që i referohen stolave dhe karrigeve dhe "sekondare" ose mundësive joformale të uljes siç janë shkallët, piedestalet, kunjat, bordurat, plingjet etj. (Gehl, 1996 ; f. 163). Në lidhje me stolat e kudogjendur, megjithëse pozicionimi i tyre duhet të përputhet me kujdes me konfigurimin e secilit patern në të cilin vendosen, dy karakteristika janë të nevojshme për përdorimin e tyre të suksesshëm : të qenit i pozicionuar mirë dhe rehatia. Për sa i përket pozicionit, situata më e mirë është kur ato vendosen drejt peizazhit kryesor të shikimit (p.sh. Lumi, vendi publik) ose drejt rrjedhës kryesore të këmbësorëve, për të lejuar njerëzit që të vrojojnë veprimtaritë e përbashkëta (Whyte, 1988). Për sa i përket komoditetit, stolat duhet të jenë të dizajnuara në mënyrë të tillë, që të mund të ulesh dhe të ngrihesh lehtësisht prej tyre, veçanërisht në lidhje me kategoritë më të ndjeshme të përdoruesve : fëmijë dhe njerëz të moshuar.

Në përgjithësi, një vend publik duhet t'u ofrojë përdoruesve një shumëllojshmeri variantesh për t'u ulur "në mënyrë që t'u japin frymëzim të gjitha grupeve të përdoruesve dhe mundësinë e qëndrimit" (Gehl, 1996 ; f. 161).

Sipas Matthew Carmona, një ndër elementët e rëndësishëm për një hapësirë publike janë edhe fasadat e objekteve që e kufizojnë, duke e bërë kalimin në këto hapësira një experiencë më të këndëshme por gjithashtu shton edhe ndjesinë e një sigurie më të lartë :

“Fasadat e ndërtesave duhet të jenë të dizajnuara në mënyrë që ndërtesat të arrijnë në rrugë dhe të ofrojnë një “front aktiv” në hapësirën publike, duke shtuar interes dhe gjallëri në sferën publike. Ndërsa dritaret dhe dyert sugjerojnë një prani njerëzore, aq më shumë dyer dhe dritare në hapësirën publike, aq më mirë”. (Carmona et al. 2003 ; f. 173)

Sipas fjalëve të Tibbalds (1992) : « ... një qytet ose qendër e qytetit e krijon vitalitetin e tij nga aktivitetet dhe përdorimet në ndërtesat që ndodhen përgjatë rrugëve të tij. Në këtë drejtim, fasadat dhe aktivitetet e ndodhura në nivelin e rrugës - më afër nivelit të syrit - janë veçanërisht të rëndësishme. Shumë shpesh ndërtesat e reja kanë fronte të errëta dhe jo miqësore në nivelin e rrugës. Këto mbytin zonën ngjitur ". (Tibbalds, 1992 ; f. 41)

### 2.4.1 Llojet e hapësirës publike

Duke I'u referuar Matthew Carmona, Hapësira publike-Dimensioni I menaxhimit, hapësira publike grupohet në katër grupe kryesore në bazë të cilësive të saj :

#### 1-HAPËSIRA POSITIVE

1.1-Natyrare dhe gjysëm natyrare -Karakteristikat natyrore dhe gjysëm natyrore brenda zonave urbane, zakonisht nën pronësinë e shtetit p.sh : Lumenj, tipare natyrore, bregdet, kanale

1.2-Hapësira civile- Format tradicionale të hapësirës urbane, të hapura dhe të disponueshme për të gjithë dhe që furnizojnë një larmi funksionesh p.sh : Rrugë, sheshe, shëtitore.

1.3-Hapësira publike e hapur-Hapësirë e hapur e menaxhuar, tipike e gjelbër dhe e disponueshme për të gjithë, edhe nëse kontrollohet përkohësisht p.sh : Parqe, kopshte, komuna, pyje urbane, varreza.

#### 2-HAPËSIRA NEGATIVE

2.1-Hapësira lëvizje-Hapësira e mbizotëruar nga nevojat e lëvizjes, kryesisht për transport p.sh : Rrugët kryesore, autostradat, hekurudhat, nënkalimet.

2.2-Hapësirë shërbimi-Hapësira ku mbizotërojnë nevojat moderne për shërbime p.sh: Parkimet e makinave, oborret e shërbimit

2.3-Hapësirë e neglizhuar-Hapësira e mbetur pa zhvillim, e krijuar shpesh pa funksion

2.4-Hapësirë e papërcaktuar-Hapësirë e pazhvilluar, ose e braktisur, ose në pritje të rihvillimit p.sh: Hapësira e rihvillimit, hapësira e braktisur, hapësira kalimtare

#### 3-HAPËSIRA TË DYFISHTA

3.1-Hapësirat e shkëmbimit-Ndalesat e transportit dhe shkëmbimet tregtare, qofshin ato të brëndshme apo të jashtme p.sh: metro, ndalesa autobuzi, stacione treni, ndalesa trami.

3.2-Hapësire publike-private-Në dukje janë hapësira publike por me pronësi private, në të cilat ushtrohet kontrolli në shkallë të vogël ose të madhe p.sh: hapësira qytetare private, parqe biznesi, sheshet e kishave.

3.3-Hapësire e dyshimtë-Hapësira të dizenuara në mënyrë të tillë që ti bëjnë të huajt të ndihen jo të mirëpritur.

3.4-Hapësirë e përvetsuar-Formalisht publike dhe me përdorim të jashtëm, shpesh të përvetsuara dhe në disa raste deri të privatizuara.

3.5-Hapësirë tregtare-Me pronësi private por e aksesueshme nga publike për shkëmbime tregtare.

3.6-Hapësirë e trete-Hapësire sociale takimi gjysëm publike, publike dhe private



3.7-Hapësirë private publike-Me pronësi publike por funksioni dhe përdoruesit e saj I nënshtrohen kontrollit

3.8-Hapësirë e dukshme private-Fizikisht private por vizualisht publike

3.9-Hapësira nderveprimi-Fizikisht të kontrolluara por publikisht të aksesueshme ku ndërveprojne hapësira publike dhe private

3.10-Hapësira të kontrolluara-Hapësira në të cilat kanë akses vetëm grupe të caktuara, të grupuara shpesh në bazë të moshës ose aktivitetit.

#### 4-HAPËSIRA PRIVATE

4.1-Hapësira private e hapur-Hapësire private fizikisht e hapur

4.2-Hapësire private outdoor-Hapësira publike private si kopshte dhe oborre

4.3-Hapësira private indoor-Hapësira private ose hapësirë biznesi

Por sic e kemi përmendur që në fillim të studimit, pronësia e hapësirës publike nuk është pjesë e analizës së kësaj tezë, por vetëm cilësitë fizike të saj.

#### 2.4.2 Socializimi si roli primar I hapësirës publike

Në analizën e mësipërme u vu re se, rezultatja e cilësive që duhet të përmbaj një hapësirë e suksesshme publike është shumë e qartë: të ftoj publikun të shpenzoj kohë në të, individualisht ose në grup dhe të krijoj kohezion social midis tyre. Njerëzit varen nga hapësira publike për të kryer shumicën e aktiviteteve të tyre të përditshme si funksionale, sociale, relaksuese, për të udhëtuar, për të bërë blerje, për të luajtur apo për takime të ndryshme, duke e kthyer cilësinë e saj në domosdoshmëri për shëndetin psikologjik dhe social të shoqërive moderne.

*Crowhurst-Lennard dhe Lennard (1995)*, kanë argumentuar se "hapësira publike është elementi i vetëm më i rëndësishëm në percaktimin e jetueshmërisë së një qyteti" (f. 25).

Hulumtimet e fundit në studimet urbane tregojnë se hapësira publike në kohërat bashkëkohore është e rëndësishme për të gjeneruar, forcuar dhe mbajtur një ndjesi të bashkësisë (Boyer, 1994; Hayden, 1995).

Studiues në fusha të ndryshme të shkencave urbane, pohojnë se janë rrugët, plazat, sheshet, parqet dhe hapësirat e tjera publike urbane që kanë potencialin të jenë "skena në të cilën shpaloset drama e jetës komunale" (Carr et al., 1992, 3). Argumentohet që hapësira të tilla janë "skenat tona të përsosura qytetare, të dukshme dhe të arritshme" (Sorkin, 1992, xv). Hapësira

publike ofron mundësi të ndryshme për kontakte sociale për të përjetuar diversitetin dhe krijimtrine, të cilat, siç sugjeron Sennett (1971), nxisin zhvillimin personal të individëve.

Nëse pikat e shumta të kontaktit shoqëror që karakterizojnë dikur qytetin, mund të rigjenerohen nën kushte të përshtatshme për ndikim, atëherë disa mundësi për të provuar larminë dhe rendin do të jenë përsëri të disponueshme për njerëzit. Premtimi i madh i jetës së qytetit është një lloj i ri konfuzioni i mundshëm brenda kufijve të tij, një anarki që nuk do të shkatërrojë njerëzit, por do t'i bëjë ata më të pasur dhe më të pjekur. (Sennett, 1971, 108)

Ekziston një shqetësim gjithnjë e në rritje midis urbanistëve bashkëkohor se jeta shoqërore është gërryer nga theksimi i një *kulture të intimitetit, komoditete individuale* në fushën private dhe një stil jetese bipolare midis punës dhe shtëpise. Vëzhguesit urbanë kanë lidhur një seri të tërë sëmundjesh sociale me mungesën në rritje të kontakteve sociale. Si zgjidhje, Oldenburg (1991) ka bërë një "rast studimor" për një sferë sociale publike - një vend i tretë - në mënyrë që të jetojë një jetë të ekuilibruar. Një hapësirë publike cilësore ka aftësinë për të mbështetur, lehtësuar dhe promovuar jetën publike, e karakterizuar në mënyrë të duhur nga Oldenburg si një homolog thelbësor i hapësirave tona private, shtëpiake dhe të punës, për të kënaqur nevojën tonë për kontakte, komunikim, lojë dhe relaksim. Oldenburg dhe Brissett (1980) gjithashtu I japin rëndësi vendeve të tilla si një terren i përbashkët, një nivel i një shoqërie polarizuese. Ata shprehen:

*"Takimet shoqërore janë të rëndësishme për atë që na simbolizon; një lloj shoqërie e pastër dhe e lirë, e pa kontaminuar nga statusi, qëllimet ose objektivat e veçanta". (Oldenburg dhe Brissett, 1980, 82)*

Ndërsa Lefebvre sugjeron që nevoja për hapësirë sociale dhe jetë shoqërore është më shumë sesa nevojë psikologjike dhe komunale - është një nevojë politike. Në të njëjtën mënyrë, ajo përcakton të drejtën e takimit dhe mbledhjes; vendet dhe objektet duhet të përgjigjen për disa "nevoja" të caktuara, të cilat përgjithësisht keqkuptohen, për disa "funksione" të përçmuara dhe për më tepër "nevojën" për jetën shoqërore dhe një qendër, nevojën dhe funksionin e lojës, funksionin simbolik të hapësirës. (Lefebvre, 1996, 195)

Berman (1986) shprehet se dualiteti midis privates dhe publikes, dualiteti I jetës së njëriut lidhet me konceptin e Marx's për një "individualitet egoist" dhe një "qenië e komunitetit" ose "njeriu dhe qytetari". Berman gjithashtu sugjeron, duke lidhur socializimin me politiken, se duhet të

zgjidhen fillimisht kontraditat e brendshme midis privates dhe publike në vetvete dhe për të zhvilluar një jetesë të integruar në shoqëritë demokratike, njerëzit kanë nevojë, jo vetëm për ndryshime rrenjësore në sistemin politik dhe social por edhe për një vend ku mund të qendrojnë të lirshëm sipas nevojave të veta.

Duke theksuar rolin e hapësirës publike në shoqëritë demokratike, *Arendt (1958)* argumenton se hapësira publike u jep mundësinë njerëzve të mblidhen, të diskutojnë dhe të njohin praninë e njëri-tjetrit, gjë që është thelbësore për demokracinë.

*Walzer (1986)* ndan mendimin se hapësira publike është "hapësira që ne ndajmë me të huajt, njerëz që nuk janë të afërmit tanë, miqtë ose bashkëpunëtorët e punës. Është hapësira për politikë, fe, tregti, sport; hapësirë për bashkëjetesë paqësore dhe takime jopersonale.

Duke "simpatizuar" hapësirën publike në qendër të qytetit, *White (1988)*, përshkruan rolin e saj te shumëfishte si:

- vend për lajme dhe thashetheme
- vend për krijimin e ideve dhe diskutimin e tyre
- vend për të arritur në marrëveshje
- vend për fillimin e paradave.

Këto janë procese që përbëjnë jetën e qytetit- jo domosdoshmërisht i admirueshëm, shpesh gërryes, i zhurmshëm, i diskutueshëm apo pa ndonjë qëllim të dukshëm. Por ky konglomerat njerezor është thelbi i vendit, arsyeja e tij për të qenë, skaji i tij i madh marginal. Ky është motori, eksporti i vërtetë i qytetit.

*Lofland (1998)* shton një tjetër dimension të tolerancës dhe argumenton se kontakti aktiv dhe pasiv shoqëror në hapësirën e hapur publike siç janë rrugët, siguron vendosjen e "mësimin të kozmopolitarizimit" dhe qytetarët duhet që në rrjedhën normale të jetës së tyre të përditshme, të "fërkojnë" shpatullat, të kryejnë ndërveprime të pashmangshme me persona për të cilët nuk pranojnë, me të cilët nuk pajtohen, ndaj të cilëve ndjejnë të paktën antipati të butë, ose që evokojnë në to të paktën një frikë të butë. Kjo do të thotë se çdo qytet që është i aftë të mësojë urbanizmin dhe tolerancën duhet të ketë një avantazh të vështirë. Të pastruara, të rregullta, të purifikuara, qytete të Disneyland (ose pjesë të qyteteve), ku asgjë nuk trondit, asgjë nuk neveritet, asgjë nuk është edhe pak e frikshme, mund të jenë vende të këndshme për daljet

familjare ose tubimet e grupimeve të ndryshme, por vendet e tyre publike nuk do të ndihmojnë në krijimin e kozmopolitanëve. (Lofland, 1998, 243)

## 2.5 Përmbledhje

Një nga pyetjet kryesore mbi të cilat ngrihet studimi I hapësirës publike në këtë tezë është, ‘*a funksionon hapësira urbane si hapësire publike ?*’, është tentuar që ti jepet një përgjigje nëpërmjet analizës së thelluar. Kapitulli I dytë është I strukturuar në menyrë të tillë, për të arritur në esencën e hapësirës publike, ku fillimisht shpjegon përbërjen dhe funksionimin e saj në çdo komponent. Pra kapitulli nis me një mikro-analizë për të kuptuar mënyrën sesi qëndrojnë elementet ndërtues të hapësirës publike kundrejt njëri tjetrit, cili prej tyre është komponenti bazë, cili dominon në përdorim dhe cili është përgjegjës më së shumti për suksesin e saj. Më pas makro-analiza qëndron në analizën e cilësisë fizike të këtyre komponentëve dhe qasjen e tyre kundrejt përdoruesve për të arritur në konceptin se si do të ishte një hapësirë publike ideale.

Mbi bazën e këtyre vetive fizike hapësira publike ndahet në pozitive dhe negative.

Pas një analize shumë të gjerë të literaturës mbi këtë tematikë, kemi analizuar funksionin e hapësirës publike në nivelin e cilësive fizike të saj, duke arritur kështu në katër cilësi kryesore që duhet të plotësoj për të qënë e tillë:

-Komforti fizik

-Dobia

-Vizualisht tërheqëse

-Ndjesia e përkatësisë

Në kapitullin pasardhës do të shpjegohet më qartë si do të ndërthurren këto konkluzione midis tyre për të arritur në modelin e vlerësimit mbi të cilin ndërtohet e gjithë metodologjia bazë e studimit.

## **KAPITULLI 3: Transformimi social I hapësirës publike përgjatë historisë**

### **3.1 Hyrje**

Në këtë kapitull do të hedhim një vështrim historik mbi funksionin dhe evolucionin që ka pësuar hapësira publike ndër shekuj. Deri më tani kemi analizuar hapësirën publike në shumë dimensione por duke patur parasysh që çdo hapësirë është produkt i zhvillimit të mjedisit urban

në të cilin ndodhet, në një analizë historike do të tentojmë të kuptojmë se si ka ndikuar zhvillimi I mjedisit urban në funksion të hapësirës publike. Kapitulli nis me rolin e hapësirës publike në antikitet, duke diskutuar mbi tre qytetërimet kryesore, Mesopotami, Greqi dhe Rome. Më pas analiza vazhdon në rend kronologjik sipas kohës që daton cdo periudhë ku permendim, hapësirën publike në mesjetë, rilindje, periudhën moderne, periudhën socialiste duke i'u referuar edhe Tiranës në këtë periudhë dhe së fundmi me hapësirën publike kontemporane. Është e rëndësishme të merret në konsideratë cdo periudhë pasi në këtë mënyrë mund të kuptojmë aktorët dhe faktorët e rëndësishëm në krijimin e morfologjisë së saj.

### **3.2 Hapësira publike në antikitet**

#### 3.2.1 Mesopotamia

Në një vështrim të shkurtër historik, në periudha të ndryshme kohore të njerëzimit, do të konkludojmë se hapësira publike e ditëve të sotme daton që në lindjen e njerëzimit. Vendndodhja e Mesopotamisë përkon me qytetet moderne të Irakut, veri-lindja e Sirisë, jug-lindja e Turqisë dhe jug-perëndimi I Iranit, ku përfshinte zona me një shumëllojshmëri topografie dhe klime.

Së fundmi, gërmimet në zonën e Irakut kanë bërë zbulime të shumta të vendbanimeve në Mesopotami duke faktuar popullsi të ndryshme, institucione, objekte të prodhura prej tyre të cilat datojnë në mijvjeçarin e hershem të katërt para Krishtit. Qytetet e Mesopotamis përgjithsisht kishin vendbanime me densitet të ulët dhe përdorim fleksibël të hapësirave dhe megjithëse janë bërë zbulime që dëshmojnë konflikte të dhunshme të asokohe, qyteti arriti të funksiononte pavarësisht stresit social. Sipas Bettencourt and West 2010; Glaeser 2011; Sudjic 2016 qytetet antike konsistonin në jetesën dhe punën në afërsi me njëra tjetrën duke pasur kështu ndërveprime të vazhdueshme sociale me njëri tjetrin. Me krijimin e qyteteve të para, krijimi I hapësirave publike erdhi në një mënyrë të natyshme si përgjigje ndaj një nevoje të popullsisë, duke krijuar një sistem si rrugët dhe shtigjet për transport, tempujt për të ushtruar rite fetare dhe hapësirat komerciale për të zhvilluar tregti.




Figure 4. Vendndodhja gjeografike e Mesopotamisë

### 3.2.2 Qytetërimi Grek

Daton ne shek 5 para Krishtit, mund të vëmë re se nëpërmjet formës së organizimit të qytetit dhe cilësive estetike të tij mishëronte rëndësinë që kishte hapësira publike për qytetin. Shembulli më i mirë ilustrues për këtë është Agora (fig.4), sheshi kryesor i qytetit, ku akomodohej rendi politik dhe shoqëror dhe në të cilin zhvilloheshin të gjitha funksionet e jetës sociale si artistike, fetare, atletike, politike etj. Vetë domethënia e fjalës agora është “kuvend” ose “vend grumbullimi”.

LeGates dhe Stout (2000: 31) theksojnë rëndësinë e hapësirës publike për jetën sociale në Polis, duke argumentuar se jeta publike ishte në thelb komuniste. Polisi si nje institucion social përcaktoi natyrën e qenies njerëzore për qytetarët e saj, ndërsa forma fizike e polisit theksoi hapësirën publike.




Figure 5. Ilustrim grafik I morfologjisë së hapësirës publike në Greqinë e lashtë, viti 150 para lindjes së Krishtit

Hapësira publike në Greqinë e lashtë arrin zhvillimin kulmor me Akropolin I cili nisi si një fortesë në kodër duke evoluar gradualisht në një hapësirë publike e cila përdorej për qëllime fetare, grumbullime laike dhe tregtare (Kitto 2000: 33).

Ndryshe nga regjimet autokratike të antikiteit, greket e kishin ndërtuar qytetin e tyre mbi bazën e demokracisë, duke dhënë të drejta të barabarta secilit në jetën që zhvillohej në qytet: “Ishte koncepti i qytetarit urban dhe qeverisjes demokratike që solli një kontribut ndryshe në Greqi në zhvillim dhe evolucionin e civilizimit urban”. (LeGates and Stout eds., 2003; p. 22) Por pavarësisht se në dukje në Greqinë e lashtë mbizoteronte demokracia, faktikisht kjo nuk ishte plotësisht e vertetë sepse gratë, të huajt dhe skllëverit nuk kishin të drejta në jetën e qytetit.

Sipas Carmona et al (Public space-The management dimension, 2008) hapësira publike në Greqinë e lashtë karakterizohej nga disa tipare të cilat janë aktuale edhe në debatet e sotme për hapësirën publike:

- 1-Nocioni I hapësirës publike ka funksione të shumëfishta
- 2-Hapësira publike është një hapësirë demokratike, ku qytetarët ndërveprojnë dhe diskutojnë çështje që kanë të bëjnë me qytetin
- 3-Hapësira publike përdoret për qëllime tregtare

4-Hapësira publike si një vend takimi joformal dhe hapësirë e komunitetit

5-Cilësitë estetike të hapësirës publike I japin kënaqësi përdoruesve

6-Nocioni I aksesit të kontrolluar të hapësirës publike, ku disa përdorues kanë më tepër të drejta se disa të tjerë.

### 3.2.3 Qytetërimi Romak

Më vonë, në shek 3 para Krishtit kemi lulëzimin e **qytetërimit Romak**, ku për disa shekuj pati një mbivendosje kulturore midis tij dhe qytetërimit Grek, ku nje prej rezultateve ishte krijimi I *forumeve romake* I cili ishte nukli kryesor I qyteteve romake të cilët arrinin një numër banorësh me të madh se një million duke bërë kështu që tekstura urbane e tyre të ishte më e pasur dhe më dinamike se ajo e qyteteve Greke.




Figure 6. Shembull I ndërtimit të një forumi romak

Carr *et al.* (1992: 53) bën një përshkrim të forumeve romake duke i cilësuar ato si një kombinim i Akropolit grek dhe agoras. Forumet e mëdha përmbanin hapësira të hapura, gjysëm të hapura dhe të mbyllura dhe përfshinin funksione tregtare, takime fetare, evente politike, sportive dhe takime joformale. Këto forume përmbanin:

-sheshe



*-ndërtesa të rëndësishme civile* si bazilika që ishin hapësira të mbyllura që përdorshin për qëllime gjyqësore ose fetare dhe tempuj dedikuar perëndive të ndryshme romake ku roli i tyre ishte i dyfishtë si vende takimi por gjithashtu edhe për qëllime fetare. Përgjithësisht, kishin formë drejtkëndore të rrethuar nga portikë.

“Brenda në qytetet që nuk kishin dalje në detë, forumi ishte qendra e tij, ndërsa në qytete bregdetare forumi duhej të ndodhej afër portit (Vitruvius, 1999, I, 6, p.31). Tempujt dhe vende të tjera publike duhet të ndodheshin pranë forumit dhe senatit në vecanti si dhe të ndertuara në mënyrë të tillë që lartësonin dinjitetin e qytetit”. (Vitruvius, 1999, V, 2, p. 65).” (Madanipour, 2003; p. 195)

Me kalimin e kohës forumet romake filluan gradualisht të përdorshin kryesisht për qëllime formale, duke pastruar edhe arkitekturën e tyre nga “rrëmuja” e statujve, harqeve, monumenteve dhe elementeve të tjerë të ngjashëm të ndërtuar përgjatë kohës (Mumford 1961: 221–3).

Rreth vitit 113 a.d, Hall (1998: 625) thekson se Roma kishte shumë hapësira për të shëtitur, për biznes dhe për kënaqësi. Në këtë mënyrë qytetet romake prezantuan një qasje më të planifikuar për proshimin e hapësirave publike.

Carmona et al (Public space-The management dimension, 2008) konkludon se Romaket e kishin kuptuar natyrën semitoike të hapësirës publike duke rrethuar sheshet kryesore me ndërtesa si senati dhe tempuj, të shoqëruara këto me ornamente të shumta. Nëpërmjet kësaj metode Roma perandorake donte të impononte një imazh tek populli i vet duke theksuar idenë se dizajni i hapësirës mund të ketë një influencë kontrolluese mbi popullin ndërsa Greket theksonin se cilësitë estetike të hapësirës mund të zbkurojnë shpirtin dhe të lartësojnë mendimin.

### **3.3 Hapësira publike në mesjetë**

Qyteti mesjetarë ishte kryesisht vend tregtie ku sheshet të dedikuara pazarit, ishin hapësirat publike kryesore të tij. Me rënien e perandorisë romake, jeta në Europën perëndimore pësoi rënie, për rrjedhojë kjo solli edhe rënien e jetës urbane publike në këto qytete. Tashmë brenda mureve të qyteteve të trashëguara nga romaket pushteti ra në duart e kishës. Katedralja ishte institucioni kryesor i qytetit që zhvillonte jetën publike, me festa fetare, pelegrinazhe, procesione të përdorura për të bashkuar komunitetin dhe sheshet e tregtisë ndodheshin gjithmonë pranë saj. Duke qënë se në këtë periudhë qytetet u fortifikuan me mure mbrojtëse për shkak të sulmeve që mund të vinin nga pushtues të ndryshëm, hapësira që ngelej në

dispozicion brenda këtyre mureve ishte e pakët duke u kthyer në një motiv për nisjen e tensioneve të shumta midis banorëve, ku secili kërkonte ta përvetësonte për qëllime private.



*Figure 7. Ilustrim i hapësirës publike në mesjetë*

Hapësirat publike në mesjetë ishin të copëzuara dhe në shumicën e rasteve kontrolloheshin nga kisha. Webb (1990: 40–1), i përshkruan rrugët mesjetare si utilitare dhe vetëm më vonë ndërsa qytetet përparonin, rrugët dhe hapësirat filluan të ishin estetikisht tërheqëse, gjë e cila filloi të krijonte edhe hapësira të pavarura nga kisha por brenda kufinjve të ngushtë të mureve të qytetit. Megjithëse themeli i jetës në mesjetë ishte kisha, jeta kryesisht zhvillohej në hapësirën e rrugës: “Në mesjetë ishte rruga- e rrëmujshme, e ndotur, e mbipopulluar- dhe jo hapësira publike që identifikoheshin me kishën, kështjellën apo marketin, që ishte qendra e jetës ekonomike dhe jetës sociale. Rruga ishte vendi i punës, vendi për të blerë apo për të shitur, për tu takuar apo për të negociuar dhe skena e eventeve më të rëndësishme fetare, ceremonive civile apo procesioneve.” (Jackson, 1984 in Glazer and Lilla eds., 1987; p. 289)

Carmona et al. (2008) thekson se në vendbanimet mesjetare, rruga fitoi dy cilësi të cilat kanë qënë piknisja e principeve mbi të cilat hapësira publike funksionon edhe në ditët e sotme. Nga njëra anë, këto vende publike ishin gjithëpërfshirëse duke krijuar akses universal për të gjithë qytetarët duke krijuar kështu një ndjesi egalitarizmi përballë kërcënimeve të vazhdueshme që ndiheshin në qytet. Ndërsa në anën tjetër duke qënë se rrugët mesjetare ishin të ngushta dhe ndiqnin një linjë gjarpëruese krijonin një eksperiencë më emocionuese urbane.

Alberti dhe Sitte, së bashku kanë admiruar patternin dredha-dredha të rrugëve mesjetare duke argumentuar se nxisnin tek përdoruesit kënaqësinë dhe ndjesinë e paparishikueshmërisë.

(Mumford 1961: 316), argumenton se qytetet mesjetare kishin arritur në një sukses që askush prej paraardhësve të tyre nuk kish mundur sepse për herë të parë shumica e banorëve ishin

qytetar të lirë, fakt i cili u reflektua në aksesin e pakushtëzuar të tyre në hapësirën publike. Sistemi rrugor që u zhvillua ishte organik, tregtar dhe vibrant.

### 3.4 Rilindja

Sheshet rilindase dhe baroke ishin të planifikuara dhe të dizenuara me kujdes, me një rëndësi të veçantë për proporcionet dhe harmoninë që reflektohej në fasadat uniformë të objekteve që rrethonin këto sheshe. Pikërisht këtu e ka gjenezën një metodë e re dizajni, lagje banimi që rrethonin sheshet, të cilat fillimisht ishin për shtresën e pasur të shoqërisë, duke krijuar kështu hapësira gjysëm-publike, gjë e cila ngjalli interes të madh tek zhvilluesit e tokave të asokohe (shiko fig.7).




Figure 8. Shembull i mënyrës së organizimit të një sheshi publik në periudhën e rilindjes

Rilindja dhe baroku mbështeteshin në principet klasike të bukurisë dhe simetrisë, e ilustruar kjo më së miri në planin e parë urban të Sforzinda nga Filarete në Itali, në shek.15 (Madanipour, 2003; p.199) si dhe nga shehi i parë Parisien i planifikuar, sheshi mbretëror, sot Place des Vosges në 1605 (Carmona *et al.*, 2008; p. 26). Sheshet më të famshme të asokohe ishin sheshet e reja civile: “Ndërkohë që autoritetet në shek.17 dhe shek.18 u ndërgjëgjësuan për mundësin e ndërtimit të shesheve të planifikuara, një numër i madh i shesheve publike të mëdha u krijuar, shpesh të rrethuara me ndërtesa të planifikuara që më herët për ti dhënë një formë uniformiteti monumentit që ndodhej në qendër të sheshit.” (Leith, 1991; p. 6)

Gjithashtu: “ Sheshet publike në Francë dhe qytete të tjera Europiane në ditet e sotme janë pjesë e peisazhit urban sa që ne priremi të harrojmë që prejardhja e tyre ka qenë pjesë kyce e krijimit të historisë së urbanizmit. Qytetet mesjetare u zhvilluan më tepër si rezultat i rastësisë ku përgjithsisht hapësirat e hapura publike ishin të krijuara në mënyrë aksidentale më tepër sesa si rezultat i planifikimit.” (Leith, 1991; p. 6)

Girouard (permendur tek Carr et al. 1961: 55) thekson se “ periudha e rilindjes kristalizoi ideologjinë e ndërtimit të shesheve që shprehin dinjitetin civil, duke u bërë kështu të papërshtatshme për qëllime tregtare”. Këto sheshe kërkonin ta tejkalonin botën klasike, estetikisht dhe politikisht.

Webb (1990: 68), argumenton, “ lidhja midis artit dhe pushtetit është po aq e vjetër sa njerëzimi” duke qënë se interesat drejtues të kohës punësonin artistët më të mirë, për të rigjenruar qytetet mesjetare dhe pallatet e tyre, për të pohuar dhe shfaqur statusin e tyre shoqëror dhe pasurinë gjithashtu. Në Italinë e shek. 15 tregtia dhe marketet pothuajse u ndaluan që të zhvilloheshin në qendra ndërsa parimet estetike, shkalla e vecantë dhe proporcioni u kthyen e parimet e dizajnit urban, duke bërë që arkitektura dhe skulptura të pasqyronin madhështi.

### **3.5 Periudha moderne**

Periudha moderne është e stigmatizuar me parullën “Forma ndjek funksionin” kështu utilitarizmi i modernistëve i dha prioritet automjeteve dhe varianteve të lëvizjes së shpejt nëpër hapësirën urbane, duke i vendosur në një marrëdhënie edhe më të ngushtë hapësirën e hapur me ndërtesat kufizuese të saj. Tashmë qytetet planifikoheshin si sisteme të mirë organizuara duke e vënë theksin gjithmonë tek funksionaliteti. Ky vizion i ri i ndërtimit të qyteteve krijoi hapësira gjigande tek të cilat ngriheshin objekte të mëdha pa asnjë lidhje me pjesën e qytetit dhe duke vënë theksin tek interesi publike, modernistet nuk i kushtuan rëndësi hapësirave publike historike duke krijuar kështu një lloj “hapësire të humbur” në të cilën socializimi ishte thuajse i pamundur. Nevojat sociale dhe psikologjike thuajse u anashkaluan nga modernistët duke mos e marrë thuajse asnjëherë në konsideratë hapësirën publike.



*Figure 9. Le Corbusier's Plan Voisin-Plani rregullues për qendrën e Parisit, 1925*

Madanipour (2003: 202) konstaton sesi këto hapësira të hapura ishin pothuajse të palidhura: Rezultati i modernizimit ishin hapësira tejet të mëdha të palidhura si me njera tjetren ashtu edhe me qytetin, rezultati i të cilave ishte që liheshin thuhet të papërdorura dhe vëzhgoheshin vetëm nga dritaret e ndërtesave të larta apo nga xhamat e automjeteve.

Në këtë sens këto hapësira mund të konsiderohen si “negative”, dhe roli i tyre është i gjithi në funksion të ndërtesave që i rrethojnë”.

Një prej kritikëve të parë, të qasjes moderne të ndërtimit të qytetit ishte Camillo Sitte i cili i lavderonte hapësirat historike për prekjën artistike që i jepnin qytetit dhe nga ana tjetër sulmonte karakterin prozaik të planifikimit modern të qytetit. Duke pasur parasysh hapësirën e hapur, kritikon fuqinë e inxhinierit në dizajnin e hapësirave. Sitte vuri re një konvergencë në hapësirën publike urbane e cila nuk kishte më asnjë lidhje me identitetin artistik dhe kulturor të njeriut.

Sennett (1990: 4–5), gjithashtu lavdëron qyteterimet e të shkuarës, vecanërisht ato antike, duke iu referuar pjesëmarrjes në jetën publike duke argumentuar se jeta moderne publike është shumë e personalizuar: “Grekët e lashtë mund të përdornin sytë e tij ose të saj për të parë kompleksitetin e jetës. Tempujt, marketet, fushat e lojrave, vendet e takimeve, muret, statujat publike si dhe pikturat prezantonin vlerat e kulturave në fe, politik dhe jetën familjare. Në kontrast me këtë do të ishte e vështirë të mund të kuptoje se ku të shkojë në Londrën apo New York-un modern”. Sennett (1977: 12) fajëson modernizmin për krijim e hapësirave publike të vdekura ku hapësirat janë përgjithësisht të izoluara duke krijuar me tepër vende për të kaluar

sesa për të qëndruar. Sennett pranon se qyteti në vetvete është një konglomerat të huajsh dhe aludon për problemin që kanë banorët në qytetet post-moderne për të marr kënaqësi nga eksperiencat urbane, vecanërisht nëse hapësira është “e divorcuar” nga konteksti dhe socializimi. Ai konstaton se i huaji është një domosdoshmëri në qytetet moderne por në vetvete i huaji është një figurë kërcënuese sepse shumë pak mund të arrijnë të gjejnë kënaqësi në një botë të huajsh, sic është qyteti kosmopolitan (Sennett 1977: 3).

Jane Jacobs së bashku me shumë kritikë të tjerë ia atribuojnë dështimin e hapësirës moderne percaktimit të dobët midis publikes dhe private, duke iu referuar vecanërisht kimit. Vecanërisht Jacobs fajëson urbanistët modern për shkatërrimin e marrëdhënieve të qëndrueshme sociale. Për rrjedhojë, diskutimet e saj mbi hapësirën publike duke pasur referencë bazë sigurinë në trotuare, duke listuar këtu tre cilësi që një rrugë publike duhet të ketë për të përballuar “të huajt”: “Fillimisht, duhet të ketë një kufi të qartë midis asaj çfarë është hapësirë publike dhe asaj çfarë është hapësirë private. Së dyti, fokusi duhet të jetë tek rrugët. Ndërtesat të ndodhen në rrugë që kanë kapacitetin e duhur për të përballuar “të huajt”. Së treti, trotuaret duhet të kenë prezencën e përdoruesve në mënyre të vazhduar, për të rritur kështu numrin e syve efektive në rrugë, gjithashtu për të nxitur njerëzit në objektet që ndodhen përgjatë rrugës që ti shohin trotuaret si të mjaftushëm në numer”. (Jacobs 1961: 45)

Antropologu Edw

ard T. Hall ka ekzaminuar impaktin psikologjik të hapësirës urbane. Duke iu referuar modernizmit, hall kritikoi skemat masive të rivitalizimit të cilat i ndajne përdoruesit nga konteksti kulturor (Hall 1966: 155–8). Hall argumentonte se hapësira publike duhet të akomodoj përdorues të përkatsive të ndryshme kulturore: “Një prej nevojave më kritike të njeriut, është dizajni i hapësirave që kanë një densitet të shëndetshëm, një shkallë të shëndetshme ndërveprimi dhe një ndjesi e vazhdueshme e identitetit etnik”.

Pra, periudha e modernizmit duke iu referua hapësirës publike, megjithatë u zhvillua në një kohë që përkonte me një diversitet të madh kulturor, e trajtoi zhvillimin e saj me uniformitet duke anashkaluar nevojat psikologjike dhe sociale të përdoruesve

### **3.6 Hapësira publike gjatë periudhës së socializmit**

Periudha e socializimit, e cila pati kulmin e zhvillimit të vet në shek.20, solli ndryshime radikale në konfigurimin dhe përdorimin e hapësirës publike, e cila shërbeu si një vorbull për shprehjen e pakenaqësisë sociale. Në vitet '60, kryesisht në Europë, trazirat sociale dhe politike zhvilloheshin në hapësirat publike ku kishte edhe raste në të cilat përvetësoheshin edhe

hapësirat private të cilat dekoroheshin me simbole të protestës. Në këtë kohë ishte stigmatizuar sllogani së qytetarët duhet të merrnin kontrollin e hapësirave të hapura, duke themeluar kështu lëvizjen për të drejtën e qytetit.

### 3.6.1 Hapësira publike në Tiranë gjatë periudhës komuniste

Ndryshe nga situata e shteteve të tjera komuniste të kohës, hapësira publike në Tiranë asokohe nuk përdorej për trazira sociale apo shfaqje të paknaqesive të përgjithshme, përkundrazi banoret shpenzonin kohën e tyre të lirë në këto hapësira ndërkohë që politika I përdorte në funksion të saj për:

- Shfaqje të pushtetit
- Parada ushtarake
- Prezantimin e ideologjive të politikës komuniste



*Figure 10. Ilustrim për funksionin e hapësirës publike si vend grumbullim për shpërndarjen e ideologjive*

Arkitektura dhe dizajni i hapësirës publike në këtë periudhë ishte i ftohtë për shkak të përdorimit masiv të betonit, hapësirat ishin të hapura dhe të arritshme dhe duke e kuptuar natyrën e fuqishme semiotike të hapësirës publike, udhëheqësit e kohës e kishin dekoruar me monumente të mëdha të figurave politike të socializmit. Pavarësisht se këto hapësira ishin të lira në dukje për këdo, për shkak të trytnisë që politika ushtronte mbi qytetarët, në to ndihej një ndjesi pasigurie konstante.



*Figure 11. Sheshi “Skenderbej” gjate periudhes komuniste*

### **3.7 Hapësira publike kontemporane**

Tashmë procesi I globalizimit ka ushtruar ndikimin e tij edhe në hapësirën publike kontemporane nëpërmjet kapitalizmit dhe privatizimit duke çuar kështu drejt një rikonfigurimi social dhe fizik të saj që rezulton në një humbje të konsiderueshme të hapësirave publike. Paqet e gjelbëruara, sheshet e hapura, shëtitorët ranë pre e privatizimit, proces I cili krijoi një hapësirë hibride e cila nuk kishte një kufi të dukshëm midis publikes dhe private apo simbole të dukshme, thjesht një hapësirë konsumi e hapur ose e mbyllur.



*Figure 12. (majtas) Qendra tregtare Grand Central Birmingham, (djathtas) rruga “La Rambla”, Barcelonë*

Konfigurimi i duhur i një hapësire publike urbane pasqyron funksionimin korrekt të një qeverisjeje demokratike e megjithatë pas kaq shumë shndërrimeve ndër shekuj, ne jemi tani në një pikë ku duhet të merremi me këto mbetje të hapësirës publike. Por një hapësire publike e suksesshme nuk varet vetëm nga arkitekti, planifikuesi apo dizenjuesi urban, gjithashtu ka



peshë aftësia e njerëzve për tu përshtatur me të, përdorimi dhe menaxhimi i saj sepse njerëzit i krijojnë vendet, më tepër sesa vendet sjellin njerëzit.

### 3.7.1 Hapësira publike kontemporane në Tiranë

Procesi i vrullshëm i privatizimit i cili e pati zanafillën me rëninën e regjimit komunist, filloi ta zhvesh qytetin nga hapësira publike duke sjell një formë të re zhvillimi kaotike. Tashmë karakteri i hapësirës urbane në një qytet post-komunist si Tirana po formohet dhe zhvillohet nga procese të vazhdueshme sociale në një mjedis shoqëror i cili po polarizohet në mënyrë të ndjeshme duke reflektuar impaktin e vet në konfigurimin hapësinor.



Figure 13. (majtas) Sheshi “Skënderbej” Tiranë, (djathtas) Kryqezimi i bulevardit “Deshmorët e Kombit” dhe “Bajram Curri”

## **KAPITULLI 4 : Ontologjia e hapësirës publike**

### **4.1 Hyrje**

Në vazhdimësi të kapitujve të mësipërm, pasi kemi bërë një hetim të thellë në natyrën e hapësirës publike për të zbuluar në fund kategoritë kryesore që e ndërtojnë hapësirën publike, në këtë kapitull do të detajojmë më thellë këto koncepte për të kuptuar drejt mënyrën sesi qëndrojnë në raport mes tyre. Pra pikat kryesore të diskutimit do të jenë:

*-Dobia- Hapësira publike si një mekanizëm funksional I jetës urbane*

*-Komforti fizik- Hapësira publike si një qasje fizike*

*-Ndjesia e përkatësisë- Hapësira publike si një entitet social*

*-Vizualisht tërheqëse- Hapësira publike si element I dizajnit urban*

Gjatë diskutimit të këtyre kategorive do të kuptojmë se kufinj të dallues midis tyre janë shumë të mjegullt dhe të paqartë por për qëllimin e diskutimit tonë është domosdoshmëri të përcaktojmë se si është e ndërtuar një gjëndje mendore dhe fizike e hapësirës publike “ideale”. Si rezultat do të kemi një mjet matës të cilit do ti referohemi, për të kuptuar më pas dhe për të analizuar cdo tipologji të mundshme të hapësirës publike.

### **4.2 Kategoria I e Ontologjisë: Dobia -Hapësira publike si një mekanizëm funksional I jetës urbane**

Nje kategori e rëndësishme e hapësirës publike është dobia ose e thënë ndryshe funksionaliteti I saj, nëse një hapësirë e bën të mundur përdorimin e të gjitha funksioneve që duhet të ofrojë. Një hapësirë duhet të përmbush disa kritere të caktuar për të qënë funksionale në tërësinë e mundësive që duhet të siguroj për përdoruesit e saj, të cilat janë:

#### -Aksesi

Aksesi nënkupton mundësinë e përdoruesve për të hyrë dhe përdorur hapësirën, pa asnjë barrierë fizike, në cdo mënyrë që ata ndihen komodë dhe të bëhen pjesë e një shoqërie nëpërmjet hapësirës publike pavarësisht gjinisë, etnisë, moshës apo nivelit socio-ekonomik. Pra, atributet që duhet të ofroj aksesit janë:

-Fizikisht e aksesueshme për të gjithë

-Socialisht e aksesueshme për të gjithë

-Aktivitet dhe proceset e ndryshme të përdorimit të hapësirës publike të jenë të mundura për të gjithë

Duke iu referuar hapësirës publike në terma të aksesit, Benn dhe Gaus (1983) sugjerojnë një metodologji shumë të vlefshme empirike për të vlerësuar cilësinë e saj. Ata listojnë tre kritere për vlerësim, “akesi”, “aktorët” dhe “interesi”. Së pari, duke iu referuar aksesit hapësira publike është një vend fizikisht I arritshëm dhe I hapur për këdo. Gjithsesi, koncepti I aksesit nuk është I kufizuar vetëm në ambientin fizik. Aksesit gjithashtu nënkupton akses social dhe akses simbolik. Mjedisi, siguria dhe aktivitetet mund të perceptohen si ftuese ose si komforte nga publike duke ndikuar kështu drejtpërdrejt aksesin në hapësirë. Së dyti, hapësira publike është një vend që kontrollohet nga aktor publik. Këtu, pronësia dhe mirëmbajtja nga organet përgjegjëse si dhe grupet e përdoruesve, të cilët kryesisht përdorin vendin, janë pikat kryesore në lidhje me kontrollin e vendit publik.

Së fundmi, vendi publik është një vend që i shërben interesit publik, pra interesit të përbashkët. Sidomos, duke marr ne konsiderate se deri në çfarë mase favorizon interesin publik ndaj interesit në rritje privat, është problem kryesor në lidhje me gjithëpërfshirjen ne hapësirën publike.

Madanipour (1996) zhvilloi dy korniza të gjera të 'vendit' dhe 'procesit' për të analizuar cilësinë e hapësirës publike. Ai argumentoi se hapësira publike duhet të jetë vend i arritshëm dhe i zhvilluar përmes proceseve gjithëpërfshirëse. Sipas tij, aksesueshmëria është tipari kryesor i hapësirës publike. Ai dallon vendin publik nga ai privat dhe përcakton funksionet dhe aktivitetet që do të lejohen atje. Madanipour pohoi gjithashtu se për një proces gjithëpërfshirës të planifikimit dhe konfigurimit të hapësirës, një kusht I rëndësishëm që duhet përmbushur është se si interesat e grupeve të ndryshme të njerëzve reflektohen në të.

Por jo gjithmonë barrierat të cilat pengojnë aksesin në një hapësirë publike janë elemente fizike. Shpesh edhe mungesa e një komponenti që duhet të ofroj hapësira kthehet në një barrierë, pengesë aksesit për publikun. Në projektimin e hapësirave publike, edhe në rastet kur ato janë të arritshme fizikisht, çështje dhe aspekte të tjera të hapësirave publike mund të veprojnë si një pengesë për përdorimin e tyre nga disa njerëz. Këtu mund të jetë vështirësia për t'u futur, mungesa e tualeteve publike (të hapura), ambientet për fëmijë dhe të moshuarit dhe parkimi për makina (Caroline H. et al, 2007). “Në një hapësirë publike të mirë-projektuar dhe të mirë-menaxhuar, mburoja e jetës së përditëshme mund të hiqet, duke na lejuar ti shohim të tjerët si njerëz të tërë. Të shohësh njerëz të ndryshëm nga vetja që I përgjigjen një hapësirë në mënyrë të ngjashme mund të krijoj një lidhje të përkohshme. ” (Carr et al., 1993, f.344).

Fjala "vend publik" duhet te karakterizohet shumë nga "publiku". Sot, hapësira publike duhet të konceptohet si e ndryshme nga fusha e shtetit dhe pronësia e tij. Duhet konsideruar më shumë

si një hapësirë e aksesueshme nga të gjithë. Hapësira publike janë hapësira ku publiku ka qasje të papenguar fizike dhe sociale (Lofland, 1998).

Praktikisht është thuajse e pamundur që një hapësirë publike të ekzistoj me të gjitha cilësitë positive të dëshiruara.

“Shumica e vendeve që ne ndajmë me të huajt nuk janë as publike dhe as private por ekzistojnë në një zonë gri midis të dyve. ” (Kohn, 2004; f. 9)

Pra, zakonisht hapësirat publike zhvillohen midis një balance të mesme të këtyre kriterëve positive ose negative.

Vëmë re se në gjithë morinë e cilësive që kemi diskutuar se duhet të përmbajë një hapësirë publike ideale, të gjitha cilësitë janë të ndërlidhura midis tyre, ku prezenca ose mungesa e një cilësie jep një efekt zinxhir në të gjithë cilësitë e tjera dhe për rrjedhojë në tërësinë e hapësirës publike. Piramida e nevojave të Maslow, kategorizon nevojat njerëzore duke u nisur nga më esencialet dhe jetësoret sic janë nevojat fizike deri tek nevojat më komplekse që janë ato sociale. Referuar hapësirës publike në këtë këndvështrim, cila është cilësia bazë nga e cila më pas mund të derivojnë të gjitha kategoritë e tjera që duhet të përmbush hapësira “ideale”. Sic e kemi përmendur edhe në fillim të diskutimit në përcaktimin e konceptit të hapësirës publike, cilësia bazë që e ben një hapësirë publike është aksesi, e cila pasohet nga barazia midis përdoruesve dhe ajo çfarë është e domosdoshme siguria për ta përdorur.

Sipas Carmona et al.2003 aksesibiliteti ekziston në dy lloje:

(a) Vizual -mundësia e hyrjes e cila i lejon njerëzit ta shohin atë dhe të informohen se çfarë po ndodh në atë hapësirë

(b) Fizik -mundësia e hyrjes e cila i lejon njerëzit të hyjnë në atë hapësirë dhe të përdorin funksionet e saj.

Një hapësirë publike duhet të ftoj njerëzit të vijnë brenda dhe ta përdorin atë. Ky faktor na çon drejt një nevoje tjetër të rëndësishme shoqërore që është barazia. Mjedise të barabarta janë ato që mund të ndahen në mënyrë të barabartë nga të gjitha pjesët e shoqërisë. Ato ofrojnë të gjitha cilësitë që kërkojnë një gamë e gjerë e përdoruesve. Ata takohen me nevojat e grupeve të ndryshme pa zvogëluar mirëqenien e të tjerëve. Mjedise të cilat nuk janë të barabarta ose nuk janë gjithëpërfshirëse, shfaqin cilësi të cilat i bëjnë më pak të përdorshme për disa grupe të caktuar të shoqërisë, d.m.th. gratë, pakicat etnike, pleqtë, invalidët, njerëzit e varfër dhe fëmijët.

-Vitale dhe e zbatueshme

Gjendja e të qenit aktiv dhe funksionimi në mënyrë korrekte janë koncepte të cilat bëjnë të mundur dallimin midis një hapësire publike të suksesshme nga një hapësirë urbane. Në

kontekstin urban, kjo lidhet me një hapësirë më të sigurt, më e dëshirueshme, më atraktive e cila mund të ofroj më shumë sesa një mënyrë për të nxitur kohezionin social apo shkëmbime kulturore, duke prodhuar kështu një proces për krijimin e vendeve për njerzit.

Në anën tjetër vitaliteti lidhet gjithashtu edhe me prezencën e eventeve apo ngjarjeve të ndryshme që mund të zhvillohen në një hapësirë. Në menaxhimin e hapësirave publike, Caroline et al (2007) argumenton se “njerëzit tërhiqen dhe priren të qëndrojnë më gjatë, në hapësirat publike që ofrojnë interes, vitalitet, stimulim dhe / ose një shkallë komoditeti. Sondazhet dhe të dhënat e vëzhgimeve tregojnë se njerëzit tërhiqen dhe kërkojnë ngjarje dhe aktivitete të veçanta në hapësirat publike, si në nivel lokal ashtu edhe në qendër të qytetit. Ngjarje unike dhe speciale si “aretime spontane në rrugë” të cilat tërheqin vëmendje dhe ndihmojnë vendet që të etiketohen si interesante. Njerëzit ka më shumë gjasa të priren për të shpenzuar kohë në një hapësirë nëse shohin aty vende për tu ulur dhe të mbrojtura nga dielli apo shiu”.

Lynch (1981) identifikon vitalitetin si një nga dimensionet e performancës së paternit urban dhe e përshkruan atë si shkallën, në të cilën forma e vendeve mbështet funksionet, kërkesat biologjike dhe aftësitë e qenieve njerëzore. Vitaliteti simbolizon shkallën e suksesit social të një hapësire.

Në përkufizimin e Montgomery (1998), vitaliteti i referohet numrit të njerëzve brenda dhe përreth hapësirës publike (rrjedhat e këmbësorëve) përgjatë intervaleve të ndryshme kohore të ditës dhe natës, ofrimi i shërbimeve, numri i ngjarjeve kulturore dhe festimeve gjatë vitit, prania e një jete aktive në rrugë, dhe përgjithësisht shkalla në të cilën një vend ndihet i gjallë ose “energjik”. Vitaliteti në sferën urbane është një cilësi e rëndësishme sepse zvogëlon krimin, rrit interes komercial, rrit kënaqësinë pasive të vëzhgimit të rrugës - njerëzit që shikojnë, inkurajojnë ndërveprimin shoqëror dhe sigurojnë mundësi për shkëmbime kulturore. Si pasojë, gjallëria ose vitaliteti në hapësirën urbane është një tregues i rëndësishëm i shëndetit të saj.

Komisioni auditit (2002a: 3–6) hartoi “axhenden e jetueshmerise/vitalitetit” ku sipas tyre do ti ndihmoj komunitetet të përmirësojnë hapësirën publike, duke i bërë rrugët më të sigurta, më të pastra dhe të mirë menaxhuara. Analiza e tyre tregon se njerëzit i dëshirojnë hapësirat e tyre të jenë:

- Të këndshme
- Tërheqëse
- Të mirë dizenuara

-Të mos kenë rrezikun e ndotjes apo zhurmave

-Funksionale

-Të pastra nga mbetjet urbane

-Të ndryshme, për të përmbushur të gjitha nevojat-e paqtë dhe e gjalle, të ketë prezencën e bizneseve dhe mundësinë për të luajtur.

Barry Sherman (1988) e konsideron vitalitin si një nga treguesit më të rëndësishëm të suksesit të hapësirës publike. Studimet e fundit bashkëkohore dëshmojnë se vitaliteti është një produkt i cilësive vizuale të mjedisit me shkallën e variacionit të eventeve që zhvillohen në të. Në këtë pike, vlen për tu theksuar se një hapësirë publike vizualisht tërheqëse duhet të përmbush shumicën e nevojave të njerëzve, pra një kryqëzim midis nevojave të përdoruesve dhe aktiviteteve që zhvillohen në hapësira.

Vëmë re se në gjithë morinë e cilësive që kemi diskutuar se duhet të përmbaje një hapësirë publike ideale, të gjitha cilësitë janë të ndërlidhura midis tyre, ku prezenca ose mungesa e një cilësie jep një efekt zinxhir në të gjithë cilësitë e tjera dhe për rrjedhojë në tërësinë e hapësirës publike. Piramida e nevojave të Maslow, kategorizon nevojat njerëzore duke u nisur nga më esenciale dhe jetësoret sic janë nevojat fizike deri tek nevojat më komplekse që janë ato sociale. Referuar hapësirës publike në këtë këndvështrim, cila është cilësia bazë nga e cila më pas mund të derivojnë të gjitha kategoritë e tjera që duhet të përmbush hapësira “ideale”. Sic e kemi përmendur edhe në fillim të diskutimit në përcaktimin e konceptit të hapësirës publike, cilësia bazë që e bën një hapësirë publike është akses.

-Funksionale

Referuar Carmona et al.2003, një hapësirë publike quhet funksionale nëse ajo arrin të funksionoj pa konflikte, pra:

-Ofron përdorime të ndryshme

-Aktivitete

-Marrëdhënie pa konflikte midis këmbësorëve dhe automjeteve

-Siguron lehtësi në mirëmbajtje

-Shërbime

-Mungesë të parkimit në rrugë

Megjithëse shumicës prej nesh do ti pelqente të mendonte se ne jetojmë në një gjendje natyrale konsensusi, realiteti i jetës së përditshme është shumë larg kësaj utopie, për më tepër kemi të bejmë me një realitet konfliktual, shumëpalesh dhe kompleks.

Ritzer 2011, thotë se pluralizmi I atribuoi hapësirës publike “surpriza” të niveleve të ndryshme. Takime të ndryshme mund të ndodhin në hapësirën publike dhe produkti I një heterogjeniteti të tillë është tepër I vështirë për tu parashikuar. Kjo paparishikueshmeri është munduar në mënyrë konstante të nxirret jashtë hapësirës publike për ta bërë atë më racionle, më të kontrolluar, më eficente dhe të parashikueshme.

Vëzhgimi nëpërmjet videove 24 orë është një nga përpjekjet që është bërë për të minimizuar shkallën e konfliktit, duke qënë se krijon mundësinë e:

- Përllogaritjeve (sa persona mesatarisht e përdorin gjatë ditës një hapësirë të caktuar)
- Eficencë (prezenca e oficerëve të policis mund të shpërndahet më sakt)
- Kontroll (Krijon mundësinë e ndërhyrjeve më të shpejta në raste konfliktesh)
- Parashikueshmëria (ndërhyrjet që bëhen në një hapësirë të vëzhguar kanë tendencën të jenë më të parashikuara)

Në këtë kontekst, forma të ndryshme të mobilimit urban janë përdorur për të manovruar sjelljet e ndryshme në hapësirën publike, për të nxitur ose për të evituar takime specifike ose për të penguar prezencën e padëshiruar të prostitutave, të pastrehëve apo përdoruesve të lëndëve narkotike. Kështu kemi të bëjmë me një ndërhyrje nga aktoret urbane për të krijuar hapësira publike të “sheshta” ose “të neutralizuara”, hapësira të cilat nuk lënë vend për spontanitet, kreativitet apo surpriza. Por pavarësisht kësaj, hapësirat publike janë shumë komplekse. Racionalizimi I tyre kundërshtohet nga një mori mikro-procesesh, të cilat Santos (1996) I quajti kundër-racionalizim.

Kur racionalizmi është një strategji e “të fuqishmëve” për të konsoliduar pushtetin e tyre në hapësirë, kundër-racionalizmi është një taktikë për të përmbysur këtë rregull dominues, megjithëse përkohësisht. Këto përmbysje dhe ripërshtatje të përdorimeve të përditshme ndodhin thuhet cdo ditë dhe të njëjtat teknologji apo objekte racionalizuese përdoren përsëri. Për Lefebvre (1976:31) “hapësirat publike janë praktikisht të mbushura me ideologji”. Poshtë mantelit të këtij rregulli dominues qëndron një dieversitet përdoruesish dhe përdorimesh prandaj në këto situatë duhet të kemi parasysh kush përfiton nga një rregull I caktuar I vendosur dhe cilat dinamika të pushtetit janë përdorur për ta formuluar, zbatuar dhe kontrolluar. Nëse këto dispozitiva janë efektive në ruajtjen e paqes dhe funksionimit të hapësirës publike ngre një shqetësim dhe debat të madh mbi drejtësinë sociale.

Funksionaliteti në hapësirën publike nënkupton atë çfarë është e pranueshme dhe sesi ne do ti zbatojmë dhe ruajmë kufinj të të pranueshmes, duke futur në këtë pikë mekanizmin e përfshirjes apo përjashimit nga hapësira publike. Duke vëzhguar përditë hapësirën dhe eventet

që marrin jetë në të apo fenomene që zhvillohen në te, e kuptojmë se norcioni I rregullit është në varësi të:

-Konflikteve

-Negociatave dhe pazareve

-Larg nga pandryshueshmëria, natyralja dhe të qenit vetvetja

Duke nisur nga sa thamë më sipër metodologjia kontemporane e vendosjes së rregullit bën që rregulli dhe ndërveprimi social në hapësirën publike të jenë gjendje të ndara mes tyre.

Pavarësisht nëse pikëpamja jonë për ndryshimin e hapësirës publike është positive apo negative, Carr et al. 1992 fakti ngelet se në kuptimin formal të hapësirës publike si një arenë ku individët mund të kërkojnë të drejta të plota të aksesit, përdorimit, veprimit dhe pershtatjes. Por realisht në praktikë këto të drejta janë në negociatë të vazhdueshme duke krijuar kështu konflikte të mëdha, të cilat na tregojnë dicka mbi natyrën e hapësirës publike dhe sesi në përditshmëri ne e marrim për të mirëqënë atë.

Mëgjithëse historikisht hapësira publike ka qënë një arenë debate mbi lirinë apo kufizimin e aksesit, duhet që ta zbërthejme “shkallën e publikes” për të kuptuar dilemën se sa shumë rregulla janë të nevojshme të vendosen për të bere të mundur funksionim e saj por pa cënuar dimensionin social.

-E fuqishme, ti rezistoj përdorimit të përditshëm dhe ndryshimit me kalimin e kohës

Referuar Carmona et al.2003 kjo përkthehet në:

-Hapësirë me cilësi të lartë

-Të mos “gërrmohet” vazhdimisht

-Mobilim rrugor I përshtatshëm

-Materiale shtrimi

-Kufij të mirëpërcaktuar

-Peisazh I butë-pra peisazh I ndërtuar pa konstruksione por me elemente të natyrës si gjelbërim I ulët dhe I lartë

-Mobilim rrugor

-Ndertesa të mirëmbajtura

-Hapësira “të zhdërvjellta” që kanë aftësi ti përshtaten ndryshimit

Hapësirat publike janë një pjesë integrale e hapësirës urbane dhe transformimit të saj (Madanipour / Knierbein / Degros 2014). Në kohën e transformimeve të vazhdueshme strukturore, shumë qytete duhet të merren me hapësira të hapura urbane që janë vjetëruar ose



me hapësira publike që pësojnë ndryshime drastike (proceset e tkurrjes, transformimi post-industrial, masat shtrënguese, e kështu me radhë). Edhe interesat e kundërta për përdorime të ndryshme shpesh duket se mungojnë plotësisht në këto hapësira. Shpesh, e ndikuar nga krizat njerëzore, ndryshimi i klimës ose thjesht ndryshimi i shpejtë demografik, hapësirat publike bien nën presion edhe më të madh nëse qyteti përballlet me një situatë drastike ose traumatike. Në këtë mënyrë, hapësirat publike konsiderohen mjete thelbësore për kapërcimin e rënies së ngadaltë ose fazave të shpejta të shokut që mund të pësojë qyteti.

Kështu hapësira publike, duke qënë një katalizator për ndryshimet në shoqëri, “fortësia” e saj mund të ndahet në dy kategori: *Elasticiteti dhe ritmi*.

*Elasticiteti* ka të bëjë me kapacitetin e hapësirës për tu rikuperuar nga një situatë traumatike ose rënie graduale duke riformuar hapësira domethënëse publike të cilat e kanë të thjeshtë të përshtaten sërish në varësi të kontekstit ku ndodhen.

*Ritmi* ka të bëjë me shpejtësinë, dinamikën e përshtajës së hapësirës publike me proceset e vazhdueshme të urbanizimit global.

Një jetë publike e fortë dhe vibrante mbështetet plotësisht në aftësinë e hapësirës publike për të mbledhur njerëzit së bashku. Aftësia për të bashkuar, për të krijuar kohezion social, evente në komunitet apo për demonstrata politike janë e drejta bazë jo vetëm e demokracisë por edhe të një hapësire publike të shëndetshme.

### ***Plotësisht e dobishme***

- Akses
- Vitale dhe e zbatueshme
- Funksionale
- E fuqishme, e aftë për të përballuar përdorimin e përditshëm



### ***Jo e dobishme***

- E zaptuar me vende parkimi
- Mungesë vitaliteti
- Mungesë funksioni

Figure 14. Grafik për kategorizimin e cilësive të dobishme dhe jo të dobishme të hapësirës publike

### 4.3 Kategoria II e Ontologjisë: Komforti fizik-*Hapësira publike si një qasje fizike*

Përsa I përket komfortit fizik në hapësirën publike lidhet në mënyrë të drejtëpërdrejtë me vendndodhjen gjeografike, kushtet fizike dhe menaxhimin e saj. E thënë ndryshe në një shkallë më të madhe *makro*, komforti fizik lidhet me objektet apo rrugët që e kufizojnë atë ndërsa në një shkallë më të vogël *mikro*, lidhet me vecori specifike të gjendjes së saj fizike dhe menaxhimit.

Duke qënë se hapësira publike është pjesë e sistemit të madh të qytetit, asnjëherë nuk mund të veprojë vetme në mënyrë të pavarur, në këtë mënyrë vendndodhja dhe elementet rrethues të saj japin një ndikim të madh dhe të drejtëpërdrejtë në cilësinë e saj.

“Vendet nuk janë thjesht një vendndodhje lokale. Ato janë momente në një shkallë të madhe, në atë shkallë të madhe të cilën ne e quajmë qytet. Është qyteti që I krijon vendet dhe jo vendet qytetin. Dallimi është jetësor. Ne nuk mund të krijojmë vende pa kuptuar së pari qytetin.” (Hillier, 1996, p. 42)

Sipas Gehl 1996, pavarësisht se konteksti social dhe fizik variojnë nga një vend në tjetrin, duke bërë që secila hapësirë të ketë identitetin e vet dhe karakterin e vecantë, ekziston një konsensus I përgjithshëm se që të mund të zhvillohen aktivitete “opsionale” apo “sociale”, dy janë elementet kryesor që duhet të ofrojë një hapësirë publike: mundësi të mira për tu ulur dhe mundësi të mira për të ecur:

“Hapësirat publike që ofrojnë shumë cilësi dhe disa disavantazhe frymëzojnë një spektër të gjerë të veprimtarive urbane. Rrugë dhe vende tërheqëse për të ecur, vende për të ndaluar gjatë rrugës, inkurajimi I fluksit të lëvizjes këmbësore I cili nga ana e vet nxit socializimin dhe aktivitete rekreative, sepse njerëzit që ecin së bashku frymëzohen për të qëndruar më gjatë dhe për të shijuar skenën urbane.” (Gehl dhe Gemzøe, 2000; f. 14)

Dy autorët kryesor që kanë analizuar rëndësinë e vende për tu ulur në suksesin e hapësirës publike janë arkitekti danez Jan Gehl’s *Life Between Buildings* dhe urbanisti William H Whyte’s *City: Rediscovering the Centre* (1988):

“Vetëm kur ekzistojnë mundësitë për t’u ulur, mund të ketë kohëzgjatje të qëndrimit në hapësirë për secilin. Nëse këto mundësi janë të pakta ose të këqija, njerëzit thjesht ecin përpara. Kjo do të thotë jo vetëm që qëndrimi në hapësirën publike është i shkurtër por edhe që përjashtohen shumë aktivitete tërheqëse dhe të vlefshme në natyrë. Ekzistenca e mundësive të mira për ulje hap rrugën për aktivitete të shumta që janë atraksione kryesore në hapësirat publike: ngrënia,

leximi, gjumi, luajtja e shahut, banja në diell, shikimi i njerëzve, biseda, etj.” (Gehl, 1996; f. 157)

"Cilado qofshin atraksionet e një hapësire, ajo nuk mund t'i shtyjë njerëzit të vijnë dhe të ulen nëse nuk ka vend për t'u ulur." (Whyte, 1988; f. 112)

Mundësitë e uljes mund të ndahen në dy kategori: ulje "primare" ose zyrtare duke iu referuar stolave dhe karrigeve dhe mundësi "sekondare" ose joformale të uljes si shkallët, piedestalet, parvazet, shkallët, bazamentet, etj. (Gehl, 1996; f. 163)

Lidhur me stolat e kudogjendura, megjithëse pozicionimi i tyre duhet të përputhet me kujdes me konfigurimin e mjedisit ku ndodhen, dy karakteristika janë të domosdoshme për përdorimin e tyre me sukses: të qenit i pozicionuar mirë dhe i rehatshëm. Për sa i përket pozicionit, variant më i mirë është kur ato vendosen drejt peizazhit kryesor të shikimit (p.sh. lumi, vendi publik) ose drejt rrjedhës kryesore të këmbësorëve, për të lejuar aktivitetin e përbashkët të njerëzve që shikojnë (Whyte, 1988).

Për sa i përket komoditetit, stolat duhet të projektohen në mënyrë që të jenë të lehtë për t'u ulur ose për t'u ngritur prej tyre, veçanërisht në lidhje me kategoritë më të ndjeshme të përdoruesve: fëmijë dhe njerëz të moshuar. Në përgjithësi stola me shpinë - të vendosura në mënyrë ideale në një kënd prej 95-105 gradë me mundësi për tu mbështetur. (ëëë.pps.org)

Në lidhje me të gjitha variantet për t'u ulur Whyte (1980) zbuloi se:

“Nje dimension vërtet i rëndësishëm dhe shumë shpesh i neglizhuar apo i injoruar nga arkitektet është shpina njerëzore. Nuk ndodh shpesh që të gjesh nje stol që të jetë mjaftueshëm të gjerë për tu ulur nga të dyja anët. Disa nuk janë mjaftueshëm as për tu ulur në një anë.” (Whyte, 1988; p.114)

Sipas Carmona et al. 2008 në listën e cilësive universale positive që duhet të përmbaj një hapësirë publike ai thekson se një hapësirë publike ideale duhet të jetë:

► *E pastër dhe e rregullt*-të ketë pastrim dhe mirëmbajtje të vazhdueshme (e pastër nga mbeturinat, posterat e reklamimit, makina të braktisura, aroma të kqija, baltë dhe pluhur, të ketë vend-grumbullime të përshtashme për mbetjet, vende për qentë.

► *E rehatshme*- e rehatshme për të shpenzuar kohe në të (të mos ketë trafik të rënduar, zhurma të forta të mjeteve të transportit, industri të rëndë, prezencë të mobilimit urban rrugor, sipërfaqe të rehatshme për tu ulur, tualete publike, steha mbrojtëse, e lexueshme, sinjalistikë e qartë, hapësira të jetë e mbrojtur.

► *E sigurt* -Të jetë e sigurt dhe ta transmetoj këtë ndjesi tek përdoruesit (automjetet të kenë shpëjtësi të ulët, këmbësor, siguri për ciklistët, nivele të ulta të krimit në rrugë, të mos ketë sjellje anti sociale, e pastër dhe e mbikqyrur, prania e autoriteteve, preceptimi i sigurisë).

Duke qënë se siguria është elementi kyç për të ndërtuar jo vetëm hapësira të shëndetshme, funksionale, produktive por gjithë qytetin duke siguruar gjithëpërfshirjen, duhet përdorur si një instrument i rëndësishëm i zhvillimit të qëndrueshëm duke sjell për rrjedhojë përfitime mjedisore, sociale dhe ekonomike.

‘Sytë tek rruga’ është një strategji tjetër për promovimin e sigurisë së hapësirës publike me një arsytim mjaft të veçantë. Duke ndjekur studimet e Jane Jacobs (2010), kjo strategji thekson se si përdoruesit e hapësirës publike dhe ata të ndërtesave përreth mund të luajnë një rol themelor në parandalimin e krimit dhe vandalizmit. Gjatë natës ka më pak njerëz jashtë, më pak vëzhgime duke bërë që rreziku të ndihet më tepër se zakonisht. Ndriçimi i mirë duhet të jetë i ngrohtë, mikpritës, i bollshëm dhe i orientuar drejt aspekteve të rëndësishme shoqërore, njerëzve dhe fytyrave të tyre, dhe sipërfaqeve horizontale, por në të njëjtën kohë nuk duhet të jetë shumë intensive, pasi mund të shkaktojë shkëlqim “verbues” (Gehl, 2006; A. B. Jacobs, 1995)

Sic përmendëm edhe më sipër, Jane Jacobs (1961) është shprehur në “Eyes on the street”, se një mjedis që nxit zhvillimin e aktiviteteve të ndryshme, diversitet përdoruesish është një mjedis i sigurt dhe për rrjedhojë mund të arrijë nxitjen e kohezionit social. Tibbalds (1992) na jep një përshkrim më të detajuar të një mjedisi të tillë:

“Ne të gjithë përjetojmë diskomfort ose shqetësime në situata të caktuara urbane. Ndërsa shumë njerëz kërkojnë vetmi në një mjedis rural, në një mjedis urban, mungesa e njerëzve mund, në rastin më të mirë, të krijojë një mjedis të mjerueshëm ose të shurdhër dhe, në rastin më të keq, të krijojë një kërcënim, alarm ose panik në një endacak të vetmuar. Veçanërisht për gratë, të rinjtë, të moshuarit, të dobëtit dhe të ndrojturit, perspektiva - reale ose e imagjinuar - e agresionit, përqeshjes, përdhunimit dhe krimeve të tjera kundër personit, rri në çdo cep të rrugës së shkretë dhe në çdo autobus pothuajse të zbrazët.” (Tibbalds, 1992; f. 27)

Për më tepër, shqetësimet e sigurisë në lidhje me kriminalitetin janë një nga nxitësit më të fortë të politikës aktuale të hapësirës publike dhe janë një pjesë themelore e komoditetit psikologjik në hapësirat publike. Shqetësimi i ligjshëm për promovimin e sigurisë së njerëzve ka çuar në përpjekje për të kontrolluar përdorimin e hapësirës publike, përmes menaxhimit dhe masave të dizajnit. Meanxhimi është përqëndruar gjithënjë e më tepër për të ofruar siguri, përkatësisht duke rritur mbikëqyrjen, përmes forcave të rendit ose CCTV, efekti dekurajues i të cilit është i

diskutueshëm (Carmona et al. 2008). Më e rëndësishme është marrëdhënia e tensionuar midis promovimit të sigurisë dhe çështjeve më të gjera të aksesit në hapësirat publike, pasi administratat kanë kërkuar në mënyrë aktive të eliminojnë disa sjellje dhe kategori përdoruesish nga hapësirat publike.

Në anën tjetër komforti është njëzetë kriter i rëndësishëm dhe duke pasur parasysh impaktet e ndryshme që ai ka në hapësirën publike, varion në disa spektre ndikimi si:

- Komfort termal
- Komfort visual
- Komfort akustik
- Nuhatja
- Ndotja e ajrit
- Lehtësia për të lëvizur në hapësirë dhe për tu ndjerë i sigurt
- Kushtet e shtrimit të rrugës
- Kushtet e ndricimit
- Cilësia estetike e mjedisit
- Gjendja e trafikut

Sipas Projects for public space 2018, në më të mirën e saj një hapësirë publike duhet të ndihet si një vazhdimësi e hapësirës së shtëpisë dhe një ndjesi të fortë familjariteti e cila buron nga ndjesia e komfortit në të. Nëse njerëzit ndihen fizikisht dhe psikologjikisht komfort në një hapësirë, ata kanë tendencën të jenë të hapur kundrejt të tjerëve, të ndërveprojnë me te tjerët, duke i kthyer hapësirat publike në vende “të treta” midis punës dhe shtëpisë, ku zhvillohet pjesa më e madhe e jetës sociale.

Ka një mori thujse të pafundme treguesish për komfortin në hapësirën publike por Projects for public space liston pesë kriteret kryesore:

-Gjuha e trupit

Siç Fred Kent, themelues i Project for public space, vëren: “Mund ta vesh re direkt nëse dikush ndihet komod apo jo”. Postura e qëndrimit është më e qetë, më e lirshme. Ritmi i tyre ngadalësohet madje edhe lëvizjet e syve mund të ndryshojnë, pasi ata zhvendosen në një hapësirë për të marrë pjesë në atë vend. Këto sjellje delikate së bashku shënojnë një çlirim të tensionit dhe shenjat e hershme të komoditetit në rritje.

-Të gjithë njerëzit në çdo kohë

Një hapësirë realisht komode duhet të jetë e tillë për të gjithë njerzit e të gjitha moshave, gjinive apo aftësive. Nëse nuk është e tillë atëherë kategoritë e prekura të përdoruesve thjesht nuk do të jenë prezentë. Një vend i këndshëm për t'u ulur mund të sjellë një ndryshim të madh për njerëzit me lëvizshmëri të kufizuar. Vende të vendosura mirë, vende tërheqëse, sjellin njerëzit në një hapësirë në një mënyrë të tillë që pak gjëra të tjera mund ta bëjnë. Por të gjithë stolat dhe tavolinat në botë janë shumë pak të dobishme nëse, për shembull, gratë nuk ndihen të sigurta duke i përdorur ato, ose nëse nuk janë të arritshme për këdo. Në këtë mënyrë, nëse një hapësirë nuk perceptohet si e sigurt natën apo në ditë me mot të keq, njerëzit thjesht nuk do të shkojnë aty. Gjatë natës një ndricim i mirë mund ta ndihmojë një hapësirë që të ndihet si e sigurt por asgjë më tepër se prania e njerzve të tjerë nuk e bën të ndihet e tillë. Në mënyrë të ngjashme, aktivitetet mund të zhvillohen përgjatë gjithë vitit nëse një hapësirë përmban atributet e duhura për këtë. Që hapësira publike të evitohet mungesa e aktiviteteve në sezona të caktuara, ato duhet të ofrojnë gjëra të tilla si hije, ujë, vende të freskëta në verë dhe vende të ngrohta në dimër. Një shembull ilustrues për këtë është Harvar Plaza, në të cilën janë vendosur në mënyrë të suksesshme grumbuj zjarri dhe lojra për njerëzit që të grumbullohen përreth.

#### -Afeksioni

Në rrënjët e tyre, llojet e sjelljeve që diskutuam me lart, mbi afeksionin midis njerëzve, të gjitha burojnë nga një ndjenjë rehatie. Kur njerëzit janë në gjendje të pushojnë në një hapësirë publike, ata gjithashtu pushojnë rreth njëri-tjetrit. Kjo është arsyeja pse afërsia, ndarja, prekja, buzëqeshja, kontakti me sy dhe shfaqja e dashurisë në publik nuk janë vetëm tregues të mirë të dashurisë, por edhe tregues të besueshëm të komoditetit në të.

#### -Improvizimi

Shkalla e improvizimit në një hapësirë publike mund të jetë tregues pozitiv ose negativ i faktit se sa e rehatshme është një hapësirë publike. Nga njëra anë, ndërveprime dhe aktivitete më spontane shoqërore ndodhin kur njerëzit ndihen të sigurt, të mirëpritur dhe të rehatshëm. Nga ana tjetër, improvizimet mund të jenë gjithashtu një shenjë se diçka mungon në një hapësirë. Për shembull, kur dizajnuesit e hapësirës nuk ofrojnë mundësi të mira për tu ulur atëherë, përdoruesit do të shpikin të tyre, duke u ulur në gjithcka që mund të hasin - shtylla, biçikleta, karroca për fëmijë, shkallë etj.

#### -Përdorimi i zakonshëm dhe sjellja 'shtëpiake'

Sipas Fred Kent, këmbët e zhveshura janë një nga treguesit më të mirë të një hapësire të rehatshme. Kjo sepse njerëzit i trajtojnë hapësirat e mëdha publike si një dhomë tjetër në shtëpinë e tyre. Ata heqin këpucët dhe ngrenë këmbët. Ata kalojnë kohën aty duke ndenjur,

duke dremitur dhe konsumojnë ushqime ashtu si do të bënin në shtëpinë e tyre. Shpesh duhet kohë për të krijuar këtë ndjenjë intimiteti dhe familjariteti në publik, që do të thotë se vizita e kthimit mund të jetë një pararendës i rëndësishëm i këtyre sjelljeve 'shtëpiake'. Me fjalë të tjera, sa më shumë "të rregullt", aq më e mirë është cilësia e hapësirës ku ndodhen.

Edhe nëse një hapësirë është e bukur nga pikëpamja estetike, nëse nuk është e rehatshme do të mbetet e papërdorur dhe pak e preferuar për njerëzit. Komoditeti nuk është një luks ose diçka "ekstra" për një hapësirë të mirë-dizajnuar. Në fakt, disa nga komoditetet më efektive që kontribuojnë në rehati janë joformale, të lira dhe madje të shëmtuara. Por ndonjëherë kjo mungesë komoditeti nuk është gabim.

Projektuesit dhe menaxherët shpesh i bëjnë hapësirat publike qëllimisht të pakëndshme: arkitektura armiqësore dhe mbikqyrja e hapësirës janë bërë të zakonshme në përpjekjet për të zhvendosur njerëzit e pastrehë. Këto përpjekje të gabuara gjithmonë do të dështojnë të krijojnë vende që ti bëjnë njerëzit të ndihen si në shtëpinë e tyre, dhe më e rëndësishmja, atyre u mungon thelbi i hapësirës publike - që ajo mirëpret dhe i jep rehati të gjithëve.

Një dimension themelor i rehatisë fizike lidhet me motin, në këtë kontekst hapësirat publike duhet të sigurojnë mbrojtje nga kushtet e pakëndshme. Hapësirat publike duhet të projektohen në mënyrë që të bjerë sa më shumë sipërfaqe e tyre nën zonat e rehatisë 'së njerëzve, pra një ansambel të kushteve të rehatshme për të gjitha llojet e motit. Ekspozimi në diell duhet maksimizuar por në të njëjtën mënyrë duhet të ofrohen steha të mjaftueshme për kushte të ashpra të motit. Në kushtet kur një ekspozim i drejtpërdrejtë nuk është i mundur, duhet analizuar mundësia e sipërfaqeve reflektuese për sa kohë ato nuk do të ishin të rrezikshme në kontekstin e përdorimit të hapësirës. (Marcus & Francis, 1990). Kështu ekspozimi kundrejt rrezatimit të diellit duhet të maksimizohet por në anën tjetër duhet të ofrohen streha për kushte të një moti të ftohte.

Gjerësia e trotuarit gjithashtu është një çështje e rëndësishme për sigurimin e komoditetit në hapësirat publike, por nuk ekziston faktikisht një gjerësi universale optimale, pasi ato varen nga flukset e trafikut të motorizuar, dendësia dhe lloji i funksioneve përreth, frekuenca e hyrjes në ndërtesa, sipas nevojës për gjelbërim, mobilim rrugor dhe hapësira parkimi (Moura e sá, 2010)

Një aspekt i rehatisë psikologjike lidhet me konfigurimin hapësinor të mjedisit, pasi mund të rrisë komoditetin dhe kënaqësinë e përgjithshme të përdorimit të hapësirës, sidomos në lidhje me parametrat e perceptimit vizual. Hapësira përcaktohet vertikalisht nga ndërtesa, lartësitë e mureve dhe pemëve ndërsa horizontalisht nga shtrirja dhe ndarja e elementeteve definuese (Jacobs, 1995). Konfigurimi vertikal është një diskutim midis proporcionit me madhësinë absolute: sa më e gjerë të jetë një rrugë, aq më e madhe është lartësia ose masa e ndërtesës në mënyrë që ta kufizoj hapësirën në raportin e duhur. Pavarësisht nga disa udhëzues metrikë, madhësia absolute e hapësirave nuk duket të jetë një faktor kritik për përdorimin e tyre (Whyte, 1990). Përvetse të evitohet ndërtesat e larta dizajni duhet të krijoj edhe qoshe të izoluara. E thënë në një mënyrë më të përgjithshme, ndërtesat e ulta dhe rrugët gjarpëruese kanë një efekt pozitiv në mbrojtjen nga era (Gehl, 2006).

Zhurmat janë një tjetër karakteristikë ambientale me një impakt të madh në komfortin e hapësirës publike, sidomos për bisedat dhe momentet e relaksit. Zhurmat “e bardha” sic janë ato të baseneve ujore mund ti mbulojnë zhurmat e tjera (Whyte, 1990). Gjithashtu mirëmbajtja e vazhdueshme e hapësirës është një faktor shumë i rëndësishëm i komfortit. Përzgjedhja e materialeve duhet të parashikoj mirëmbajtjen në të ardhmen në varësi të resurseve të disponueshme (Jacobs, 1995).

Komforti fizik lidhet gjithashtu me një dizajn ergonomikë. Ndryshimet në të njëjtin nivel kanë përgjithësisht efekte positive, por gjithmonë ka ndonjë pengesë që duhet kapërcyer. Në rastet kur mbajtja e një niveli nuk është e mundur, dizajni duhet të lehtësoj përdorimin midis ndryshimit të niveleve nëpërmjet plaformave e pjerrësive të buta ose rampave (Gehl, 2006). Lartësia e elementëve për tu ulur duhet të përcaktohet në përputhje me lartësinë mesatare të një personi, edhe pse grupe të caktuara përdoruesish mund të zgjedhin ulëse më pak të përshtatshme sipas nevojave të tyre.

Stolat e thella, pa shpinë lejojnë që njerëzit të ulen në të dy anët, por të paktën disa vende me shpinë duhet të sigurohen për përdorues më pak të aftë fizikisht (Gehl, 2006; Whyte, 1990). Megjithëse ato janë bërë më të rralla në hapësirat publike, për shkak të vandalizmit, pasigurisë dhe kërkesave të larta për mirëmbajtje (Whyte, 1990), tualetet publike janë të rëndësishme për rritjen e komoditetit dhe qëndrimin më të gjatë në hapësirat publike (Carr et al., 1992).

Trafiku i motorizuar, përveç cilësive fizike të mjedisit, renditet në faktorët me një ndikim të thellë në përdorimin e hapësirës publike, gjithashtu në një mikro-shkallë. Trafiku intensiv ose i shpejtë në mjediset e hapësirave veçanërisht ndikon në aktivitetet jo të domosdoshme, pra aktivitetet opsionale pasi zvogëlon komoditetin dhe kufizon lëvizjen e këmbësorëve (Gehl,



2006). Këto ndikime negative të trafikut të motorizuar janë të lidhura me nivelin e perceptimit të sigurisë në hapësirë. Një zonë e vogël dhe jo e përshtatshme për këmbësorët për rrjedhojë do të kthehej në një zonë të rrezikshme pasi do të drejtonte këmbësorët drejt rrugës së automjeteve (Whyte, 1990). Ndërsa ndarja fizike e hapësirës së këmbësorëve dhe automjeteve ka qenë masa më e zakonshme për të siguruar këmbësorët, nuk u siguron atyre domosdoshmërisht një ndjenjë sigurie dhe qetësie. Këto mund të intensifikohen nga pemët dhe parkimi gjatësor (A. B. Jacobs, 1995). Në rrugë të ngushta dhe shumë të zëna, dhe në ato rezidenciale, hapësirat e përbashkëta mund të jenë opsioni më i sigurt (Gehl, 2006; A. B. Jacobs, 1995).

Hapësira midis ndërtesave është thelbësore në përcaktimin horizontal të rrugëve; përsa i përket përcaktimit vertikal ende nuk është shumë e qartë se cilat dimensione absolute e përcaktojnë atë. (Jacobs 1995) Jacobs gjithashtu shprehet se një hapësirë më e vogël midis ndërtesave ofron një konfigurim më të mirë të saj. Gjatësia e rrugës është gjithashtu e rëndësishme për konfigurimin por jo vendimtare. Gjithsesi, është më e veshtirë të ruash interesin visual dhe diversitetin në një rrugë të tillë.

Në rrugë shumë të gjera, vendosja e pemëve në menyrë të rregullt dhe të përsëritur, si dhe e elementeve të tjerë vertikal mund të ndihmojnë në zvogëlimin e shkallës së madhe në raport me njëriun (Jacobs, 1995). Komoditeti dhe kënaqësia promovohen gjithashtu kur ndërtesat janë komplementare, duke transmetuar kështu një ndjenjë të rregullsisë dhe rendit, duke nënkuptuar ngjashmëri si në pamje ashtu edhe në gjatësi (Jacobs, 1995), por jo domosdoshmërisht kjo të jetë një sinkron zhvillimi më tepër sesa një ngjashmëri stilistike.

Jo domosdoshmërisht të gjithë faktorët që ndikojnë në psikologjinë njerëzore, për tu ndier komfort, janë subjektiv.

S. Reiter & A. De Herde, në studimin e tyre mbi kriteret sasimore dhe cilësore të komfortit, listojnë pesë parametra esenciale në komfortin njerëzorë në hapësirën publike:

#### *1-Marrëdhënia me kontekstin*

Duke qënë se komforti termik në hapësirën publike varet thellësisht nga konteksti urban, atëherë është shumë e rëndësishme sesi implementohet mobilimi urban në natyrë. Për të zgjidhur këtë problem është e rëndësishme të studiohet me imtësi konteksti urban dhe njerzor në varësi të vendndodhjes, sezonit, aktiviteteve potenciale etj. Është e nevojshme të krijohen hapësira që integrojnë aktivitetet nga më të mundshmet, kohën që njerëzit do të kalojnë atje dhe preferencat e tyre klimatike. Asnjë vendim nuk mund të merret sipas mikroklimës pa marrë

parasysh vendin, ndryshimet e tij të përkohëshme dhe përdorimin e tij. Kur dhe si një hapësirë do të përdoret nga banorët lidhet në mënyrë të dejtëpërdrejtë se çfarë lloj aktiviteti do të realizohet në një mjedis specifik. Për shembull, për çdo stinë korrespondon një lloj i vecantë i hapësirës publike. Në këtë mënyrë, do të ishte e nevojshme që të merren parasysh mundësi të ndryshme të përshtatjes së këtyre hapësirave në varësi të stinës. Secili projekt duhet të integrohet në mënyrë imperative me kontekstin.

### 2-Perceptimi i kontrollit të mundshëm

Perceptimi i kontrollit të mundshëm është një nga elementet më thelbësore të komoditetit në hapësirë. Paciuk pohon se stimujt e pakëndshëm janë më pak irritues kur subjektet perceptojnë se mund ta kontrollojnë ata (Paciuk 1990).

Kohëzgjatja e përvojës së përdoruesve gjithashtu ndikon në perceptimin e tyre të kontrollit. Një përvojë e sikletshme nuk shihet negativisht nëse individët parashikojnë që kohëzgjatja e saj të jetë e shkurtër (për shembull largimi i një makinë për t'u parkuar me një ndërtesë). Në të kundërt, është një aspekt kritik për sheshet ose vendet e pushimit pasi njerëzit e ndryshojnë kohëzgjatjen e tyre të pushimit në varësi të ndjesisë së rehatisë. (Nikolopoulou & Steemers 2000)

### 3-Diversiteti i mjediseve mikroklimatike

Sheshet të cilat ofrojnë zona me kushte të ndryshme diellëzimi apo hije përdoren për një kohë më të gjatë se ato që ofrojnë vetëm një lloj atmosfere (Nikolopoulou & Steemers 2000)

### 4-Vazhdimësia e kushteve klimatike

Të shkosh nga një zonë e pakëndshme drejt një zone më të rehatshme është më e lehtë të pranohet edhe pse ndryshimi është i menjëhershëm (Nikolopoulou & Steemers 2000). Mundësitë e krijimit të hapësirave të tranzicionit janë të pafundme. Ato varen nga klima, format e ndërtimit dhe planifikimi i qytetit.

### 5-Natyrallëti i vendit

Natyrallëti nënkupton një mjedis pa artificialitet. Karakteri natyror i një vendi është një parametër thelbësor për komoditetin e njerëzve. Modifikimet e rëndësishme të mjedisit tolerohen më mirë në hapësira ku ndryshimet klimatike shfaqen me natyrshëm sesa në zonat e tjera (Nikolopoulou & Steemers 2003).

Jeta moderne na izolon gjithnjë e më shumë nga bota natyrore. Duke marr parasysh edhe procesin e urbanizimit, arrijmë në dy konkluzione

- ne duhet të rrisim elementët natyrorë në qytetet tona.

- ne duhet të konceptojmë hapësira që ofrojnë karakteristika të ngjashme me ato të parashikuara në botën natyrore.




Figure 15. Skema e funksionimit të komfortit (Burimi: Autori)



Figure 16. Grafiku I komfortit të hapësirës publike

Konfigurimi fizik është një linjë funksionimi midis dimensionit fizik të hapësirës, pra kushteve fizike, konfigurimit, menaxhimit dhe dimensionit psikologjik të përdoruesit. Marrëdhënia e tyre është në përpjestim të drejtë, pra duhet të përmbushet dimensionin fizik që të ekzistoj dimensionin psikologjik, e kundërta nuk funksionon.

#### **4.4 Kategoria IV e Ontologjisë: Vizualisht tërheqëse- Hapësira publike si element I dizajnit urban**

Në këtë kategori të ontologjisë së hapësirës publike do të diskutojmë për dimensionin social të dizajnit urban. Sic është përmendur në pikat e mësipërme, marrëdhënia hapësirë-përdorues është konceptuar si një proces i vazhdueshëm dy-palësh në të cilin njerëzit (dhe shoqëritë) krijojnë dhe modifikojnë hapësira, ndërsa në të njëjtën kohë ndikohen prej tyre në mënyra të ndryshme. Dear dhe Walch (1989) argumentojnë se marrëdhëniet shoqërore mund të jenë: *të konstituara përmes hapësirës* (p.sh. ku karakteristikat e mjedisit ndikojnë në percaktimin e formes); *te kufizuara nga hapësira* (p.sh. kur ambienti fizik lehtëson ose pengon aktivitetin njerëzor); dhe *te ndërmjetësuar nga hapësira* (p.sh. kur kontaktet fizike gjete levizjes, lehtësojnë ose pengojnë zhvillimin e ndërveprimeve të ndryshme shoqërore). Prandaj, duke duke planifikuar ndërtimin e një hapësire, projektuesit urban ndikojnë në modelet e veprimtarisë njerëzore dhe të jetës shoqërore.

Carmona et al. në librin “The dimensions of urban design”, liston pesë aspekte kryesore të dimensionit social të dizajnit urban, të cilat janë:

##### *1-Marrëdhënia midis njerëzve dhe hapësirës*

Një kuptim i marrëdhënies midis njerëzve ('shoqëria') dhe mjedisit të tyre ('hapësira') është thelbësorë në kuptimin e modelit urban. Ideja e parë që duhet marrë në konsideratë këtu është ajo e determinizmit arkitektonik ose mjedisor, pra te gjitha eventet, përfshirë këtu edhe sjelljen njerëzore janë të përcaktuara nga shkaqe të jashtëme dhe jo nga dëshira e brendshme. E përkthyer në rastin e hapësirës publike është që mjedisi fizik ka një ndikim përcaktues mbi sjelljen

njerëzore. Duke mohuar rolin e dëshires njerëzore, supozon se bashkëveprimi mjedis - njerëz është një proces i njëanshëm. Megjithatë, njerëzit nuk janë pasivë; ato ndikojnë dhe ndryshojnë mjedisin, pasi ndikojnë dhe ndryshojnë ato. Prandaj, është një proces i dyanshëm. Ndërsa faktorët fizikë nuk janë as ndikimi I vetem dhe as domosdoshmërisht mbizotërues në sjellje, mundësitë mjedisore ndikojnë qartë në atë që njerëzit mund të bëjnë dhe nuk mund të bëjnë: prsh. një dritare në një mur lejon që dikush të shohë, ndërsa një mur i vazhdueshëm nuk e jep atë mundësi. Prandaj, sjellja njerëzore është e natyrshme 'situacionale': është e ngulitur në kontekste dhe ambiente fizike - dhe gjithashtu 'shoqërore', 'kulturore' dhe 'perceptuese'.

### 2-Ndërthurja e koncepteve 'sferë publike' dhe 'jetë publike'

E përmendur shpesh në diskutimet e dizajnit urban, 'sfera publike' - dhe koncepti i lidhur dhe i mbivendosur i 'jetës publike' - kërkojnë të merret më tepër në konsideratë 'Publiku' duhet të kuptohet përkundër 'privatit': në terma të gjerë, siç vërejnë Loukaitou-Sideris dhe Banerjee (1998, f. 1 75): 'Jeta publike përfshin kontekste relativisht të hapura dhe universale shoqërore, në të kundërt në jetën private, e cila është intime, e njohur, e mbrojtur, e kontrolluar nga individit dhe e ndarë vetëm me familjen dhe miqtë. 'Fusha publike ka dimensione 'fizike' (hapësirë) dhe 'shoqërore' (veprimtari). Fusha publike fizike nënkupton hapësirat dhe mjediset - në pronësi publike ose private - që mbështesin ose lehtësojnë jetën publike dhe ndërveprimin social. Aktivitetet dhe ngjarjet që ndodhin në ato hapësirat dhe mjedise mund të quhen *sfera publike sociokulturore*.

E përcaktuar si mjedisi dhe cilësitë e jetës publike, duke përfshirë disa nocione të 'hapësirës publike', sfera publike funksionon në mënyrë ideale si një forum për veprim politik dhe përfaqësim; si një terren 'neutral' ose i përbashkët për ndërveprimin shoqëror, ndërthurjen dhe komunikimin; dhe si një fazë për të mësuarit shoqëror, zhvillimin personal dhe shkëmbimin e informacionit (Loukaitou-Sideris dhe Banerjee, 1 998, f. 1 75). Megjithëse këto funksione rrallë arrihen tërësisht në praktikë, përkufizimi i tyre siguron një masë të shkallës nga e cila sfera publike, devijon nga konstrukti ideal I saj.

### 3-Nocioni I distriktit (lagjes)

Thelbi i dizajnit të lagjes është që, nëse lagje të suksesshme dhe të dëshirueshme ekzistojnë, duhet - në parim - të jetë e mundur të krijohen të ngjashme. Ekziston një traditë e zhvilluar mirë mbi dizajnin e lagjes. Shembulli më domethënës ishte njësia e lagjes së Clarence Perry, e zhvilluar në SH.B.A. 1920 (Kutia 6. 3), si një mjet për organizimin dhe zhvillimin sistematik

në zonat e ndryshme të qytetit. Inkorporuar brenda modelit fizik, kishte objektiva kryesor shoqërore të tilla si ndërveprimi me fqinjët, krijimi i një ndjenje të komunitetit dhe identiteti. Tre janë aspektet kryesore që kanë zhvilluar tipologjinë e dizajnit të lagjeve.

*Së pari*, është pranuar gjerësisht se lagjet ofrojnë *identitet dhe karakter*, duke krijuar ose rritur një *ndjenjë të vendit*. Ndërsa kjo mund të jetë një ndjenjë relativisht sipërfaqësore e identitetit me karakterin fizik të zonës, ajo gjithashtu mund të sigurojë një sens të thellë dhe më kuptimplotë të identitetit me karakterin sociokulturor të vendit (d.m.th. përmes përvojës në kohë të atij vendi).

*Së dyti*, lagjet ofrojnë një mënyrë relativisht pragmatike të planifikimit të zonave urbane (me ose pa i atribuar objektiva social), me teper sesa një sistem i automatizuar, ka përpjekje për të kontribuar në diçka më të madhe - një zonë me përdorim të përzier ose 'të ekuilibruar' sesa një pronë mono-funksionale e strehimit. Duke ndjekur gjithnjë e më tepër modele të zhvillimit të qëndrueshëm, lagjet mund të projektohen të jenë më të vetë-mjaftueshme, duke zvogëluar nevojën për të udhëtuar duke inkurajuar mundësi për punë dhe rekreacion afër mjedisit të shtepisë

*Së treti*, dhe disi më i diskutueshëm sesa dy aspektet e mësipërme, lagjet mund të shihen si një mjet për krijimin e zonave të ndërveprimit më të madh social. Projektimi i lagjes shpesh është shoqëruar me idenë e përcaktimit mjedisor në disa forma dhe përdorime të tokës të cilat ndihmojnë në krijimin e 'komuniteteve'. Gabimi i ngatërimit të idesë së lagjeve "fizike" (të përcaktuara nga territori ose kufijtë) me komunitetet "sociale" (të përcaktuara nga marrëdhëniet, shoqatat, etj.) është ekspozuar gjithnjë e më shumë. Blowers (1973) identifikuan pesë lloje të lagjeve ku secila njihet si e tillë dhe vetëm lloji i fundit ka atributet e një komuniteti:

- Lagjet 'arbitrare', ku i vetmi tipar i përbashkët është afërsia hapësinore.
- Lagjet 'Ekologjike' dhe / ose 'etnologjike', me një mjedis dhe identitet të përbashkët.
- Lagje 'Homogjene', të banuara nga grupe të veçanta socio-ekonomike ose etnike.
- Lagjet 'funksionale', që rrjedhin nga hartografimi gjeografik i ofrimit të shërbimeve.
- 'Lagjet e komunitetit', në të cilat grupe homogjene shoqërore ndërveprojnë në kontakte primare

#### 4-Problematikat në lidhje me sigurinë

Njerëzit përballen me një shumëllojshmëri kërcënimesh në mjedisin urban: krimi, terrorizmi, automjete që lëvizin me shpejtësi, ndotja e ajrit, ndotja e ujit, etj. Në disa vende kërcënimi i katastrofave natyrore është një frika e përditshme për t'u përballur në projektimin e ndërtesave

dhe vendbanimeve. Në shumicën e shoqërive perëndimore, megjithëse tani janë shumë kërcënime 'natyrore'të menaxhuara në mënyrë të pershtatshme, kërcënimet e tjera 'njerëzore' - reale ose të imagjinuara - janë në dukje në rritje. Këto përfshijnë sigurinë në rrugë dhe frikën nga krimi. Siguria lidhet me 'mbrojtjen' e familjes dhe miqve të dikujt, individit dhe pronës së komunitetit. Mungesa e sigurisë, perceptimi i rrezikut dhe frika e viktimizimit, kërcënojnë si përdorimin e sferës publike, ashtu edhe krijimin e mjediseve të suksesshme ubane. Një ndjenjë e sigurisë është, pra, një parakusht thelbësor i një modeli të suksesshëm urban. Sidoqoftë, rritja e sigurisë është arritur shpesh nga privatizimi dhe tërheqja nga sfera publike. Në termat e dizajnit urban, privatizimi zakonisht përfshin kontrollin e territoreve ose hapësirave të caktuara me anë të veçimit (të tilla si distanca fizike, muret, portat dhe pengesat më pak të dukshme për të përjashtuar botën e jashtme dhe kërcënimet dhe sfidat e perceptuara) dhe gjithashtu me anë të pranise së forcave të rendit dhe përdorimi i kamerave të mbikëqyrjes.

#### 5-Problematikat në lidhje me aksesin dhe përjashtimin nga hapësira publike

Një element kryesor i çdo diskutimi të fushës publike është aksesueshmëria. Ndërsa sipas përkufizimit, sfera publike duhet të jetë e arritshme për të gjithë, disa mjedise janë - me dashje ose pa qëllim - më pak të arritshme për pjesë të caktuara të shoqërisë. Përjashtimi shpesh krijon ose përforcon nocione të 'ekskluzivitetit' ose 'siguri'. Në thelb, ai është një manifestim i fuqisë përmes kontrollit të hapësirës dhe qasjes në të. Forca të ndryshme në shoqëri me qëllim e zvogëlojnë mundësinë e hyrjes në mënyrë që të kontrollojnë mjedise të veçanta, shpesh për të mbrojtur investimet. Sidoqoftë, nëse kontrolli i hyrjes praktikohet qartë dhe gjerësisht, publiku është i kompromentuar. Ndërsa strategjitë e dizajnit mund të mundësojnë dhe rrisin përjashtimin dhe përfshirjen, ideja që duhet të japin mjediset është rritja e mundësisë së zgjedhjes dhe të jenë gjithëpërfshirëse.

Carr et al. (1992, f. 138) identifikon tre forma aksesit:

- Aksesit vizual (dukshmëria): nëse njerëzit mund të shohin në një hapësirë para se të hyjnë në të, ata mund të gjykojnë nëse do të ndiheshin rehat, të mirëpritur dhe sigurt atje.
- Aksesit simbolik: shenjat (simbolet) mund të jenë të gjalla ose pajetë. Për shembull, individët dhe grupet perceptohen ose si kërcënues, ose si ngushëlluese ose ftuese dhe mund të ndikojnë në hyrjen në një hapësirë publike, ndërsa elementë të tillë si lloje të veçanta të dyqaneve mund të sinjalizojnë llojin e njerëzve që janë të mirëpritur atje.
- Aksesit fizik ka të bëjë me faktin nëse hapësira është fizikisht e disponueshme për publikun. Përjashtimi fizik është pamundësia për të hyrë ose për të përdorur mjedisin, pavarësisht nëse mund të shihet apo jo.

Mundësia e aksesit dhe përjashtimi mund të diskutohen në lidhje me menaxhimin e fushës publike (d.m.th. parandalimi ose përjashtimi i sjelljes shoqërore të padëshirueshme). Menaxherët dhe pronarët e hapësirës gjysmë-publike kanë motive të ndryshme për të kontrolluar veprimtarinë, siç janë përgjegjësia e tyre për mirëmbajtje, përgjegjësia për ato që mund të ndodhin brenda hapësirës dhe shqetësimi për tregtinë. Përjashtimi i sjelljeve / aktiviteteve të caktuara mund të jetë një funksion edhe një objektivi - i menaxhimit ose regjimit të kontrollit.

Që nga vendosja e modelit urban si një disiplinë në vitet 1980, natyra e tij ka qenë mjaft e kontestuar dhe e pamundur të përcaktohet me saktësi (Knack, 1984; Rowley, 1994). Kjo shpjegohet gjerësisht nga një shumëllojshmeri disiplinash që përfshijnë - duke përfshirë një gamë të gjerë detyrash, duke qenë në kryqëzimin e arkitekturës dhe planifikimit dhe fushën e tij të shumëllojshme të ndikimit, për shkak të rëndësise të zhvillimit të proceseve dhe rendimentin që duhet të jap. Dizajni urban ka qenë tradicionalisht i lidhur me projekte në shkallë të gjerë dhe qasja që është krijuar për të në një shkallë të gjere është se duhet të funksionoj nga një shkallë e madhe në një shkallë të vogël, duke vendosur projektuesit në qendër të vendimmarrjes dhe autorësisë së projekteve të përfshira, por sot kjo qasje nuk është më e vlefshme. Ekziston një besim në rritje që dizajni urban ka të bëjë më shumë me aftësimin sesa me autorizimin, me një mjet sesa një qëllim dhe një proces më shumë sesa një produkt, me fjalë të tjera, dizajni urban është gjithnjë e më procedural (Shibley, 1982). Megjithatë, ka një numër autorësh që e shohin modelin urban si të angazhuar në mënyrë të barabartë në hartimin e produkteve të tij përfundimtare dhe mjedisit të tij të vendimit, ku veprojnë të gjithë palët e interesuara, përfshirë dizajnerët dhe jo-dizajnerët (Carmona, 2014). Për më tepër, me prevalencën në rritje të idealeve demokratike dhe devolucionin e pushtetit ndaj bashkësive lokale, modeli urban bëhet gjithnjë e më shumë nga jo-dizajnerët përmes përdorimit të tyre, praktikave sociale dhe bonifikimeve të hapësirave publike. Kjo është një ide e mbështetur nga libra të tillë si Loose Space (Franck and Stevens, 2007) dhe Insurgent Public Space (Hou, 2010). Prandaj, dizajni urban është gjithnjë e më i varur nga konteksti social, politik, ekonomik dhe kulturor dhe, duke vepruar kështu, varet nga përdoruesit, pronarët, menaxherët dhe dizajnerët, të cilët veprojnë si agjentë dhe përcaktojnë rezultatet e tij.

Në këtë kontekst, sipas Patricia Aelbrecht dhe Quentin Stevens, kjo ngre një seri sfidash për praktikën kontemporane të dizajnit urban. Dizajni urban gjithnjë e më shumë po kontestohet dhe politizohet, duke ngritur disa çështje etike dhe pyetje: Për kë po projektojmë? Cili është përdorimi i duhur ose i papërshtatshëm i hapësirës? Kush përcakton se çfarë është e mirë? Për



më tepër, ai ka kuptime, role dhe domethënie të ndryshme në vende të ndryshme, duke ngritur një pyetje themelore: A mund ta konsiderojmë atë një mjet të barabartë në sigurimin e hapësirave publike dhe promovimin e kohezionit social?

Patricia Aelbrecht dhe Quentin Stevens, kanë identifikuar pesë tema kryesore mbi dizajnin urban dhe rolin e tij në kohezionin social, duke filluar nga nivelet teorike të atyre ndërvepruese, procedurale, psikologjike dhe praktike, dhe duke lejuar një mori perspektivash mbi lidhjen midis dy zonave fokale të hartimit të hapësirës publike dhe kohezionit shoqëror. Këto tema janë si më poshtë:

- të krijojë tipologji të ndryshme të hapësirave publike të hapura;
- simbolika dhe ndjenja e përkatësisë;
- të hartojë elemente që inkurajojnë ndërveprimin shoqëror;
- proceset e angazhimit, pjesëmarrjes dhe marrjes së vendimeve;
- reflektime nga praktika e dizajnit urban.

Boshllëqet e konsiderueshme të njohurive janë të dukshme në literaturën e vendosur mbi këtë temë specifike të hartimit të hapësirës publike dhe kohezionit shoqëror, pavarësisht nga interesi dhe pranimi në rritje që hapësirat publike janë hapësira e kontaktit dhe mjetet thelbësore për të arritur kohezionin shoqëror. Së pari, kërkimi aktual zakonisht vuan nga një ndarje e njohurive midis fushave sociologjike dhe atyre të dizajnit urban. Këto studime ose fokusohen vetëm në aspektet makro-sociologjike të jetës shoqërore (Shields, 1992; Putnam, 2000; Hajer dhe Reijndorp, 2001) ose përqendrohet kryesisht në atributet fizike të hapësirës publike (Flusty, 1997; Loukaitou- Sideris dhe Banerjee, 1998; Nemeth dhe Schmidt, 2011).

Së dyti, ka pak shkëmbim njohurish midis teorisë dhe praktikës së modelit urban. Natyra e disiplinave të dizajnit tenton të luftojë kundër shkëmbimit të njohurive (Griffiths, 2004). Disiplinat e dizajnit urban në përgjithësi nuk kanë besim, entuziazëm dhe ashpërsi për t'u angazhuar me njohuritë shkencore. Organet e njohurive të praktikuesve janë heterogjene dhe disi hermetike (Marshall, 2012). Kjo shpjegon pse planifikuesit dhe projektuesit, edhe nëse paralajmërohen nga shkencëtarët socialë, vazhdojnë të mbrojnë politikën e përzierjes sociale si një artikull i besimit, pavarësisht se këta kanë dështuar shumë herë për të arritur qëllimet e tyre në këto fushe.

Së treti, një dominim kulturor i Veriut Global është gjithashtu i dukshëm, pasi shumica e literaturës prodhohet në dhe rreth botës perëndimore, veçanërisht në Mbretërinë e Bashkuar, Hollandë dhe Shtetet e Bashkuara (Talen, 1999; Dempsey, 2009; Peters et al., 2010). Kjo situatë ngre jo vetëm pyetje praktike nëse kjo njohuri mund të transferohet në kontekste të tjera

evropiane dhe pjesë të botës, por gjithashtu pyetje më të thella nëse kohezioni shoqëror dhe proceset e përfshira në ndërtimin e tij nuk janë në mënyrë dramatike të ndryshme në kontekste të ndryshme kulturore, veçanërisht në Jugun Global.

Duke krijuar hapësira ku një gamë e larmishme njerëzish mund të takohen, dizajni urban është në gjendje të rrisë nivelin e ndërveprimit shoqëror, integritit dhe besimit në shoqëri në mënyra që janë progresive dhe civilizuese shoqërore (Sennett, 1973). Kjo kërkon vëmendje për projektimin e ketyre mjediseve publike që mbështesin bashkëveprimin joformal shoqëror, dhe veçanërisht për elementet hapësinore që e mundësojnë atë (Stevens, 2006; Simões Aelbrecht, 2016). Shumë studiues janë përpjekur të identifikojnë cilësitë hapësinore që inkurajojnë ose dekurajojnë ndërveprimin, duke filluar me punimet themelore të sociologëve si Goffman (Goffman, 1963), teoricienë të dizajnit urban si Gehl (1971), Alexander et al. (1977), Joardar (1978) dhe Ehyte (1980), ndjekur nga psikologët e mjedisit Sommer (1974) dhe Carr et al. (1993) dhe teoricienët e peizazhit Marcus dhe Francis (1990). Sidoqoftë, vihet re një ndarje e njohurive midis kërkimeve sociologjike dhe atyre të dizajnit të hapësirës. Nga njëra anë, shkencëtarët socialë theksojnë vetëm cilësitë e përgjithshme që i bëjnë hapësirat publike miqësore, të arritshme dhe gjithëpërfshirëse pa ndonjë sugjerim për elementet e dizajnit që i formësojnë ato (Goffman, 1963; Oldenburg, 1997 [1989]; Lofland, 1998). Ato zakonisht u referohen cilësive shumë të përgjithshme që janë të rëndësishme për përdorimin shoqëror dhe lidhjen midis grupeve të ndryshme shoqërore dhe kulturore. Këto përfshijnë shumë përdorime, akses, të jenë me përdorim falas (ose me kosto të ulët), paraqitje të qartë, lokale dhe të njohura në karakter, të adaptueshme, jo të kufizuara nga gjinia, raca dhe klasa, të sigurt dhe të mirëpresin këdo përdorues (Loënsbrough dhe Beunderman, 2007).

Nga ana tjetër, studiuesit e dizajnit, megjithë teoritë e tyre të dobëta të jetës shoqërore, kanë prodhuar një grup të konsiderueshëm njohurish rreth socializimit në hapësirat publike dhe rolit të dizajnit urban në krijimin e tij. Punimet kryesore të Gehl, Whyte dhe Alexander dhe puna më e fundit nga Marcus dhe Francis (1990), Madanipour (1996), Kaplan et al. (1998), Childs (2004), Franck and Stevens (2007), Mehta (2013) dhe Simões Aelbrecht (2016) kanë identifikuar karakteristikat kryesore të dizajnit që mbështesin ndërveprimet shoqërore në një gamë të gjerë të llojeve të hapësirave, aktiviteteve, kontrollit dhe menaxhimit të kushteve. Pavarësisht nga interesat, përqendrimi dhe qasjet e tyre të ndryshme kërkimore, ata të gjithë kanë një kuptim të përbashkët se një hapësirë e mirë shoqërore publike u përgjigjet nevojave njerëzore dhe kështu është kontekstuale dhe e adaptueshme, dhe për këtë arsye nuk mund të përshkruhet, duke propozuar me teper parime të dizajnit sesa projekte. Lista e tyre e parimeve

është e larmishme, por zakonisht përfshin: *qëndrueshmërinë, kufinj te qarte, karakterin e vecante, përshkueshmërinë, lexueshmërinë, larminë dhe përshtatshmërinë*. Disa nga këta autorë i kanë çuar këto parime më tej dhe kanë identifikuar elemente specifike të dizajnit që ankorohen në shoqëri aktivitete (Gehl, 1971), ndërsa të tjerët kanë theksuar elementet që i bëjnë njerëzit të ndihen rehat në publik (Shaftoe, 2012), dhe elementet që mbështesin dhe zhvillojnë përdorime sociale joformale dhe të paplanifikuara (Stevens, 2006, 2007; Simoes Aelbrecht, 2016)

Një numër I madh autorësh, teoricienësh dhe planifikues kanë tentuar që të identifikojnë çlësitë që duhet të plotesoj dizajni I mire urban per te arritur krijimin e kohezionit social.

Kevin Lynch (1981: 118–9) ka identifikuar pesë dimensionet performance të dizajnit urban:

- *Vitaliteti* - shkalla në të cilën forma e vendeve mbështet funksionet, kërkesat biologjike dhe aftësitë e qenieve njerëzore.
- *Ndjësia* - shkalla në të cilën vendet mund të perceptohen dhe strukturohen qartë në kohë dhe hapësirë nga përdoruesit.
- *Përshtatja* - shkalla në të cilën forma dhe kapaciteti i hapësirave përputhet me modelin e sjelljeve që njerëzit kryejnë ose duan të përfshihen.
- *Aksesi* - aftësia për të arritur persona të tjerë, aktivitete, burime, shërbime, informacione ose vende, përfshirë sasinë dhe larminë e elementeve që mund të arrihen.
- *Kontrolli* - shkalla në të cilën ata që përdorin, punojnë ose banojnë në vende mund të krijojnë dhe menaxhojnë aksesin në hapësira dhe aktivitete.

Dy meta-kritere - 'efikasiteti' dhe 'drejtësia' - mbështesin dimensionet themelore. Efikasiteti në lidhje me kostot relative të krijimit dhe mirëmbajtjes së një vendi për çdo nivel të caktuar të arritjeve të dimensioneve të mësipërme mjedisore, ndërsa drejtësia lidhet me mënyrën në të cilën shpërndahen përfitimet mjedisore. Ne kete menyre, për Lynch (1981: 119) pyetjet kryesore ishin:

(i) cila është kostoja relative e arritjes së një shkalle të veçantë të vitalitetit, sensit, përshtatjes, aksesit ose kontrollit

(ii) kush po merr përfitime prej tyre.

Allan Jacobs dhe Donald Appleyard Në 'Drejt një Manifesti të Dizajnit Urban', (1987) sugjeruan shtatë qëllime 'thelbësore për të ardhmen e një mjedisi të mirë urban':

- *Jetesa* - një qytet duhet të jetë një vend ku të gjithë mund të jetojnë në një rehati relative.

- *Identiteti dhe kontrolli* - njerëzit duhet të ndiejnë se një pjesë e mjedisit u përket atyre, individualisht dhe kolektivisht - një pjesë për të cilën ata kujdesen dhe janë përgjegjës, pavarësisht nëse e zotërojnë atë apo jo.
- *Qasja në mundësi, imagjinatë dhe gëzim* - njerëzit duhet ta kenë qytetin si një vend ku ata mund të shkëputen nga format e zakonshme, të zgjasin përvojën e tyre, të takojnë njerëz të rinj, të mësojnë pikëpamje të tjera dhe të argëtohen.
- *Autenticiteti dhe kuptimi* - njerëzit duhet të jenë në gjendje të kuptojnë qytetin e tyre (ose qytetet e njerëzve të tjerë), paraqitjen e tij themelore, funksionet publike dhe institucionet; ata duhet të jenë të vetëdijshëm për mundësitë e tij.
- *Komuniteti dhe jeta publike* - qytetet duhet të inkurajojnë pjesëmarrjen e qytetarëve të tyre në komunitet dhe jetën publike.
- *Vetëbesimi urban* - gjithnjë e më shumë, qytetet do të duhet të bëhen më të vetë-qëndrueshme në përdorimin e tyre të energjisë dhe burimeve të tjera të pakta.
- *Një mjedis për të gjithë* - mjediset e mira duhet të jenë të arritshme për të gjithë. Çdo qytetar ka të drejtë për një nivel minimal të jetesës së mjedisit dhe nivele minimale të identitetit, kontrollit dhe mundësive (Jacobs & Appleyard 1987: 115–6).

Për të arritur këto qëllime, u identifikuan pesë parakushte të një mjedisi urban ‘të shëndoshë’:

- Rrugë dhe lagje të jetueshme.
- Disa dendësi minimale të zhvillimit të banimit, si dhe intensiteti i përdorimit të tokës.
- Një integrim i aktiviteteve - të jetuarit, punës, blerjeve - në një afërsi të arsyeshme me njëri-tjetrin.
- Një mjedis i bërë nga njeriu, veçanërisht ndërtesat, që përcaktonin hapësirën publike (në krahasim me ndërtesat e ulta në hapësirë).
- Shumë ndërtesa të ndara, të dallueshme me rregullime dhe marrëdhënie komplekse në krahasim me disa ndërtesa të mëdha) (Jacobs & Appleyard 1987: 117).

Ne 1989, lartëmadhëria e tij, princi Charles, krijoi një kornizë për dizajnin arkitektonik, që përmbante vendin; hierarkinë; shkallën; harmoninë; mbyllje; materiale; dekorim; arti; simbole dhe drita; si dhe komunitetin. Të ngulitura fort në traditën vizuale-artistike, idetë e Princit ndezën një debat të rëndësishëm. Si përgjigje, presidenti i atëhershëm i Institutit Mbretëror të Planifikimit të Qytetit dhe themeluesi I grupi të dizajnit urban me qendër në Mbretërinë e

Bashkuar, Francis Tibbalds (1988a, b, 1992), sugjeroi një kornizë më të sofistikuar (dizajni urban) që përmban 10 parime:

- Vendet kanë më shumë rëndësi
- Mësoni mësimet e së kaluarës
- Inkurajoni përzierjen e përdorimeve dhe aktiviteteve
- Projektimi në shkallë njerëzore
- Inkurajoni lirinë e këmbësorëve
- Siguroni akses për të gjithë
- Ndërtoni mjedise të lexueshme
- Ndërtoni mjedise të qëndrueshme
- Kontrolloni ndryshimin (gradualisht)
- Bashkojini të gjitha së bashku.

Nan Ellin përcaktoi një manifest të cilin ajo e quajti “Urbanizëm Integral“, botuar si ballina e librit të saj të vitit 2006 me të njëjtin emër. Urbanizmi integral demonstroi pesë cilësi:

hibriditeti, lidhshmëria, poroziteti, vërtetësia dhe cenueshmëria:

- Në vend se të izoloni objekte dhe funksione të ndara, hibriditeti dhe lidhja i bashkojnë aktivitetet dhe njerëzit së bashku, duke i trajtuar njerëzit dhe natyrën si simbiotike - si dhe ndërtesat dhe peisazhet - në vend që të jenë opozitare.
- Poroziteti ruan integritetin e asaj që bashkohet ndërsa lejon hyrjen reciproke përmes membranës së depërtueshme.
- Autenticiteti përfshin angazhimin aktiv dhe nxitjen e frymëzimit nga kushtet aktuale shoqërore dhe fizike me një etikë kujdesi, respekti dhe ndershmërie. Si të gjithë organizmat e shëndetshëm, qyteti autentik është gjithmonë duke u rritur dhe evoluuar sipas nevojave të reja që lindin falë një loje feedback-u vetërregullues që mat dhe monitoron suksesin dhe dështimin.’ (2006: xiv).
- Prekshmëria kërkon që ‘ne të heqim dorë nga kontrolli, të dëgjojmë thellë, të vlerësojmë procesin si dhe produktin dhe të ri-integrojmë hapësirën me kohën.’ (2006: xiv).

Gjatë viteve 1990 në Shtetet e Bashkuara, Kongresi për urbanizimin e ri zhvilloi dy sete idesh në lidhje me dizajnin urban:

- Lagjet neo-tradicionale' (NTDs) dhe zhvillimi i lagjeve tradicionale' (TNDs), ku ideja qendrore ishte të projektonim lagje të reja të plota që do të ishin të ngjashme me lagjet tradicionale (p.sh. Duany & Plater-Zyberk 1991).

Lidhur me metodologjinë e vlerësimit, Bryman (2004) shprehet se përcaktimi midis metodologjive sasiore dhe cilësore është arbitrar. Kjo do të thotë që metodat duhet të përdoren me kujdes dhe, kur mungojnë, të krijohen të reja në mënyrë që ato të jenë të përshtatshme për subjektin që do të analizohet. Në kontekstin e këtij studimi nënkupton se pavarësisht se modeli I vlerësimit që kemi krijuar ka marrë për bazë literature tepër të vlerësuar ndërkombëtare duke

trajtuar cdo temë me objektivitet, në fund ngelet një krijim subjektiv i autorit i cili do jetë në një testim të vazhdueshëm për të dëshmuar funksionalitetin e tij. Rezultatet e mësipërme mbi analizimin dhe grupimin e literatures mbi kriteret që duhet të plotësoj një hapësirë publike ideale, konkluduan në:

- 4 Kategori kryesore të ontologjisë së hapësirës publike
- Cilësi të njëjta ishin domosdoshmëri për kategori të ndryshme duke dëshmuar kështu lidhjen e ngushtë mes tyre

Duke u gjendur përballë këtyre rezultateve shtrohen dy pyetje kryesore:

1-A zënë të gjitha këto cilësi të njëjtën rëndësi në gjendjen e hapësirës publike?

2-Si do të bëhet vlerësimi I secilës në gjendjen e hapësirës publike?

Që në fillim të këtij studimi qëllimi ka qënë krijimi i një mjeti matës për funksionimin e hapësirës publike si një arene e kohezionit social në shoqëri. Analiza e thellë që në konceptimin e hapësirës publike e deri në komponentet më të imët të saj, I dhanë formë në mënyrë graduale modelit të vlerësimit deri në kristalizimin e formës së tij përfundimtare ku baza mbi të cilën ndërtohet është *thjeshtësia* dhe *funksionaliteti* por sfida qëndronte në mënyrën e ndërlidhjes së cilësive të secilës kategori të ontologjisë së hapësirës të tilla që të ishin të matshme në menyrë të thjesht dhe të shpejt.

Ky sfond teorik kompleks krijoi një qasje të re të metodave të përziera si sasiore dhe cilësore, dhe risia e tyre ishte- një metodë e cila i bashkon të gjithë elementët së bashku për të dhënë një produkt të sakt. Korniza metodologjike mund të ndahet në katër pika kryesore:

1-Krijimi I një indeksi matës për funksionimin e hapësirës publike si positive apo negative për tu ndarë më tej në socialisht aktive dhe soialisht pasive-Modeli i gjysmë rrethit.

2-Përcaktimi i indikatorëve kryesor dhe testimi i modelit matës.

3-Përcaktimi i rasteve studimore që të përmbaj paterne të ndryshme urbane për ta testuar modelin gjerësisht.

4-Aplikimi në terren dhe analizimi i rezultateve.

Autorë të shumtë kanë tentuar gjithashtu të krijojnë mjete matëse për fusha të ndryshme të sferës publike. Hemphill, Berry dhe McGreal's (2004) tentuan të matnin rigjenerimin urban të qëndrueshëm duke ndjekur një linjë studimi si definimi i koncepteve, percaktimi I temave kryesore, percaktimi i indikatorëve dhe në fund krijimi i indeksit matës.

Gjithashtu Georgiana M. (2011) në “Assessing the publicness of public places: towards a new model”, krijon modelin e yllit me të cilin mat pesë meta-temat e hapësirës publike për të përcaktuar masën në të cilën një hapësirë funksionon si publike.

Vikas Mehta (2014) në “Evaluating public space” ka krijuar një indeks vlerësimi empirik i cili bazohet mbi kritere si përfshirja, vlera e vendeve, siguria, komforti, kënaqësia, për ta aplikuar funksionalitetin e tij gjatë studimit në katër hapësira publike në Tampa, Florida.

Në konkluzion të hetimit të mësipërm, në rastin e këtij studimi e paraqitur në mënyrë të thjeshtëzuar, analiza e hapësirës publike ndjek linjën logjike si në skemën e mëposhtme:





Figure 20. Skema e studimit (Burimi: autori)

Sic mund ta vëmë re në skemën e mësipërme gjithë rrjedha e studimit na çon përballë dy kategorive: Hapësira positive dhe në anën e kundërt të medaljes, hapësira negative pra e thjeshtëzuar kjo, kemi “të mirën” kundërjet “të keqes”. Në këtë moment skema e gjysmë rrethit e ka zanafillën nga simboli Yin dhe Yang, i të mirës dhe të keqes i cili përfaqëson një koncept dualiteti, duke përshkruar sesi elemente të kundërt me njëri tjetrin mund të jenë të ndërlidhur, komplementar. Gjatë studimit prej vëzhgimit empirik të hapësirave publike u vu re se

ekzistonin shumë hapësira të cilat pavarësisht se kishin dominancë të elementeve positive, në vetvete nuk krijojnë kohezion social si dhe e kundërta e saj, pra hapësira të cilat kishin dominancë të elementeve negative për arsye të ndryshme tërhiqnin në mjediset e tyre një nivel të lartë kohezioni social. Më poshtë është paraqitur simboli Ying dhe Yang I përshtatur në skemën e vlerësimit të hapësirës publike. Skema përbëhet nga dy gjysmë rrethë të cilët përmbajnë cilësitë pozitive të hapësirës publike kundrejt cilësive negative të saj. Më tej këto ndarje kategorizohen në hapësira të cilat krijojnë ose jo kohezion social, pra socialisht aktive ose socialisht pasive.



Simboli Yin Yang I përkthyer në hapësirën publike




Figure 21. Skema e gjysmë-rrethit për vlerësimin e hapësirës publike (Burimi: autori)

#### **5.4 Kalibrimi i indikatorëve të metodologjisë së vlerësimit**

Gjithë skema e studimit ka në fokus një pyetje kryesore: *Si funksionon nje hapësirë si publike?* Në këtë mënyrë, gjatë analizimit të literaturës, synimi kryesor ka qënë të nxjerrim karakteristikat apo cilësitë bazë të cilat e bejnë të mundur funksionimin korrekt si një hapësirë publike. Nëpërmjet këtij hulumtimi, analizimi dhe sinteze arrijmë të krijojmë një standart të caktuar vlerësimi nëpërmjet të cilit, situata të ndryshme urbane mund të analizohen, vlerësohen dhe krahasohen për të konkluduar më pas me mangësitë që cojnë derjt mosfunksionimit të saj. Për shkak të dualitetit të natyrës së hapësirës publike si element statik dhe dinamik, studimi ka analizuar thellësisht konceptin, katëgoritë, cilësitë, përdoruesit dhe cdo aspekt tjetër të hapësirës publike, qoftë fizikisht I prekshem apo I perceptueshem nëpërmjet ndjesive personale. Pra, e thënë në mënyrë më të thjeshtë, faza e studimit ka tre qëllime kryesore:

1. Të konceptohet ontologjia e hapësirës publike
2. Nëpërmjet rezultateve do të krijohet një skemë vlerësimi
3. Aplikimi dhe testimi në praktikë I saj




Figure 22.Ontologjitë e hapësirës publike (Burimi: Autori)

Skema e mësipërme është e ndërtuar mbi bazën e gjithë rezultateve të studimit duke I ndërthurur në një mënyrë deduktive, mbi të dhënat cilësore dhe sasiore. Pra, e konvertuar kjo në mënyrë konkrete, skema e ka gjenezën me një nocion të përgjithshëm siç është hapësira publike, ku më pas zërthehet në gjithë komponentët më të hollësishëm të saj.

Pikënisja është hapësira publike, ku më pas sic e kemi përmendur edhe më sipër, ndahet në dy pjesë përbërëse, në elementët statikë dhe elementët dinamik. Respektivisht përbëhen nga: ndërtesat, mobilimi urban, infrastruktura dhe hapësira, përdoruesit. Në pjesën e studimit të literaturës kemi përmendur referenca nga autorë të ndryshëm, të cilët listonin cilësitë që sipas tyre duhet të përmbush një hapësirë publike për të funksionuar në mënyrë korrekte, ku ne thelb këto cilësi janë kritere që I përkasin elementeve static dhe dinamik të hapësirës publike. Më pas të gjitha cilësitë që mbartin të njëjtën domethënie janë grupuar së bashku duke rezultuar në katër kategori, të cilat përbëjnë atë që kemi quajtur “Ontologjia e hapësirës publike”

### **5.5 Vlerësimi I indekseve-Sistemi BOOLEAN**

Kalimi nga rrafshi teorik në nivelin praktik për të krijuar një mjet matës të cilësisë ishte sfida kryesore e këtij studimi. Fokusi kryesor gjatë evidentimit të cilësive që do të ishin baza e mjetit mates, lidhej me përmbushjen e këtyre kritereve të cilësive:

- Lehtësisht të kuptueshme nga kushdo
- Koherente me ndryshimet e hapësirës publike
- Lehtësisht të matshme

Por pasi kemi perfunduar të gjithë procesin e identifikimit, shpejgimit dhe përcaktimit të funksionit të secilës prej tyre në hapësirën publike është moment që të bëjmë kalibrimin e këtyre cilësive në funksionimin e mjetit matës. Kur kemi diskutuar për secilën cilësi në mënyrë të veçantë kemi vënë re që secila prej tyre shfaqet në shkallë dhe mënyra të ndryshme në hapësirë. Prsh. Nëse do ti referohemi cilësisë së aksesit do të kujtojmë se kishte tre forma të ndryshme të aksesit në hapësirë të cilat ishin: akses fizik, akses visual dhe akses simbolik. Në rastin e vlerësimit tone nuk do të ketë matje në shkallë të ndryshme të elementeve por vlerësimi do të bëhet në bazë të *sistemit Boolean*.

Boolean i referohet një sistemi të mendimit logjik që përdoret për të krijuar thënie të vërteta / false. Një vlerë Boolean shpreh një vlerë të së vërtetës (e cila mund të jetë e vërtetë ose e gabuar). Shprehjet Boolean përdorin operatorët AND, OR, XOR dhe NOT për të krahasuar vlerat dhe për të kthyer një rezultat në të vërtetë ose të rremë. Logjika Boolean u zhvillua nga George Boole, një matematikan dhe filozof Anglez, dhe është bërë baza e logjikës moderne




kompjuterike dixhitale. E pështatur kjo në metodologjinë e vlerësimit të hapësirës publike do të thotë se ekziston një cilësi positive në hapësirë ajo do të korrespondoj me një vlerë në gjysmë rrethin pozitiv domethene EKZISTON ose NUK EKZISTON, edhe nëse kjo cilësi është e shfaqur në vlerën negative të saj pra nëse do ti referohemi aksesit, edhe nëse kemi shfaqjen një barriere për funksionimin e një prej tre llojeve të aksesit në një mjedis kjo të do konsiderohet direkt një cilësi negative pavarësisht mënyrës apo raportit që shfaqet në mjedis dhe do ti korrespondoj një ndarje në gjysmë rrethin e cilësive negative në mjetin mates (fig.25).

Disa prej jush mund të mendojnë se përse secila cilësi është ndarë gjatë analizimit në shkallë të ndryshme të shfaqjes së saj në mjedisin publik kur mënyra e vlerësimit është pozitive apo negative. Në rastin tone kjo është bërë që lexuesi të arrij ti kuptoj deri ne imtësi këto cilësi dhe të gjitha situatat e mundshme sesi ato mund të shfaqen dhe të qendrojnë në raste praktike për të arritur kështu në një vlerësim sa më të sakt. Nëpërmjet metodës së gjysmë-rrethit mund të kuptohet me një vështrim të vetëm nëse në një hapësirë dominojnë elementet pozitiv ose negativ dhe nëse ajo është socialisht aktive apo socialisht pasive. Në këtë mënyrë mund të evidentohen cilësitë kryesore që ndikojnë në kohezionin social në mjedise publike dhe të merren për referencë në krijimin e hapësirave të reja si dhe evidentimi i cilësive negative do të ndihmonte në arritjen e ndërhyrjeve të sakta në mjedis për të përmirësuar sferën publike duke nxitur kohezionin midis përdoruesve.



Figure 23. Ilustrim mbi metodologjinë e funksionimit të sistemit BOOLEAN



**E gabuar OSE e vertete**

*Figure 24. Vlerësimi sipas modelit Boolean*

## **KAPITULLI 6: Aplikimi i modelit në praktikë**

### **6.1 Hyrje**

Në këtë kapitull paraqitet aplikimi në praktikë I modelit të vlerësimit të cilësisë së hapësirës publike. Pasi kemi krijuar një këndvështrim të përgjithshëm historik dhe kemi njohur disi në terma të përgjithshëm fizik situatën aktuale të rastit studimor, kapitulli vazhdon të prezantojë dhe shpjegojë vlerësimin për secilin indeks të modelit vlerësues, nën katër ontologjitë e hapësirës publike. Pas kësaj, nëpërmjet modelit të gjysmë rrethit analizojmë jo vetëm cilësinë e hapësirës por edhe funksionimin e saj si një arenë për socializimin aktiv midis përdoruesve. Kapitulli përfundon me analizimin e gjetjeve dhe diskutimin e konkluzioneve për të arritur në këtë mënyrë në thelbin e qëllimit të këtij studimi.

### **6.2 Rastet studimore**

Vlerësimi efikas I hapësirës publike mund të nis vetëm në fazën pasi është krijuar dhe konsoliduar modeli I gjysmë-rrethit dhe duke e pasur të qartë se çfarë metodash do të përdoren për grumbullimin e të dhënave të nevojshme për të bërë vlerësimin, ka ardhur momenti që të tesotojmë efikasitetin e metodologjisë në praktikë. Perzgjedhja e rasteve për tu studiuar ka në fokus dy elemente kryesor:

-Rastet studimore duhet të përzgjidhen tepër të larmishme, të përmbajnë situata të ndryshme urbane të hapësirës publike në mënyrë që efikasiteti I metodës së vlerësimit të testohet në të gjitha dimensionet.

-Gjatë rasteve studimore hapësirat do të vlerësohen nëpërmjet grumbullimit të të dhënave në mënyrë empirike duke vëzhguar drejtpërdrejtë hapësirat dhe përdoruesit.

-Vëzhgimi dhe grumbullimi të dhënave do të zhvillohet përgjatë harqeve të ndryshme kohore ditore dhe mujore si dhe nga persona të ndryshëm për ta rritur më tepër shkallën e saktësisë. Duke patur parasysh procesin e vrullshëm të urbanizimit dhe globalizimit vecanërisht vitet e fundit ku qendrat e qyteteve nuk ishin të planifikuara për këtë lloj zhvillimi dhe zonat periferike po zhvillohen në mënyrë ekstensive, hapësira publike gradualisht po e humbet funksionin e saj public për të nxitur kohezionin social në komunitet. Në shumicën e rasteve sot, më tepër se sa skena sociale e qytetit, hapësira publike konsiderohet thjeshtë si hapësira midis ndërtesave, ku komuniteti I përdor kryesisht për qarkullim. Për këtë arsye rastet e përzgjedhura për studim janë paterne tipike të prekura nga ky zhvillim. Në këto zona nuk janë zhvilluar më herët studime mbi hapësirën publike, kështu që mjete I vlerësimit përveçse do të testohet mbi funksionalitetin e vet, në rastin e një rezultati pozitiv do të mund të jepte të dhënat paraprake mbi mënyrën sesi

keto hapësira janë përshtatur me vrullin e zhvillimit të qytetit dhe konkretisht cilët janë elementët negative të prodhuara nga ky proces.

### 6.2.1 Unaza nr.3, Tirane

Sic e përmendem edhe më herët qëllimi i përzgjedhjes së rastit studimor lidhet me përfshirjen e tipologjive të larmishme të hapësirave publike. Unaza nr.3, Tiranë me një gjatësi rreth 7.3 km përfaqëson shembullin ideal referuar qëllimit të studimit si një hapësirë publike e cila ka pësuar ndryshime tepër të mëdha pas periudhës komuniste. Megjithatë fokusi i zhvillimit historik nuk është në qëllimin kryesor të vlerësimit të këtij studimi. E ndodhur në zemër të qytetit të Tiranës, duke krijuar marrëdhënie të drejtpërdrejta si me qendrën e qytetit ashtu edhe me pole të ndryshme kryesore të tij, unaza nr.3 ka ekzistuar si hapësirë publike që në periudhën totalitare ku me rënien e saj dhe ndryshimet drastike që solli demokracia, rimodeloi hapësirat e veta si dhe prodhoi edhe tipologji të reja. Një pjesë e konsiderueshme e hapësirave të ndodhura në këtë zonë ndajnë të njëjtat karakteristika të zhvillimit të tyre, të njëjtat funksione si shërbime apo vende për të shpenzuar kohën e lirë si dhe të njëjtin konfigurim fizik. Gjithashtu në këtë zonë të marrë në studim nuk janë kryer më parë testime për cilësinë e hapësirës publike, për më tepër është konsideruar një arterie kryesore vetëm për qarkullimin e automjeteve, duke neglizhuar dimensionin publik dhe impaktin që jep në cilësinë e përgjithshme të sferës publike në qytet.




Figure 25. Morfologjia urbane e zones studimore

### 6.3 Metoda e studimit

Përsa i përket numrit të hapësirave publike që do të merren në studim brenda unazës, është një shifër e cila do të rezultoj në bazë të ndarjes së gjithë zonës në mini-hapësira të cilat duhet të kenë:

- Konfigurim të ngjashëm hapësinor
- Funksion të ngjashëm
- Mobilim të ngjashëm
- Madhësi të përafërt




Figure 26. Shembull I skedës informative për cdo mini-hapësirë (Burimi: autori)

Gjithë hapësira e unazës nr.3 do të nënshtrohet këtyre kriterëve seleksionuese për të ndarë hapësirat në tipologji të ngjashme pasi në të kundert do të ishte e pamundur të zhvillohej procesi i vlerësimit. Kjo do të jetë faza e parë me të cilën do të nisi procesi i vlerësimit. Pasi të jetë ndarë në mini-zona, për secilën prej tyre do të ndërtohet një skedë informuese e cila do të jetë një “pasaportë” për zonën ku do të përmbaj informacione për të si: Vendodhja në hartë në raport me qytetin dhe konfigurimin e saj në plan, të dhëna fizike si sipërfaqja, tabelën e cilësive e cila më pas do të aplikohet në modelin e gjysmë rrethit për të arritur në vlerësimin e cilësisë së saj si një hapësirë publike. Për të gjitha rezultatet e nxjerra nga ky vlerësim do të ndërtohen database të posaçme nëpërmjet të cilëve mund të nxjerrim në fund konkluzione të rëndësishme në lidhje me kritere positive apo negative të cilat kanë spikatur gjatë studimit.

Përveç, vëzhgimit të drejtpërdrejtë të hapësirës për grumbullimin e të dhënave, gjithashtu janë përdorur edhe dokumente nga burime të besueshme siç janë materplane, plane me strategji ndërhyrje apo harta kadastrale e qytetit të cilat na ndihmojnë për të nxjerr të dhënat fizike të nevojshme. Përsa i përket intervistave të strukturuar për përdoruesit e hapësirës, nuk janë realizuar pasi studimi përqëndrohet kryesisht në gjendjen fizike të mjedisit por është vlerësuar prania dhe gjuha e trupit të përdoruesve gjatë prezencës së tyre të vetëm ose në grupe në këto hapësira. (grumbullimi i të dhënave nuk parashikon intervista me njerëz) Pra një metodologji e cila mund të përdoret nga studiues dhe projektues profesionistë në mënyrë individuale.

Në modelin e gjysmë-rrethit, çdo ndarje e tij grafike i korrespondon një cilësi e hapësirës publike ku vlerat, sic e përmendëm më sipër sipas sitemit Boolean, variojnë midis dy vlerave 0 dhe 1 pra mungesë ose prani të një cilësie specifike. Modeli grafik i krijuar na ndihmon ta perceptojmë direkt, vizualisht gjendjen e një hapësire të marrë në studim. Në këtë model studimi cilësitë janë konsideruar me të njëjtën vlerë në grafik por sic e kemi analizuar më herët në piramidën “Maslow” të cilësive të hapësirës publike, jo të gjitha cilësitë kanë të njëjtën vlerë dhe ndikim në kualitetin e përgjithshëm, gjë të cilën do ta vërtetojmë edhe më vonë gjatë studimit kundrejt rezultateve që do të pasojnë këtë konstatim. Gjithsesi ky zbulimin tepër kompleks qëndron në limitet e analizës sonë dhe do të ishte zanafillë për një studim edhe më të madh që mund të pasojë prandaj në këtë fazë të studimit tonë shkencor, cilësitë do të trajtohen me vlerë të njëjtë në grafikun e analizës.

*Pra praktikisht thelbi i metodologjisë së krijuar për vlerësimin e hapësirës publike kundrejt funksionimit të saj si arenë për krijimin e ndërveprimit social në komunitet është që të jetë një*

*mjet praktik vlerësimi, i mundur që të përdoret nga kushdo dhe jo vetëm nga profesionistë, duke përdorur vëzhgimin e strukturuar të drejtpërdrejtë të hapësirave.*

#### **6.4 Grumbullimi dhe analizimi i dokumentacioneve të ndryshme**

Gjatë studimit, përveç vëzhgimit të drejtpërdrejt të zonës, ishte i domosdoshëm gjithashtu analizimi i disa dokumentave zyrtare për të nxjerr të dhëna të nevojshme për zonën. Përveç të dhënave fizike si sipërfaqja apo konfigurimi në plan i zonave të ndryshme gjithashtu mund të arrijmë të kuptojmë sesi ka ndryshuar në kohë hapësira e marrë në studim për të konkluduar kështu në faktor të rëndësishëm që ndikojnë zhvillimin e saj. Gjithashtu janë marrë dokumenta nga bashkia e qytetit për masterplane ose plane të detajuara vendore të cilat janë zbatuar më herët ose janë në plan për tu implementuar në të ardhmen në zhvillimin e zonës që kemi marr në studim. Duhet pasur parasysh që çdo dokument analizohet në këndvështrimin e dobisë që mund ti sjell qëllimit të studimit së kësaj teze për hapësirën publike, pa e zgjeruar atë në fusha të cilat jo vetëm nuk kanë interes për këtë tezë por do të mund të na conin në rezultate të gabuara.

Gjatë kërkimit për informacione mbi zonën, nuk rezulton të jenë kryer më herët studime mbi hapësirën publike. Në vitin 2017, e kam aplikuar modelin e analizës së gjysmë rrethit në një formë më të thjeshtë në këtë zonë. Tashmë, 3 vite më pas modeli i gjysmë rrethit ka evoluar, duke u detajuar në një mënyrë tepër të thelluar dhe kjo gjë do të na shërbej që përveç përcaktimit të analizës së cilësisë së hapësirës në zona, gjithashtu mund të bëjmë edhe një balancë mbi ndryshimin që ka pësuar në kohë zona.

Gjithashtu një tjetër burim informacioni kanë qenë faqet e web-it online. Përveç informacioneve që mund të gjenim si foto të zonës apo informacione të gjendjes fizike gjithashtu na ka shërbyer për të gjetur raste të ndryshme në botë ku situatat urbane mund të kenë qenë të ngjashme dhe të shohim se çfarë ndërhyrje janë kryer për të përmirësuar cilësinë e tyre.

Sic e kemi përmendur edhe më lart, intervistat e drejtpërdrejta në terren nuk janë pjesë e analizës së kësaj teze, por është vëzhguar imtësisht gjuha e trupit të përdoruesve pra mënyra sesi ata ndërvepronin me hapësirën ndryshe nga studime të tjera të cilat janë bazuar mbi zhvillimin e pyetsorëve të ndryshëm por pothuajse asnjë prej tyre nuk ka synuar një metodë vlerësimi të bazuar mbi vëzhgimin individual, të stukturuar me kritere të mirëpërcaktuara paraprakisht.




Figure 27. Evolucionit historik i zonës së Unazës nr.3



## **6.5 Aplikimi i modelit të vlerësimit në praktikë**

Modeli i vlerësimit të gjysmë rrethit, sic edhe e kemi përmendur më herët është i bazuar mbi vëzhgimin e drejtpërdrejt të strukturuar në sajë të indikatorëve të ontologjisë së hapësirës. Si duhet ta kuptojmë këtë? Fillimisht duket të kuptojmë qartë se çfarë përfshinë procesi i vlerësimit. Referuar fjalorit është një përcaktim sistematik i meritës, vlerës dhe domethënies së një subjekti, duke përdorur kritere të bazuara mbi një sërë standardesh. Duke pasur parasysh këtë përcaktim dhe diskutimin më sipër se hapësira publike është shumë dinamike dhe e ndryshueshme në të gjithë konfigurimin e saj, nëse do ta vlerësonim të gjithë hapësirën e marrë në studim si një element të vetëm modeli i vlerësimit do ta humbte shkallën e saktësisë pasi rezultati do të shfaqte të gjithë indikatorët e marrë në vlerësim. Për këtë arsye hapësirat janë ndarë në njësi më të vogla mbi bazën e kritereve të ngjashme që shfaqin secila prej tyre.

### 1-Ndarja e zonave

Ndarja e kufijve të zonave është bërë mbi bazën e karakteristikave të përbashkëta fizike sic janë:

- Fasada të ngjashme që konfigurojnë hapësirën
- Mobilim i ngjashëm urban
- Funksione të ngjashme
- Fluksi i lëvizjeve të këmbësoreve
- Shërbime të ngjashme

### 2-Përcaktimi i madhësisë optimale të njësive të studimit

Është e rëndësishme që për të kuptuar më qartë mënyrën sesi është e ndërtuar dhe funksionon zona, duhet të pozicionohemi në pika strategjike për ta vëzhguar. Kryesisht fluksi i lëvizjeve ishte ndër elementet kryesor që përcaktonin madhësinë e ndarjes për njësitë e studimit. Mesatarisht njësitet kishin një gjatësi 100m-250m.

### 3-Vëzhgimi i strukturuar

Hapi I tretë konsiston në vëzhgimin e drejtpërdrejtë të zones por ky proces duhet zhvilluar mbi bazën e indikatorëve të cilësisë së hapësirës publike për të mbledhur të dhëna të vlefshme për vlerësimin.

Gjatë mbledhjes së evidencave nëpërmjet vëzhgimit të drejtpërdrejt të zonës, procesi është strukturuar në dy pjesë:

-Vëzhgimi i elementëve fizik të pandryshueshëm të zonave, sic janë mobilimi urban, fasadat e objekteve etj.

-Vëzhgimi i elementëve të ndryshueshëm në zonë, sic janë përdoruesit, gjuha e trupit e shfaqur gjatë qëndrimit në këto hapësira, shërbimet në zonë etj.

#### 4-Koha e vëzhgimit

Zonat e përzgjedhura për aplikimin në praktikë të metodologjisë janë vëzhguar në harqe të ndryshme kohore mbi bazën e treguesve të cilësisë së hapësirës publike që përmban modeli vlerësimi.

Procesi i qëndrimit në zona për të vlerësuar gjithë karakteristikat fizike të tij sipas indikatorëve të modelit të vlerësimi është zhvilluar përgjatë haqeve të ndryshme kohore të ditës, për shkak se disa kushte specifike të hapësirës prsh, fluksi i lëvizjeve këmbësore është i varur në mënyrë të drejtpërdrejt nga intervalet kohore ditore. Gjithashtu vëzhgimi nuk është realizuar vetëm për një ditë por për ditë të ndryshme, duke e rritur kështu shkallën e saktësisë së gjithë provave të mbledhura nëpërmjet këtij procesi.

#### 5-Përcaktimi i socializimit aktiv ose pasiv

Për qëllimin e këtij studimi, në hapësirat publike të vëzhguara u përcaktua së hapësirat socialisht aktive do të bazoheshin mbi praninë e një numri njerëzish të angazhuar në një shumëllojshmëri aktivitete të zgjatura në kohe dhe të qëndrueshme, veçanërisht ato aktivitete që kanë natyrë sociale. Duke përdorur të dhënat e mbledhura nga vëzhgimet e drejtpërdrejta në terren, u përcaktua një metodologji mbi të cilën do të mund të përcaktonim llojin e socializimit në hapësira duke pasur parasysh tre kritere kryesore:

-Llojin e aktivitetit social

-Kohëzgjatja e aktivitetit social

-Numri i personave të përfshirë

#### 6-Saktësia e vëzhgimit empirik

Për të arritur një shkallë më të lartë të saktësisë dhe besueshmërisë së vlerësimi nëpërmjet vëzhgimit të strukturuar por gjithashtu edhe për të testuar funksionalitetin e kësaj metode, përveç autorit, grumbullimi i të dhënave empirike u krye edhe nga një studiues tjetër i planifikimit urban. Vlerësimi u krye në mënyrë të pavarur nga autori dhe në harqe të ndryshme kohore. Ky proces u krye për të gjitha hapësirat në studim dhe konkluzionet më pas u krahasuan midis tyre për të parë shkallën e mospërputhjes. Rezultatja e krahasimit konsistonte në një

mospërputhje midis vlerës 4-5% dhe kryesisht lidhej me vlerësimin e elementeve estetikë të dizajnit urban.

## 6.6 Tipologjitë urbane në zonë

Grumbullimi dhe analizimi i të dhënave është bërë në tipologji të ndryshme urbane në qytetin e Tiranës, rreth 115 hapësira publike (të paraqitura në shojce). Për efekt studimi këtu do të trajtohen tre tipologjitë kryesore do të trajtohen me imtësi, të cilat janë: rrugë, sheshe dhe bulevard. Në këto zona do të paraqitet në mënyrë të hollësishme procesi i vlerësimit për të kuptuar mënyrën në të cilën zhvillohet.



Figure 28. Lidhja e tre tipologjive urbane me qendrën e qytetit.

### 1-Bulevardi “Bajram Curri”, “Gjergj Fishta”

Janë dy bulevardet më të mëdha në Tiranë. Të dy, janë të shtrirë në mënyrë paralele me njëri tjetrin, duke ruajtur një drejtim perëndim-lindje, të pozicionuar në jug të sheshit “Skenderbej” dhe ndahen midis tyre me lumin “Lana”. Siç është përmendur edhe më sipër pjesë e studimit

janë të gjitha hapësirat e bulevardit që përfshihen në unazën nr.3 dhe në vijim do të aplikojmë modelin e gjysmë rrethit në praktikë në një sekuncë hapësinore të dy bulevardëve.

Nga imazhet e mëposhtëme është e qartë vizualisht se, zona konfigurohet më së shumti nga objekte 5-6 kate të larta, të ndërtuara rreth viteve 1950, me funksion banim dhe katet përdhe shërbim. Shërbimet në zonë përbëhen kryesisht nga bare/lokale dhe dyqane, ku i vetmi shërbim I ndryshëm nga kjo tipologji është kinema “Agimi”. Nëse do ti referohemi gëendjes së hapësirës publike, zona është relativisht e gjelbëruar, por mungojnë ndërhyrjet e planifikuara për përmirësimin e cilësisë së saj. Duke qenë se kufizohet me një nga arteriet kryesore të qarkullimit automobilistik në qytet, prania e automjeteve dominon hapësirën nëpërmjet trafikut dhe parkimit. Sipërfaqja e hapësirës publike është afërsisht 5200m<sup>2</sup>.



Figure 29. Pamja në plan e zonës së studiuar




Figure 30. Imazhe të gjendjes aktuale në bulevard

### 1-Hapi I-Ndarja në zona të ngjashme

Siç e kemi diskutuar edhe më sipër ndarja e hapësirave në mini zona për efekt studimi bazohet mbi disa kritere ndarës:

#### a) Fasada të ngjashme që konfigurojnë hapësirën




Figure 31. Foto të gjendjes aktuale në bulevardin "Bajram Curri"

Bazuar mbi këtë kriter, zona nuk mund të ndahet në hapësira më të vogla të ngjashme pasi ndërtesat që e kufizojnë janë shumë të ngjashme midis tyre, si nga ana estetike ashtu edhe nga ajo funksionale.

*b) Mobilim i ngjashëm urban*

Gjithashtu, edhe mbi këtë kriter nuk është e mundur ndarja e zonës në mini hapësira pasi mobilimi urban është thujtë i njëjtë kudo dhe karakterizohet nga: trotuar të ngushtë dhe të keqmbajtur si dhe të shtruar me të njëjtin patern, mungesa e vendeve për tu ulur dhe elementeve të dizajnit urban, ndriçim relativisht i plotë, gjelbërim relativisht i plotë dhe prania e koshave për grumbullimin e mbetjeve urbane si pjesë e dizajnit urban.

*c) Funksione të ngjashme*

Diskutimi mbi ngjashmërinë e hapësirave, vlen edhe për pjesën e funksioneve në zonë pasi objektet janë të gjitha të ndara në katin përdhe shërbime dhe pjesa tjetër banim.

*d) Fluksi i lëvizjes këmbësore*

Përpos fluksit të lartë të lëvizjes këmbësore që është i lidhur me përdorimin e shërbimeve, duke qënë se ka një pozicion dhe funksion strategjik në qytet, përdoret gjithashtu si një hapësirë tranzitore për këmbësorët. Në rastin e studimit tonë janë vëzhguar në harqe kohore të zgjatura, levizjet e këmbësoreve për të parë arsyen që i sillte në zonë. Kjo ka qene pika kryesore mbi të cilën është bazuar ndarja në skeda për këtë hapësirë.

*e) Shërbime të ngjashme*

Shërbimet lidhen në mënyrë të drejtpërdrejtë me fluksin e lëvizjes këmbësore pasi në më tëshumtën e rasteve ishin pikërisht shërbimet që sillnin publikun në zonë. Shërbimet e ngjashme të cilat ishin një kombinim midis lokaleve dhe dyqaneve si dhe fluksi i lëvizjes këmbësore ishin dy kriteret mbi të cilat u krye ndarja ne mini-hapesira.

Pasi e kemi analizuar zonën mbi bazën e kritereve ndarëse, tashmë mund të bëjmë një ndarje rigoroze dhe optimale në nën njësi të ngjashme për të ndërtuar skedat informuese të zonës dhe aplikimin e modelit të gjysmë rrethit. Sipas hapave të mësipërm, hapësira u nda në katër mini zona.



Figure 32. Ndarja e hapësirës në nën njësi të ngjashme studimore

## 2- Hapi II-Përcaktimi i madhësisë optimale të njësive studimore

Një tjetër kriter i rëndësishëm i vlerësimit është që zonat duhet të kenë një madhësi relativisht të vogël dhe të përafërt me njëra tjetren sepse në një shkallë të madhe do të ishte thuajse e pamundur të bëhej vlerësimi pasi hapësira do të shfaqte të gjitha llojet e cilësive, qofshin ato positive apo negative. Në këtë rast, nën zonat kishin përafërsisht madhësi:

- I. Hapësira 1 - 835 m<sup>2</sup>
- II. Hapësira 2 - 960m<sup>2</sup>
- III. Hapësira 3 – 1061m<sup>2</sup>
- IV. Hapësira 4 – 1187m<sup>2</sup>
- V. Hapësira 5 – 1098m<sup>2</sup>

### 3-Hapi III-Vëzhgimi i strukturuar

Në këtë zonë dhe në gjithë zonat e tjera të marra në studim janë vëzhguar në mënyrë të veçantë, elementet fizik të pandyshueshëm të zonës, të cilët do të vlerësohen sipas katër ontologjive të hapësirës publike, me cilësitë që përmban secila prej tyre dhe elementet dinamik sic janë përdoruesit. Në hapësirën në fjalë elementet fizik ishin në një gjendje të keqmbajtur ku mbizotëronin fasadat e keqmbajtura që kufizojnë hapësirën dhe mungesa e mobilimit urban.

### 4-Hapi IV-Koha e vëzhgimit

Duke qene se zona ka një fluks shumë të lartë këmbësorësh, hapësira u vëzhgua në harqe të ndryshme kohore ditore dhe mujore për të kuptuar se cila ishte arsyeja që lidhej me praninë e këmbësorëve. Në zonë prezenca e tyre lidhej me dy shkaqe kryesore: 1) përdorimi i shërbimeve në zone dhe 2) përdorimi i hapësirave për qarkullim të fluksit këmbësor.

Në këtë moment, pasi kemi grumbulluar të gjitha informacionet e mësipërme, mund të procedojmë me ndërtimin e skedave për secilën zonë.

#### 1) Hapësira 1

Gjatë vëzhgimit në zonë të dhënat janë shënuar në tabla të përgatitura paraprakisht, të cilat përmbajnë të gjitha indekset e metodologjisë në vlerësimin. Më pas këto të dhëna janë përdorur për të ndërtuar modelin e gjysmë rrethit vlerësues.

Cilësitë pozitive											
E pastër dhe e rregullt	Aksesibiliteti i	Tërheqëse	E rehatshme	Ftuese	Vitale	Funksionale	Të ketë karakter dallues	E sigurtë	E qëndrueshme fizikisht ndaj përdorimit të përditshëm	E gjelbërt	Të ketë sensin e përkatësisë
/	X	/	/	/	X	/	X	X	/	X	/

Table 5. Cilësitë pozitive në hapësirën 1

Cilësitë negative															
E ndotur	Grumbullime	Graffiti	Trafik i	Ndërtesa të keqmbajtura që kufizojnë hapësirën	E pasigurt	Të pastrehë	Kontribut	Parkime	E plogët	Boshe	Frike nga krimi	Mungesa e ndjesisë së vendit	Akses jo i mirë	Hapësira ndërmetese	Mungesa funksioni
/	/	/	X	/	/	X	/	X	/	/	/	/	/	X	/

Table 6. Cilësitë negative në hapësirën 1

	Lloji I socializimit	
	Socialisht aktive	Socialisht pasive
Hapësira 1		X

Table 7. Lloji I socializimit në hapësirën 1






Figure 33. Skeda vlerësuese e hapësirës 1, bulevardi “Bajram Curri”

I) *Hapësira 2*

Cilësitë pozitive											
E pastër dhe e rregullt	Aksesibiliteti	Tërheqëse	E rehatshme	Ftuese	Vitale	Funksionale	Të ketë karakter dallues	E sigurtë	E qëndrueshme fizikisht ndaj përdorimit të përditshëm	E gjelbërt	Të ketë sensin e përkatësisë
/	X	/	/	/	/	X	/	/	/	/	/

Table 8. Cilësitë pozitive në hapësirën 2

Cilësitë negative															
E ndotur	Grumbullime	Graffiti	Trafik i	Ndërtesa të këmbajtura që kufizojnë hapësirën	E posigurt	Të pastrehë	Kontribut	Parkime	E plogët	Boshe	Fritë nga kriminali	Mungesa e ndjesisë së vendit	Aksesja e mirë	Hapësira ndërmjetese	Mungesa e funksionit
X	X	X	X	X	X	/	X	X	X	/	X	/	/	X	/

Table 9. Cilësitë negative në hapësirën 2

	Lloji I socializimit	
	Socialisht aktive	Socialisht pasive
Hapësira 2		X

Table 10. Lloji I socializimit në hapësirën 2




Figure 34. Skeda vlerësuese e hapësirës 2, bulevardi “Gjergj Fishta”

II) Hapësira 3

Cilësitë pozitive											
E pastër dhe e rregullt	Aksesibiliteti	Tërheqëse	E rehatshme	Ftuese	Vitale	Funksionale	Të ketë karakter dallues	E sigurtë	E qëndrueshme fizikisht ndaj përdorimit të përditshëm	E gjelbërt	Të ketë sensin e përkatësisë
/	X	/	/	/	/	X	/	/	/	/	/

Table 11. Cilësitë pozitive në hapësirën 3

Cilësitë negative															
Endërlur	Grumbullime	Graffiti	Trafik	Ndërtesa të keqmbajtura që kufizojnë hapësirën	E pasigurt	Të pastrehë	Kontribut	Parkime	E plogët	Boshe	Frikë nga krimi	Mungesa e ndjesisë së vendit	Akses jo i mirë	Hapësira ndërmjetese	Mungesa funksioni
X	X	X	X	X	X	/	X	X	X	/	X	/	/	/	/

Table 12. Cilësitë negative në hapësirën 3

	Lloji I socializimit	
	Socialisht aktive	Socialisht pasive
Hapësira 3		X

Table 13. Lloji I socializimit në hapësirën 3




Figure 35. Skeda vlerësuese e hapësirës 3, bulevardi “Gjergj Fishta”

III) Hapësira 4

Cilësitë pozitive											
E pastër dhe e rregullt	Aksesibiliteti	Tërheqëse	E rehatshme	Ftuese	Vitale	Funksionale	Të ketë karakter dallues	E sigurtë	E qëndrueshme fizikisht ndaj përdorimit të përditshëm	E gjelbërt	Të ketë sensin e përkatësisë
/	X	/	/	/	/	X	/	/	/	/	/

Table 14. Cilësitë pozitive në hapësirën 4

Cilësitë negative															
Endotur	Grumbullime	Grafiri	Trafik i	Ndërtesa të keqmbajtura që kufizojnë hapësirën	E pasigurt/ Të pastrehtë	Kontribut	Parkingje	E plogët	Boshe	Frikë nga krimi	Mungesa e ndjesisë të vendit	Akses jo i mirë	Hapësira ndërmetëse	Mungesa funksioni	
X	X	X	X	X	X	/	X	X	X	/	X	/	/	/	/

Table 15. Cilësitë negative në hapësirën 4

	Lloji I socializimit	
	Socialisht aktive	Socialisht pasive
Hapësira 4		X

Table 16. Lloji I socializimit në hapësirën 4




Figure 36. Skeda vlerësuese e hapësirës 4, bulevardi "Gjergj Fishta"

IV) Hapësira 5

Cilësitë pozitive											
E pastër dhe e rregullt	Aksesibiliteti	Tërheqëse	E rehatshme	Ftuese	Vitale	Funksionale	Të ketë karakter dallues	E sigurtë	E qëndrueshme fizikisht ndaj përdorimit të përditshëm	E gjelbërt	Të ketë sensin e përkatësisë
/	X	/	/	/	/	X	/	/	/	/	/

Table 17. Cilësitë pozitive në hapësirën 5

Cilësitë negative														
E ndotur	Grupullime	Grafiti	Trafiku	Ndërtesa të keqmbajtura që kufizojnë hapësirën	E pasigurtta pastrehe	Kontribut	Parkime	Llogjet	Boshie	Frikë nga krimi	Mungesa e ndjesisë së vendit	Akses jo i mirë	Hapësira ndërmjetëse	Mungesa funksioni
X	X	X	X	X	X	/	X	X	X	/	X	/	/	/

Table 18. Cilësitë negative në hapësirën 5

	Lloji I socializimit	
	Socialisht aktive	Socialisht pasive
Hapësira 5		X

Table 19. Lloji I socializimit në hapësirën 5






Figure 37. Skeda vlerësuese e hapësirës 5, bulevardi "Gjergj Fishta"

## **6-Hapi VI - Përcaktimi i socializimit aktiv ose pasiv**

Më sipër kemi shpjeguar në mënyrë të imtësishme se çfarë përcakton socializmi aktiv dhe socializimi pasiv. Në këtë fazë vëzhgimi, hapi i parë është të përcaktohet nëse hapësira e marre në studim ka apo jo një fluks të lartë këmbësorësh dhe më pas analizohen motivet që i sjellin në zonë. Për ta kuptuar më qartë i diskutojmë të gjitha kriteret në mënyrë të veçantë.

### *1-Lloji I aktivitetit social*

Nga vëzhgimi periodik i zonës, gjatë harqeve të ndryshme kohore, u vu re se hapësira kishte një fluks të lartë këmbësorësh, sidomos gjatë paradites dhe pasdites. Por kryesisht dy ishin motivet që sillnin praninë e njerëzve në zonë: 1) duke qene se hapësira është një arterie kryesore rrugore që kap pikat kryesore dhe më të rëndësishme të qytetit, njerëzit e përdornin për të arritur nëdestinacionet e dëshiruara, pra vetëm lëvizje, pa ndalesa për të shpenzuar kohë në këto hapësira.

2) Shërbimet në zonë dhe këtu përmendim kryesisht baret/lokalet ishin një shkak i fortë i pranisë së këmbësorëve në zonë por duke qene se këto janë hapësira private dhe për të cilat duhet të paguash për ti përdorur, kjo nuk klasifikohet si një sjellje sociale në zonë.

### *2) Kohëzgjatja e aktivitetit social*

Siç e diskutuam zona është socialisht pasive që do të thotë se kohezioni social në zonë nuk ekziston dhe kohëzgjatja e qëndrimit të përdoruesve në zonë është për pak minuta, pra afërsisht 5-10 minuta.

### *3) Numri i personave të përfshirë*

Në varësi të llojit të socializimit që ka zona, I cili është pasiv, numri I personave të përfshirë është zakonisht 1-3 persona dhe shumë rrallë në grupe më të mëdha.

## **7-Hapi VII-Saktësia e vlerësimit empirik**

Për të arritur në konkluzionet e mësipërme, me shkallë të lartë saktësie, zona u vëzhguar gjatë ditëve të javës, paradite, gjatë drekës dhe darkës, për të parë ndryshimet në fluksin e këmbësorëve. Vëzhgimi gjithashtu u zhvillua edhe gjatë fundjavës. I gjithë procesi u përsërit në muaj të ndryshëm, përgjatë stinës së dimrit dhe verës. Për të patur një vlerësim objektiv të cilësive të hapësirës publike i gjithë procesi u krye edhe nga një profesionist tjetër. Në fund rezultatet u grumbulluan dhe u ballafaquan midis tyre. Shkalla e mospërputhjes ishte shumë e ulët 5-7%.

## 2-Sheshi “Çajupi”

Sheshi “Çajupi” kufizohet në pjesën veriore të tij me bulevardin “Bajram Curri”, të pozicionuar në jug të sheshit “Skënderbej” dhe ndahen midis tyre me lumin “Lana”. Siç është përmendur edhe më sipër pjesë e studimit janë të gjitha hapësirat e bulevardit që përfshihen në unazën nr.3 dhe në vijim do ta aplikojmë modelin e gjysmë rrethit në praktikë në një sekuncë hapësinore të dy bulevardeve.

Siç shihet edhe në imazhet e mëposhtme, zona konfigurohet më së shumti nga objekte 5-6 kate të larta, të ndërtuara rreth viteve 1950, me funksion banim dhe katet përdhe shërbim. Shërbimet në zonë përbehen kryesisht nga bare/lokale dhe dyqane. Nëse do ti referohemi gjendjes së hapësirës publike, zona është e gjelbëruar dhe janë bërë disa ndërhyrje urbane për ta përmirësuar cilësinë e saj. Duke qene se kufizohet me një nga arteriet kryesore të qarkullimit automobilistik në qytet, prania e automjeteve dominon hapësirën nëpërmjet trafikut dhe parkimit. Sipërfaqja e hapësirës publike është afërsisht 3500m<sup>2</sup>.




Figure 38. Pamja në plan e sheshit «Çajupi »



Figure 39. Imazhe të gjendjes aktuale në sheshin “Cajupi”

### 1-Hapi I-Ndarja në zona

Siç e kemi diskutuar edhe më sipër ndarja e hapësirave në mini zona për efekt studimi bazohet mbi disa kriteret ndarëse:

f) Fasada të ngjashme që konfigurojnë hapësirën



Figure 40. Imazhe të gjendjes aktuale në sheshin “Cajupi”

Bazuar mbi këtë kriter, zona nuk mund të ndahet në hapësira më të vogla të ngjashme pasi ndërtesat që e kufizojnë janë shumë të ngjashme midis tyre, si nga ana estetike ashtu edhe nga ajo funksionale. Katet përdhe janë të pershtatura për shërbim dhe katet e sipërme për banim.

*g) Mobilim I ngjashëm urban*

Gjithashtu, edhe mbi këtë kriter nuk është e mundur ndarja e zonës në mini hapësira pasi mobilimi urban është thujse i njëjtë kudo dhe karakterizohet nga: trotuare të gjera, të mirëmbajtura si dhe të shtruar me të njëjtin patern, të kufizuar me lulishte dhe gjelbërim. Vihet re një element tepër pozitiv i mobilimit urban që janë vendet për tu ulur por që nga ana tjetër krijohet një kontrast negativ me hapësirën që zaptohet prej parkimeve.

*h) Funksione të ngjashme*

Diskutimi mbi ngjashmërinë e hapësirave, vlen edhe për pjesën e funksioneve në zonë pasi objektet janë të gjitha të ndara në katin përdhe shërbime dhe pjesa tjetër banim.

*i) Fluksi I lëvizjes këmbësore*

Përpos fluksit të lartë të lëvizjes këmbësore që është i lidhur me përdorimin e shërbimeve, duke qene se ka një pozicion dhe funksion strategjik në qytet, si dhe një lulishte relativisht të mirëmbajtur përdoret gjithashtu si një hapësirë për të kaluar kohën e lirë nga përdoruesit. Në rastin e studimit tonë janë vëzhguar në harqe kohore të zgjatura, lëvizjet e këmbësorëve për të parë llojin e sjelljeve sociale në zonë. Kjo ka qene pika kryesore mbi të cilën është bazuar ndarja në skeda për këtë hapësirë.

*j) Shërbime të ngjashme*

Shërbimet lidhen në mënyrë të drejtpërdrejte me fluksin e lëvizjes këmbësore pasi në më të shumtën e rasteve ishin pikërisht shërbimet që sillnin publikun në zonë. Shërbimet e ngjashme të cilat ishin një kombinim midis lokaleve dhe dyqaneve si dhe fluksi i lëvizjes këmbësore ishin dy kriteret mbi të cilat u krye ndarja në mini-hapësira.

Pasi e kemi analizuar zonën mbi bazën e kritereve ndarëse, tashmë mund të bëjmë një ndarje rigoroze dhe optimale në nën njësi të ngjashme për të ndërtuar skedat informuese të zonës dhe aplikimin e modelit të gjysmë rrethit. Sipas hapave të mësipërm, hapësira për shkak të ngjashmërisë dhe konfigurimit do të konsiderohet si një zonë e vetme.



*Figure 41. Ndarja e sheshit « Cajupi » në nën njësi të ngjashme studimore*

## **2- Hapi II-Përcaktimi i madhësisë optimale të njësive studimore**

Një tjetër kriter i rëndësishëm i vlerësimit është që zonat duhet të kenë një madhësi relativisht të vogël dhe të përafert me njëra tjetrën sepse në një shkallë të madhe do të ishte thuajse e pamundur të bëhej vlerësimi pasi hapësira do të shfaqte të gjitha llojet e cilësive, qofshin ato positive apo negative. Në këtë rast, që e gjithë zona është një nënnjësi e vetme sipërfaqja e saj është:

I-Hapësira 1 – 3082 m<sup>2</sup>

### 3-Hapi III-Vëzhgimi i strukturuar

Në këtë zonë dhe në gjithë zonat e tjera të marra në studim janë vëzhguar në mënyrë të veçantë, elementet fizik të pandyshueshëm të zonës, të cilët do të vlerësohen sipas katër ontologjive të hapësirës publike, me cilësite që përmban secila prej tyre dhe elementet dinamik sic janë përdoruesit. Në hapësirën në fjalë elementet fizik ishin në një gjendje kryesisht të mirë, me mobilim urban relativisht të plotësuar me shumicën e nevojave dhe në gjendje të mirë. Përsa I përket përdoruesve u vu re prezenca e tyre në numër të madh jo vetëm për të përdorur shërbimet në zonë por edhe për të kaluar kohën e lirë në zonë të vetëm ose në grupe. Aktivitetet sociale varionin nga personat që kalonin kohën të vetëm dhe deri tek grupe që luanin lojra të ndryshme tavoline apo fëmijë që luanin në grupe.

### 4-Hapi IV-Koha e vëzhgimit

Duke qene se zona ka një fluks shumë të lartë këmbësorësh, hapësira u vëzhgua në harqe të ndryshme kohore ditore dhe mujore për të kuptuar se cila ishte arsyeja që lidhej me praninë e këmbësorëve. Në zonë prezenca e tyre lidhej me dy shkaqe kryesore: 1) përdorimi i shërbimeve në zone dhe 2) përdorimi i hapësirave të gjelbëruara për të shpenzuar kohën e lirë

Në këtëmoment, pasi kemi grumbulluar të gjitha informacionet e mësipërme, mund të procedojmë me ndërtimin e skedave për secilën zonë.

#### V) Hapësira 1

Cilësitë pozitive											
E pastër dhe e rregullt	Aksesibiliteti i	Tërheqëse	E rehatshme	Ftuese	Vitale	Funksionale	Të ketë karakter dallues	E sigurtë	E qëndrueshme fizikisht ndaj përdorimit të përditshëm	E gjelbërt	Të ketë sensin e përkatësisë
X	X	X	X	X	X	X	/	X	X	X	X

Table 20. Cilësitë pozitive në hapësirën 1

Cilësitë negative															
E ndotur	Grumbullime	Graffiti	Trafik i	Ndertesa të keqmbajtura që kufizojnë hapësirën	E pasigurt	Të pastrehë	Kontribut	Parkime	E plogët	Boshe	Frika nga krimi	Mungesa e ndjesisë së vendit	Akses jo i mirë	Hapësira ndërmjetëse	Mungesa funksioni
/	/	/	X	/	/	/	/	/	/	/	/	/	/	/	/

Table 21. Cilësitë negative në hapësirën 1

	Lloji I socializimit	
	Socialisht aktive	Socialisht pasive
Hapësira 1	X	

Table 22. Lloji I socializimit në hapësirën 1



Figure 42. Skeda vlerësuese e hapësirës 1, sheshi "Cajupi"



## **6-Hapi VI) - Përcaktimi i socializimit aktiv ose pasiv**

Më sipër kemi shpjeguar në mënyrë të imtësishme se çfarë percakton socializmi aktiv dhe socializimi pasiv. Në këtë fazë vëzhgimi, hapi i parë është të përcaktohet nëse hapësira e marrë në studim ka apo jo një fluks të lartë këmbësorësh dhe më pas analizohen motivet që i sjellin në zonë. Për ta kuptuar më qartë i diskutojmë të gjitha kriteret në mënyrë të veçantë.

### *1-Lloji I aktivitetit social*

Nga vëzhgimi periodik i zonës, gjatë harqeve të ndryshme kohore, u vu re se hapësira kishte një fluks të lartë këmbësorësh, sidomos gjatë pasdites dhe darkës. Por kryesisht dy ishin motivet që sillnin praninë e njerëzve në zonë: 1) duke qene se hapësira është shumë e mirëmbajtur dhe e gjelbëruar në raport me zonën, krijonte mjedise komode për të nxitur praninë dhe kohezionin social të përdoruesve.

2) Shërbimet në zonë dhe këtu permendim kryesisht baret/lokalet ishin një shkak i fortë i pranisë së këmbësorëve në zonë por duke qene se këto janë hapësira private dhe për të cilat duhet të paguash për ti përdorur, kjo nuk klasifikohet si nje sjellje sociale në zonë.

### *2) Kohëzgjatja e aktivitetit social*

Siç e diskutuam zona është socialisht aktive që do të thotë se kohëzgjatja e qëndrimit të përdoruesve në zonë është në intervale kohore të gjata, minimalisht 1 orë deri në 3-4 orë.

### *3) Numri i personave të përfshirë*

Në varësi të llojit të socializimit që ka zona, i cili është aktiv, numri i personave të përfshirë është zakonisht 2-4 persona dhe grupe të mëdha të përfshirë në lojrat e tavolinës.

## **7-Hapi VII-Saktësia e vlerësimit empirik**

Për të arritur në konkluzionet e mësipërme, me shkallë të lartë saktësie, zona u vëzhgua gjatë ditëve të javës paradite, gjatë drekës dhe darkës, për të parë ndryshimet në fluksin e këmbësorëve. Vëzhgimi gjithatu u zhvillua edhe gjatë fundjavës. I gjithë procesi u përsërit në muaj të ndryshem, përgjatë stinës së dimrit dhe verës. Për të patur nje vlerësim objektiv të cilësive të hapësirës publike I gjithë procesi u krye edhe nga nje profesionist tjetër. Në fund rezultatet u grumbulluan dhe u ballafaquan midis tyre. Shkalla e mospërputhjes ishte shumë e ulët 5-7%.

### 3-Rruga “Bardhyl”

Rruga “Bardhyl”, është e pozicionuar në pjesën very-lindore të unazës nr.3 dhe sheshit “Skënderbej”.Siç është përmendur edhe më sipër pjesë e studimit janë të gjitha hapësirat e bulevardit që perfshihen ne unazen nr.3 dhe në vijim do ta aplikojmë modelin e gjysmë rrethit në praktikë në një sekuncë hapësinore të dy bulevardeve.

Siç shihet edhe në imazhet e mëposhtme, zona konfigurohet më së shumti nga objekte 5-6 kate të larta, të ndërtuara rreth viteve 1950, me funksion banim dhe katet përdhe shërbim dhe shumë pak objekte mbi 6 kate të larta të ndërtuara vitet e fundit. Shërbimet në zonë përbëhen kryesisht nga bare/locale dhe dyqane. Nëse do ti referohemi gjendjes së hapësirës publike, zona është e keqmbajtur, gjelbërimi është në nivele shumë të ulta, mungon mobilimi urban si dhe mungojnë ndërhyrjet e planifikuara për përmirësimin e cilësisë së saj. Duke qene se kufizohet me një nga arteriet kryesore të qarkullimit automobilistik në qytet, prania e automjeteve dominon hapësirën nepërmjet trafikut dhe parkimit. Sipërfaqja e hapësirës publike është afërsisht 5000m<sup>2</sup>.



Figure 43. Pamja në plan e rrugës « Bardhyl »



Figure 44. Imazhe të gjendjes aktuale në rrugën « Bardhyl »

### 1-Hapi I-Ndarja në zona

Siç e kemi diskutuar edhe më sipër ndarja e hapësirave në mini zona për efekt studimi bazohet mbi disa kriteret ndarës:

k) Fasada të ngjashme që konfigurojnë hapësirën



Figure 45. Imazhe të gjendjes aktuale në rrugën « Bardhyl »

Bazuar mbi këtë kriter, zona nuk mund të ndahet në hapësira më të vogla të ngjashme pasi ndërtesat që e kufizojnë janë shumë të ngjashme midis tyre, si nga ana estetike ashtu edhe nga ajo funksionale.

*l) Mobilim I ngjashëm urban*

Gjithashtu, edhe mbi këtë kriter nuk është e mundur ndarja e zonës në mini hapësira pasi mobilimi urban është thujse I njëjtë kudo dhe karakterizohet nga: trotuare të ngushtë të keqmbajtur si dhe të shtruar me të njëjtin patern, mungesa e vendeve për tu ulur dhe elementeve të dizajnit urban, ndriçim relativisht i plotë dhe gjelbërim i dobët.

*m) Funksione të ngjashme*

Diskutimi mbi ngjashmërinë e hapësirave, vlen edhe për pjesën e funksioneve në zonë pasi objektet janë të gjitha të ndara në katin përdhe shërbime dhe pjesa tjetër banim.

*n) Fluksi i lëvizjes këmbësore*

Përpos fluksit të lartë të lëvizjes këmbësore që është i lidhur me përdorimin e shërbimeve, duke qene se ka një pozicion dhe funksion strategjik në qytet, përdoret gjithashtu si një hapësirë tranzitore për këmbësoret. Në rastin e studimit tonë janë vëzhguar në harqe kohore të zgjatura, lëvizjet e këmbësorëve për të parë arsyen që i sillte në zonë. Kjo ka qenë pika kryesore mbi të cilën është bazuar ndarja në skeda për këtë hapësirë.

*o) Shërbime të ngjashme*

Shërbimet lidhen në mënyrë të drejtpërdrejtë me fluksin e lëvizjes këmbësore pasi në më të shumtën e rasteve ishin pikërisht shërbimet që sillnin publikun në zonë. Shërbimet e ngjashme të cilat ishin një kombinim midis lokaleve dhe dyqaneve si dhe fluksi i lëvizjes këmbësore ishin dy kriteret mbi të cilat u krye ndarja në mini-hapësira.

Pasi e kemi analizuar zonen mbi bazën e kritereve ndarëse, tashmë mund të bëjmë një ndarje rigoroze dhe optimale në nën njësi të ngjashme për të ndërtuar skedat informuese të zonës dhe aplikimin e modelit të gjysme rrethit. Sipas hapave të mësipërm, hapësira u nda në katër mini zona.



Figure 46. Ndarja e rrugës « Bardhyl » në nën njësi të ngjashme studimore

## 2- Hapi II-Përcaktimi i madhësisë optimale të njësive studimore

